



**PUNIM I POLITIKAVE**

Nr. 5/14 – Tetor 2014

# **Pjesëmarrja e Kosovës në Organizatat dhe Nismat Rajonale**

Ky projekt është përkrahur nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme



**NORWEGIAN MINISTRY  
OF FOREIGN AFFAIRS**

Përmbajtja dhe pikëpamjet të shprehura në këtë botim janë të KIPRED-it, dhe nuk mund të merren si pikëpamje të donatorit.

Përgatitur nga: Agon Demjaha

Përkthimi: Mentor Agani

Copyright © 2014, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org) apo: +381 38 227 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave

Rr. Rexhep Mala, Nr. 5A

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +381 38 227 778

[www.kipred.org](http://www.kipred.org)

## LISTA E AKRONIMEVE

AKRZHS – Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim  
ALPBR – Arranzhimet Lidhur me Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal  
APA – (programi i) Asistencës së Para-Aksesionit  
APBEDZ – Asambleja Parlamentare e BEDZ  
BDZTZH – Banka e Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim  
BEDZ – Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi  
BEDZ PERMIS – Sekretariati Permanent Ndërkombëtar i Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi  
BeH – Bosnja e Hercegovina  
BIE – Banka Investuese Evropiane  
BZHKE – Banka Zhvillimore e Këshillit Evropian  
CEFTA – Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore (nga: the Central European Free Trade Agreement)  
EBRD – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (nga: the European Bank for Reconstruction and Development)  
EJL – Evropa Juglindore  
EQL – Evropa Qendrore dhe Lindore  
EULEX – Misioni i Unionit Evropian i Sundimit të Ligjit në Kosovë  
FOTAJ – Forumi i Odave të Tregtisë të Adriatik-Jonit  
FQAJ – Forumi i Qyteteve të Adriatikut dhe Jonit  
GJND – Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë  
GV – Grupi i Vishegradit  
ICR – Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil (nga: the International Civilian Representative)  
IMF – Fondi Monetar Ndërkombëtar (nga: the International Monetary Fund)  
IPVQ – Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes  
K SHBA-A – Karta e SHBA-Adriatikut (e njëjtë me PKA)  
KBN – Komiteti i Bashkëpunimit të Ndërsjellë  
KBR – Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal  
KÇP – Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme  
KE – Këshilli Evropian  
KEE/KB – Komisioni Ekonomik për Evropë i Kombeve të Bashkuara  
KK – Kriteret e Kopenhagës  
KKK – Komiteti i Koordinatorëve Kombëtarë (të NEQ)  
KKKK – Komiteti Këshillues i Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve  
KMJ – Këshilli i Ministrave të Jashtëm (të NAJ)  
KN – Këshilli Nordik  
KP – Komiteti për Programe  
KP PKA – Komisioni i Partneritetit të PKA  
KPEA – Këshilli i Partneritetit Euro-Atlantik

KPT – Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin e Dënimit Jonjerëzor dhe Degradues  
 KQRLKTK – Karta e Qendrës Rajonale (të NBEJL-së) për Luftimin e Krimit Trans-Kufitar  
 KRB – Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit  
 KSHDB – Këshilli i Shteteve të Detit Baltik  
 KSSBEJL – Konferenca për Stabilitet, Siguri dhe Bashkëpunim në Evropën Juglindore  
 KZL – Komiteti i Zyrtarëve të Lartë (të NAJ)  
 MBPLKTK – Marrëveshja e Bashkëpunimit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Trans-Kufitar  
 ME – Marrëveshjet e Evropës  
 MIK – Menaxhimi i Integruar i Kufijve  
 MSA – Marrëveshjet e Stabilizimit dhe Asociimit  
 MVN – Marrëveshja për Vendin Nikoçir (të KBR-së)  
 MZPEA – Marrëveshja e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit  
 NAJ – Nisma e Adriatik-Jonit  
 NBEJL – Nisma Bashkëpunuese e Evropës Juglindore  
 NEQ – Nisma e Evropës Qendrore  
 NRDB – Nisma e Rajonit të Detit Baltik  
 NVM – Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme  
 OBD – Organizata Botërore e Doganave  
 OBT – Organizata Botërore e Tregtisë  
 OTEJL – Observuesi i Transportit i Evropës Juglindore  
 PBEJL – Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore  
 Pfp – Partneriteti për Paqe  
 PJPS – Punët e Jashtme dhe Politika e Sigurisë  
 PKA – Partneriteti i Kartës së Adriatikut (e njëjtë me K SHBA-A)  
 PS – Pakti i Stabilitetit  
 PSA – Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit  
 PSABP – Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit i Ballkanit Perëndimor  
 PSEJL – Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore  
 PSSP – Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm  
 QNSDZ – Qendra Ndërkombëtare për Studimet e Detit të Zi  
 QR – Qasja Rajonale  
 QRLKN – Qendra Rajonale për Luftimin e Krimeve Ndërkufitare  
 QRM – Qendra Rajonale Mjedisore (për Evropën Qendrore dhe Lindore)  
 ReSPA – Shkolla Rajonale e Administrimit Publik  
 SHEVJ – Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm  
 T MPJ – Takimi i Ministrave të Punëve të Jashtme (të NEQ)  
 TKE – Traktati i Komunitetit të Energjisë  
 UniAdrion – Rrjeti i Universiteteve të Adriatikut dhe Jonit  
 UNMIK – Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë  
 V3 (Vishegrad 3) – Grupi i Treshes së Vishegradit

VRKASHAI – Verifikimi Rajonal i Kontrollit të Armatimit dhe Shërbimi i Asistencës së Implementimit

ZKBR – Zyra e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal

ZL – Zgjerimi Lindor

## **PËRMBAJTJA**

<b>Përmbledhje ekzekutive .....</b>	<b>6</b>
<b>Rekomandime: .....</b>	<b>9</b>
<b>1. HYRJE.....</b>	<b>10</b>
<b>2. ZHVILLIMI I BASHKËPUNIMIT RAJONAL NE EVROPËN JUGLINDORE PAS PËRFUNDIMIT TË LUFTËS SË FTOHTË .....</b>	<b>12</b>
2.1. Bashkëpunimi Rajonal si pjesë e kondicionalitetit të Unionit Evropian .....	12
2.2. Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit.....	16
2.3. Pakti i Stabilitetit.....	19
2.4. Organizatat dhe nismat e tjera rajonale .....	23
2.4.1. Nisma Bashkëpunuese e Evropës Juglindore (NBEJL) .....	23
2.4.2. Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore (PBEJL) .....	24
2.4.3. Nisma e Evropës Qendrore (NEQ) .....	25
2.4.4. Nisma e Adriatik-Jonit (NAJ).....	26
2.4.5. Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ) .....	28
2.4.6. Partneriteti i Kartës së Adriatikut .....	29
<b>3. RRUGA E KOSOVËS DREJT PJESËMARRJES RAJONALE .....</b>	<b>30</b>
3.1. Anëtarësia nën Administratën e UNMIK-ut .....	30
3.2. Pjesëmarrja rajonale nën UNMIK-un .....	32
3.3. Pjesëmarrja pas pavarësisë .....	37
3.4. Statusi aktual i pjesëmarrjes së Kosovës në organizatat dhe nismat rajonale.....	40
3.4.1. Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (KBR) .....	42
3.4.2. Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore (PBEJL) .....	44
3.4.3. Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore (CEFTA) .....	46
3.4.4. Nisma e Evropës Qendrore (NEQ) .....	48
3.4.5. Partneriteti i Kartës së Adriatikut .....	49
<b>4. PERSPEKTIVAT E ARDHSHME TË PJESËMARRJES RAJONALE TË KOSOVËS</b>	<b>50</b>
4.1. Marrëdhëniet e tërësishme midis Kosovës dhe Serbisë .....	50
4.2. Njohja ndërkombëtare dhe integrimi i Kosovës.....	53
4.3. Kapaciteti institucional i institucioneve të Kosovës.....	56
<b>5. PËRFUNDIM .....</b>	<b>58</b>
<b>Bibliografia .....</b>	<b>62</b>

## Përmbledhje ekzekutive

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, Unioni Evropian e ndër morri misionin historik të integritit të ish vendeve komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore. Pos kritereve standarde të anëtarësimit, bashkëpunimi rajonal u bë pjesë e kondicionalitetit të UE-së për anëtarësim për këto vende të reja aspiruese. Si pasojë, në Evropën Qendrore dhe Lindore ishim dëshmitarë të një bollëku organizatash dhe nismash rajonale. Nga ana tjetër, për shkak të luftërave të përgjakshme që e pasuan shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, procesi i integritit të vendeve të Evropës Juglindore erdhi me një vonesë të caktuar në krahasim me pjesën tjetër të ish vendeve komuniste evropiane. Pos kësaj, edhe pse në Evropën Qendrore dhe Lindore fazat e stabilizimit, të tranzicionit dhe të integritit u përputhën, ato, në parim, e vijuan njëra-tjetrën. Nga ana tjetër, në Ballkanin Perëndimor integriti në UE ishte një kusht i stabilizimit, dhe jo e anasjellta. Rrjedhimisht, pos parimeve të Kopenhagës dhe kritereve universale perëndimore, UE-ja bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore i përvetësoi si një grup shtesë kriteresh të posaçme për Ballkanin Perëndimor.

Pas Luftës së Kosovës të vitit 1999, UE-ja parashtrroi një qasje më gjithëpërfshirëse dhe më pozitive rajonale përmes Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit për Ballkanin Perëndimor dhe Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore. Për vendet e rajonit, Marrëveshjet e Stabilizimit dhe të Asociimit e përcaktuan qartë rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe të marrëdhënieve të mira fqinjësore si qëndrore në rrugën e tyre drejt UE-së. Paktit të Stabilitetit, nga ana tjetër, iu dhanë fuqi unike për t'i mbledhur përfaqësuesit e EJT dhe të bashkësisë ndërkombëtare për të punuar në strategjitë rajonale të bashkëpunimit në fusha të ndryshme të tilla si demokracia, ekonomia dhe siguria. Padyshim, për UE-në zhvillimi i bashkëpunimit rajonal e përfaqësonte faktorin vendimtar për krijimin e stabilitetit politik, të sigurisë, dhe të prosperitetit ekonomik në rajon. Përmes këtyre dy mekanizmave, UE-ja kontribuoi në një masë domethënëse për ndjeshmërinë e rritur ndaj çështjeve dhe problemeve rajonale në mesin e vendeve të rajonit. Si pasojë, shumica e nismave të shumta rajonale që u shfaqën anëmbanë rajonit ishin të nxitura nga UE-ja.

Pjesëmarrja e Kosovës në organizatat dhe nismat rajonale mund të ndahet në dy faza kryesore: (1) Pjesëmarrja rajonale nën administrimin e UNMIK-ut, dhe (2) Pjesëmarrja rajonale pas pavarësimit. Që nga viti 2004, kur filloi faza e parë, UNMIK-u e nënshkroi një numër marrëveshjesh ndërkombëtare në emër të Kosovës, të tilla si Traktati i Komunitetit të Energjisë, Marrëveshja e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit, Observuesi i Transportit i Evropës Juglindore, CEFTA, dhe, më e rëndësishmja, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. Një pjesëmarrje e tillë e UNMIK-ut në emër të Kosovës në të gjitha këto organizata rajonale gjithsesi e ka sjellur Kosovën më afër rajonit, edhe politikisht, edhe ekonomikisht. Mirëpo, UNMIK-u dështoi në sigurimin e një tranzicioni të patrazuar të përfaqësimit vetjak të Kosovës në forumet rajonale përmes një bartjeje graduale të kompetencave të veta në Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës. Si pasojë, pas shpalljes së pavarësisë në shkurt të vitit 2008, Kosova u përball me vështirësi jashtëzakonisht të mëdha në angazhimin vetanë në organizatat dhe nismat rajonale.

Menjëherë pas pavarësimit, pjesëmarrja rajonale e Kosovës u bllokua pothuaj në tërësi për shkak të kundërshtimit tejet të fuqishëm nga Serbia dhe shtetet e tjera rajonale mosnjohëse. Fillimisht, Serbia, ose e bllokonte, ose e bojkotonte, çdo ngjarje rajonale në të cilën Kosova përpiqej të vepronte si shtet sovran, në vend se nën tutelën e UNMIK-ut. Duke u frikësuar që përjashtimi i Kosovës nga forumet rajonale mund ta kërcënojë çfarëdo bashkëpunimi domethënës rajonal, dhe që do ta krijojë një sfidë të madhe për integrimin në UE, UE-ja e ndihmoi dialogun midis Prishtinës dhe Beogradit për ta zhvilluar një bashkëpunim rajonal funksional. Si pasojë, në shkurt 2012, Kosova dhe Serbia e arritën marrëveshjen për Arranzhimet Lidhur me Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal, sipas të cilës Kosova do të merrte pjesë në emër të vetin dhe do të fliste për veten në të gjitha takimet ndërqeveritare rajonale, si një partner i barabartë me të gjitha shtetet pjesëmarrëse. Pos kësaj, marrëveshja bilaterale po ashtu përcaktonte se Kosova do të nënshkruante marrëveshje të reja dhe do t'i bashkangjitej organizatave të reja ndërkombëtare ndërqeveritare. Duke e ndërlidhur në një mënyrë të qartë përparimin e Serbisë drejt Brukselit me një normalizim të caktuar, hap pas hapi, të marrëdhënieve me Prishtinën, UE-ja në një mënyrë të suksesshme e zbatoi kondicionalitetin për t'i arritur disa marrëveshje të rëndësishme për t'i lëvizur Kosovën dhe Serbinë më afër njëra-tjetrës.

Megjithatë, për shkak të interpretimeve të ndryshme të ALPBR-së nga qeveritë e Serbisë dhe të Kosovës, marrëveshja fillimisht dështoi t'i jipte rezultatet e pritura. Në kundërshtim me marrëveshjen, Serbia fillimisht në mënyrë të vazhdueshme i bllokoi dhe i bojkotoi takimet rajonale ku Kosova ftohej si partnere, duke shkaktuar dyshime serioze lidhur me vullnetin e vet të mirë për zbatimin e ALPBR-së. Mirëpo, edhe pse përpjekjet e Beogradit gjithsesi kontribuan në ngadalësimin e procesit të njohjes së Kosovës dhe të integritet të saj në strukturat rajonale, këto nuk ia dolën që këtë proces ta ndalën në tërësi. Rrjedhimisht, pas përpjekjeve të jashtëzakonshme dhe një përkrahjeje shumë të madhe të UE-së, Kosova ia doli të bashkangjitet në disa organizata të rëndësishme rajonale, të tilla si Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal dhe Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, si dhe ta arrijë një sukses të konsiderueshëm në bashkangjitjen në shumë organizata të tjera. Është gjithsesi e qartë që pjesëmarrja e ardhshme rajonale e Kosovës varet në një masë domethënëse nga marrëdhëniet e tërësishme midis Kosovës dhe Serbisë, nga njohja dhe integrimi ndërkombëtar i Kosovës, si dhe nga kapaciteti institucional i institucioneve të Kosovës. Vetëm përmes një përparimi konkret në të gjitha këto fusha, Kosova mund të shpresojë për një pjesëmarrje domethënëse rajonale dhe për përparime të rëndësishme në integrimin e saj ndërkombëtar.



## Rekomandime:

- 1) Përmirësimi i perspektivave të Kosovës për një pjesëmarrje më të madhe rajonale përmes përmirësimit të marrëdhënieve të tërësishme midis Kosovës dhe Serbisë
  - Rritja e momentit ekzistues të krijuar me anëtarësimin e kohëve të fundit të Kosovës në disa organizata të rëndësishme rajonale.
  - Shfrytëzimi i mëtuajtshëm i kondicionalitetit të UE-së lidhur me Kosovën për progresin e Serbisë drejt UE-së.
  - Intensifikimi i reformave strukturale të Kosovës në rrugën e saj drejt UE-së dhe demonstrimi i vullnetit dhe përkushtimit për t'i plotësuar kërkesat dhe standardet evropiane gjatë këtij procesi.
  
- 2) Përmirësimi i perspektivave të Kosovës për një pjesëmarrje më të madhe rajonale përmes përpjekjeve shtesë për njohjen dhe integrimin ndërkombëtar të Kosovës
  - Të shfrytëzohet, së bashku me UE-në, nënshkrimi i MSA për të bërë përpjekje të koordinuara për të ushtruar tryzni të mëtejme në pesë shtetet mosnjohëse të UE-së.
  - Shfrytëzimi i përfshirjes më të madhe të kohëve të fundit të Gjermanisë në rajon.
  - Përqendrimi kryesisht në Greqinë dhe Rumaninë si aktorë kyç për pjesëmarrjen rajonale të Kosovës.
  - Ngulmimi në kondicionalitetin e UE-së lidhur me Kosovën për përparimin e Bosnjes drejt UE-së, si një mjet për zbutjen e qëndrimit të Bosnjes lidhur me pjesëmarrjen rajonale të Kosovës.
  - Shfrytëzimi i deficitit të madh tregtar me Bosnjen, si një monedhë kusuri, për përfshirjen rajonale.
  - Rritja e përpjekjeve dhe e lobimit për anëtarësimin në Këshillin e Evropës.
  
- 3) Përmirësimi i perspektivave të Kosovës për një pjesëmarrje më të madhe rajonale përmes fuqizimit të mëtejme të kapacitetit institucional të Kosovës
  - Përvetësimi i një strategjie gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar për anëtarësim në organizatat dhe nismat rajonale.
  - Ndërmarrja e reformave strukturale për ta rritur qeverisjen e mirë, për ta përmirësuar efikasitetin e institucioneve dhe për të gjeneruar zhvillim politik dhe socio-ekonomik.
  - Forcimi i përqendrimit në koordinimin ndër-ministor, në resurse, dhe në infrastrukturën administrative dhe fizike, për të siguruar një pjesëmarrje të suksesshme rajonale.
  - Ndarja e resurseve të mjaftueshme dhe të duhura financiare dhe njerëzore për ta përmirësuar performansën dhe për të fituar njohuri dhe projekte nga pjesëmarrja rajonale.

## 1. HYRJJE

Bashkëpunimi rajonal e paraqet njërin nga elementet kyçe për zhvillimin e të gjitha vendeve të Evropës Juglindore (EJL), posaçërisht në fushat ku bashkëpunimi bilateral nuk mund t'i japë rezultatet e dëshiruara. Për më tepër, ka, po ashtu, edhe çështje rajonale, apo çështje që kërkojnë veprim kolektiv apo multilateral nga disa apo të gjitha shtetet në rajonin e EJL, për të arritur përfitime që nuk mund të arrihen nga shtetet individuale që veprojnë si të izoluara. Në praktikë, kjo përfshin çdo fushë ku është një e mirë e përbashkët që do të mund të arrihej, por për të cilën resurset e një vendi të vetëm janë të pamjaftueshme për ta arritur shtrirjen e nevojshme. Kjo është në veçanti e vërtetë për fushat si energjia, transporti dhe mjedisi, ku nevoja për investime është shpërpjestimisht e lartë dhe kërkon një koordinim rajonal drejt donatorëve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare. Ky argument mund të zhvillohet, po ashtu, edhe në kahun e kundërt: rrjetet e bashkëpunimit rajonal – në çdo fushë – mund të bëjnë punë vetëm nëse të gjitha komponentet rajonale janë të ndërlidhura dhe mund t'i kontribuojnë arritjes së qëllimit të përbashkët. Lufta kundër krimit të organizuar është një shembull i përsosur i një rrjeti rajonal që mund të funksionojë vetëm nëse të gjitha vendet e rajonit janë të përfshira, por i njëjti parim vlen në pothuaj të gjitha fushat e bashkëpunimit rajonal.<sup>1</sup>

Janë identifikuar katër shkaqe kryesore për nxitjen e bashkëpunimit rajonal ekonomik në Evropën Juglindore.<sup>2</sup> Së pari, nevoja për rritjen e tregtisë së ndërsjellë, përmes eliminimit të pengesave tarifore dhe jo-tarifore, meqë çmimet më të ulëta do t'i nxisin rrjedhat rajonale tregtare dhe do ta kompensojnë performansën e dobët eksportuese të shteteve Ballkanike drejt Perëndimit. Madje edhe një shtysë e përkohshme në rrjedhat tregtare mund të krijojë përfitime statike dhe dinamike dhe mund t'i japë nxitje të fuqishme zhvillimit rajonal. Së dyti, integrimi mund t'i kontribuojë zgjidhjes së çështjeve që duhen shqyrtuar në nivelin rajonal, të tilla si migrimi, infrastruktura, energjia, dëmtimi ekologjik, çështjet e mjedisit, trafikimi ilegal, etj. Për shkak të natyrës së këtyre çështjeve, që e ndikojnë Ballkanin si të tërë, një përpjekje për t'i zgjidhur në mënyrë unilaterale mund të jetë vetëm pjesërisht e suksesshme. Së treti, integrimi mund të nxisë investime, përmes një stabiliteti më të madh politik dhe ekonomik në rajon. Mungesa e madhe e kursimeve, për shkak të varfërisë, moszhvillimit dhe humbjes së besimit në sistemin bankar, tërheqjen e kapitalit nga jashtë e bën posaçërisht të rëndësishme. Bashkëpunimi rajonal mund ta zvogëlojë rrezikun politik, të nxisë stabilitet ekonomik dhe ta rrisë madhësinë e tregjeve lokale, duke i kontribuar, kështu, veprimtarive investive. Së katërti, integrimi rajonal është një mekanizëm përmes të cilit mund të përshpejtohet konvergjenca dhe integrimi përfundimtar në strukturat ekonomike dhe në ato të sigurisë evropiane dhe euro-atlantike.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Mamelì, Simona. "Regional Cooperation in Western Balkans in Times of Political and Economical Uncertainty." *Portal on Central Eastern and Balkan Europe*, University of Bologna, No. 8, shkurt 2011, fq. 26. <http://www.pecob.eu/flex/cm/pages/ServeBLOB.php/L/EN/IDPagina/2961> (10.07.2014).

<sup>2</sup> Uvalic, Milica. "Regional Co-operation in Southeast Europe." *Journal of Southeast European and Black Sea Studies*, Vol. 1, No. 1, 2001, fq. 14-15.

<sup>3</sup> Uvalic, Milica. "Regional Co-operation in Southeast Europe." *Journal of Southeast European and Black Sea Studies*, Vol. 1, No. 1, 2001, fq. 14-15.

Duhet përmendur që bashkëpunimi rajonal në Evropën Juglindore (EJL) gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë nuk ishte shumë mbresëlënëse, dhe atë kryesisht për shkak të dallimeve të mëdha ideologjike në mesin e vendeve të rajonit. Greqia dhe Turqia ishin anëtare të Bllokut Perëndimor dhe, po ashtu, anëtare të aleancës së NATO-s; Bullgaria dhe Rumania ishin pjesë e të ashtuquajturit Bllok Lindor, të udhëhequr nga Bashkimi Sovjetik, ndërkohë që ishin edhe anëtare të Paktit të Varshavës; ish-Jugosllavia, edhe pse, formalisht, një vend komunist, në të vërtetë veten e mbante jashtë dy blloqeve kryesore dhe ishte një nga themeluesit e të ashtuquajturës lëvizje e të përkrahurave; Shqipëria ishte, po ashtu, një vend komunist, që e braktisi Paktin e Varshavës në vitin 1968, dhe që atëherë e ndoqi politikën e një izolimi total nga pjesa tjetër e botës, përfshirë këtu edhe fqinjët e vet.

Një realitet i tillë ndryshoi në një mënyrë të befte pas shembjes së komunizmit dhe fundit të Luftës së Ftohtë, kur e tërë Evropa, edhe Lindore, edhe Perëndimore, u gllabërua nga euforia e zgjerimit dhe integritetit. Pas pothuaj gjysmë shekulli, ish vendet komuniste evropiane kishin mundësi të bashkoheshin sërish me vendet e Evropës Perëndimore, duke u dhënë fund ndarjeve evropiane të krijuara nga Perdja e Hekurt. Jo vetëm që ndarjet ideologjike u zhdukën, por Unioni Evropian (UE) – drejt të cilit aspironin të gjitha vendet ish-komuniste – bashkëpunimin rajonal e shndërroi në njërin nga parakushtet më të rëndësishme për anëtarësim, dhe atë posaçërisht për vendet e Ballkanit Perëndimor. Rrjedhimisht, në më tepër se 20 vitet në vijim, ishim dëshmitarë të një begatie organizatash dhe nismash rajonale që u shfaqën anëmbanë rajonit. Ndërkohë që një numër i madh i tyre ishin të krijuara dhe të udhëhequra kryesisht nga UE-ja, u krijuan edhe shumë të tjera që rëndom ishin vendëse. Qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizohet pjesëmarrja e Kosovës në organizatat dhe nismat e ndryshme rajonale të Evropës Juglindore. Duke e bërë këtë, punimi fillimisht do ta hetojë kontekstin më të gjerë të bashkëpunimit rajonal në EJL pas fundit të Luftës së Ftohtë, dhe, më pas, do të përqendrohet në hapat konkret të Kosovës për ta rritur praninë dhe dukshmërinë e vet në mesin e këtyre organizatave dhe nismave rajonale.

Struktura e punimit përbëhet nga gjithsej pesë kapituj, përfshirë hyrjen dhe përfundimin. Pas kapitullit hyrës, në kapitullin e dytë punimi do të përqendrohet në një këndvështrim më të gjerë të evoluimit të bashkëpunimit rajonal në EJL pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Në kuadrin e këtij kapitulli, në tre nën-kapituj të ndarë, do t'i jipet një theks i veçantë Paktit të Stabilitetit (PS), Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit (PSA) si dhe organizatave dhe nismave të tjera rajonale. Në kapitullin vijues, punimi do t'i kthehet rrugës së Kosovës drejt pjesëmarrjes rajonale. Këtu, në dy nën-kapituj të veçantë do ta analizojmë, së pari, anëtarësimin e Kosovës në organizata dhe nisma të ndryshme rajonale nën administrimin e UNMIK-ut, dhe, më pas, atë pas shpalljes së pavarësisë. Pas kësaj, do ta analizojnë më në hollësi pjesëmarrjen konkrete të Kosovës në organizatat dhe nismat rajonale politike, ekonomike dhe të formave të tjera. Kapitulli i katërt ka të bëjë me perspektivat e ardhshme të pjesëmarrjes së Kosovës në organizatat dhe nismat rajonale politike, ekonomike dhe të formave të tjera. Punimi do të përfundojë me kapitullin përmbyllës, që synon t'i përmbledhë gjetjet kryesore të analizës sonë.

## 2. ZHVILLIMI I BASHKËPUNIMIT RAJONAL NË EVROPËN JUGLINDORE PAS PËRFUNDIMIT TË LUFTËS SË FTOHTË

### 2.1. Bashkëpunimi Rajonal si pjesë e kondicionalitetit të Unionit Evropian

Pas Luftës së Dytë Botërore, Evropa u nda midis shteteve perëndimore demokratike, dhe atyre me qeverisje komuniste. Në vitin 1989 Lufta e Ftohtë përfundoi me shembjen e Murit të Berlinit, rënien e komunizmit, dhe me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe të ish-Jugosllavisë. Brenda një periudhe të shkurtë kohore u bë e qartë që rënia e komunizmit mbartte implikime të thella për të ardhmen e Evropës – edhe të asaj Lindore, edhe të asaj Perëndimore. Ndërkohë që siguritë e vjetra të Luftës së Ftohtë zëvendësoheshin me një strukturë mjaft amorfe gjeopolitike, të gjitha vendet evropiane u gjetën përballë një konfigurimi gjeopolitik që kishte ndryshuar në një mënyrë të skajshme.<sup>4</sup> Ish vendet komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL) pas pothuaj gjysmë shekulli kishin rast të bashkoheshin sërish me vendet e Evropës Perëndimore dhe t'i jipnin fund ndarjeve evropiane që i kishte krijuar Perdja e Hekurt. Rritja e UE-së nxitej nga përvoja historike që Evropa është vend i sigurtë dhe prosperues vetëm kur është e bashkuar. Një rritje e tillë nuk ishte vetëm interes evropian, por edhe në interesin e më tepër paqeje, më tepër stabiliteti, më tepër prosperiteti dhe më tepër bashkëpunimi.<sup>5</sup>

Qeveritë e reja të ish vendeve komuniste evropiane të krijuara pas zgjedhjeve shumëpartiake që u mbajtën pas rënies së komunizmit, që nga fillimi përpjekjet dhe aspiratat e tyre i kishin strukturuar me një referim të qartë në vlerat thelbësore të integritetit evropian. Ishte e qartë që ato ishin duke kërkuar liri, prosperitet, dhe një vend të sigurtë brenda organizatave evropiane, dhe posaçërisht në Unionin Evropian. Brenda vetë UE-së realiteti i krijuar rishtas çoi në një periudhë të gjurmimit dhe të dilemave të mëdha. Dilema kryesore me të cilën përballëj UE-ja kishte të bënte me atë si duhej të reagonte ajo ndaj dëshirës së shprehur të ish vendeve komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL) për anëtarësim të plotë. Ishte hera e parë që filloi të shqyrtohej Neni 237 i Traktatit të Romës, që, thjeshtë, e shprehte atë që “çdo shtet evropian mund të aplikonte” për anëtarësim në Komunitet.<sup>6</sup>

Integriteti evropian, nga njëra anë, që nga fillimi kishte ambicje për të dëshmuar aftësinë e ndërtimit të një demokracie alternative, që do ta joshte sistemin sovjetik, që ishte duke e mbajtur kontrollin e vet mbi pjesën lindore të Evropës. Me rënien e Murit të Berlinit, pothuaj çdokush e kuptoi që fjala ishte për fillimin e një epoke të re për Evropën, që jipte shpresë që të gjithë evropianëve do t'u mundësonte të jetonin në një sistem të përbashkët dhe të shikonin me siguri drejt ardhmënisë. Rritja e UE-së, tekefundit, dukej si qëllim i këtij transformimi. Nga ana tjetër, edhe përkundrajt pritjeve të mëdha të shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore, UE-ja fillimisht ngurronte për ta dhënë

<sup>4</sup> O'Brennan, John, *The Eastern Enlargement of the European Union*. New York: Routledge, 2006, fq. 13.

<sup>5</sup> Verheugen, Günter, “Challenges and Opportunities of the Enlargement of the European Union,” në George Vassiliou red. *The Accession Story: The EU from 15 to 25 Countries*. Oxford: Oxford University Press, 2007, fq. 1.

<sup>6</sup> O'Brennan, fq. 14.

premtimin e anëtarësimit të plotë. Sidoqoftë, në vitin 1993, në Këshillin Evropian në Kopenhagë, rruga drejt zgjerimit kah Evropa Qendrore dhe Lindore u shtrua, kur UE-ja zyrtarisht e bëri të ditur që “vendet e asociuara të Evropës Qendrore dhe Lindore që dëshirojnë, do të bëhen anëtare të Unionit. Hyrja do të ndodhte sapo vendi përkatës të ishte në gjendje t’i merrte përsipër obligimet e anëtarësisë duke i plotësuar kushtet ekonomike dhe shoqërore.”<sup>7</sup> Sipas Peter Ludlow, Samiti i Kopenhagës çështjen e zgjerimit e transformoi “nga një mundësi teorike, në një qëllim të miratuar,” dhe artikuloi kriteret përmbajtësore përmes të cilëve mund të matej progresi.<sup>8</sup> Samiti i Kopenhagës e shënoi fillimin e të ashtuquajturit kondicionalitet të UE-së, që e luajti një rol aq të rëndësishëm në transformimin e plotë të ish vendeve komuniste të EQL. Kriteret që vendet kandidate duhej t’i plotësonin për t’iu bashkangjiteshin UE-së njiheshin si Kriteret e Kopenhagës, dhe këto e përfshinin krijimin e institucioneve stabile që e garantonin demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat njerëzore, dhe respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve; themelimin e një ekonomie funksionale të tregut, si dhe mundësinë për t’u përballur me trysnitë e konkurrencës dhe të forcave të tregut që vepronin brenda Unionit; dhe aftësinë për t’i marrë obligimet e anëtarësimit, dhe, në veçanti, ndjekjen e qëllimeve të unionit politik, ekonomik dhe monetar.<sup>9</sup>

Ishte e qartë që kushtet politike dhe ekonomike që në Këshillin Evropian të Kopenhagës të vitit 1993 iu parashtruan vendeve aspiruese të EQL, ishin shumë më gjithëpërfshirëse se ato që ishin parashtruar për çdo aplikues paraprak.<sup>10</sup> Megjithatë, Këshilli Evropian më vonë u pajtua po ashtu që “bashkëpunimi i ardhshëm me vendet e asociuara duhej t’i përshtatej qëllimit të anëtarësimit,” duke e vendosur kësaj në mënyrë të qartë ndërlidhjen midis bashkëpunimit dhe hyrjes, e cila nuk ekzistonte në Marrëveshjet e Evropës.<sup>11</sup> Në këtë mënyrë u bë e qartë që pjesë të kondicionalitetit të UE-së për anëtarësim, e avanconin, po ashtu, edhe bashkëpunimin ndërshtetëror. Bashkëpunimi rajonal në rajonin e EQL filloi të vendosej menjëherë pas ndryshimeve gjithëpërfshirëse në rajon që u bënë në vitin 1989, dhe ky u ndikua fuqishëm nga procesi i Zgjerimit Lindor të UE-së. Ky ndikim është posaçërisht domethënës për shkak të trysnisë të vetë UE-së për fillimin e integritit rajonal në EQL gjatë procesit të hyrjes. Ngjashëm me natyrën e procesit të akcesionit të UE-së, sfidat që bashkëpunimi rajonal në rajonin e EQL përpiqej t’i adresonte ishin ekonomike dhe politike. Për shkak të kësaj, gjatë procesit të akcesionit, në rajonin e EQL u krijuan dy tipa të përpjekjeve për integritim rajonal. Së pari, forumet për bashkëpunimin politik, qëllimi kryesor i të cilëve ishte adresimi i çështjeve të bashkëpunimit politik, kulturor dhe shoqëror në rrugën për në UE. Dhe, së dyti,

---

<sup>7</sup> Avery, Graham, “The enlargement negotiations,” në Fraser Cameron red. *The Future of Europe: Integration and Enlargement*, New York: Routledge, 2004, fq. 36.

<sup>8</sup> Ludlow, Peter, *The Making of the New Europe: The European Councils on Brussels and Copenhagen 2002*, European Council Commentary 2/1, Brussels: Euro Comment, 2004, fq. 21.

<sup>9</sup> European Council, Presidency Conclusions, Copenhagen European Council, *Bulletin of the European Communities*, EC 6–1993.

<sup>10</sup> Michalski, Anna dhe Wallace, Helen, *The European Community: The Challenge of Enlargement*, London: Royal Institute of International Affairs, 1992, fq. 73.

<sup>11</sup> O’Brennan, fq. 23.

organizatat që e synonin integrimin rajonal ekonomik, me qëllim të liberalizimit të marrëdhënieve të ndërsjella ekonomike ndërmjet vendeve aspiruese.<sup>12</sup>

Si rezultat i kësaj trysnie, në rajon u krijua një vargan skemash rajonale të bashkëpunimit. Vitet e hershme 1990 e panë shfaqjen e Nismës së Evropës Qendrore (NEQ), që i përfshinte, si vendet anëtare të UE-së, ashtu edhe vendet candidate. E nisur në vitin 1989 nga Jugosllavia, Italia, Austria dhe Hungaria, NEQ e paraqiste një forum ndërqeveritar për bashkëpunim ekonomik, politik dhe kulturor, me qëllim kryesor të asistimit të ekonomive në tranzicion për të konvergjuar në UE.<sup>13</sup> NEQ ishte e suksesshme gjatë disa valëve të procesit të zgjerimit në vitet 1990, dhe zgjerimi i saj i fundit ndodhi në vitin 2000, kur anëtare të saj u bënë Serbia dhe Mali i Zi. NEQ dhe marrëdhëniet e saj me institucionet e UE-së e paraqesin një shembull të mirë të zhvillimit të qasjes së UE-së ndaj integritit rajonal në Evropën Qendrore dhe Lindore. Ngjashëm me rastet e tjera të integritit në rajon, NEQ marrëdhënien e saj ndaj integritit mbizotërues në Evropë e përcaktoi si një të pastër plotësuese, në vend se si konkurruese.<sup>14</sup>

Ngjashëm, në shkurtin e vitit 1991, presidentët e Hungarisë, Çekosllovakisë<sup>15</sup> dhe të Polonisë u takuan në Vishegrad dhe e shpallën gatishmërinë e tyre për ta zhvilluar një bashkëpunim tre-shtegësh ekonomik, në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në NATO dhe në UE. I ashtuquajturit V3 ndoqi në një mënyrë efektive politikat e përbashkëta rreth këtyre qëllimeve, dhe deri në vitin 1992 emri i Grupit të Vishegradit (GV) ishte i njohur mirë brenda dhe jashtë rajonit.<sup>16</sup> Megjithatë, viti 1992 kishte po ashtu zhvillime që e sollën fillimin e rënies së GV-së. Ndarja e Çekosllovakisë, tendenca që konkurrenca ta zëvendësonte bashkëpunimin në marrëdhëniet e UE-së, dhe humbja gjithnjë e më e madhe e vendit të Sllovakisë në procesin e zgjerimit të UE-së dhe të NATO-s, që të gjithat ia rrëmihën themelet GV-së. Periudha 1993-98 zakonisht karakterizohet si kohë e një bashkëpunimi të përgjumur të GV-së. Një fillim i sërishëm i madh ndodhi në vitin 1998, pas ndryshimeve qeveritare në Republikën Çeke dhe në atë Sllovake. Po ashtu, në këtë kohë, procesi i para-aksesionit në UE tash kishte arritur në fazën e negociimit të anëtarësimit dhe ishte duke hapur çështje të interesit të përbashkët që bashkëpunimin politik e lëviznin për shkaqe pragmatike – për shembull, nevoja për t'i maksimalizuar shanset e Sllovakisë për t'iu bashkangjitur UE-së në të njëjtën kohë si edhe të shteteve të tjera të Vishegradit. Hapa të rëndësishëm në drejtim të formalizimit të kornizës së bashkëpunimit të GV-së u morrën në maj të vitit 1999, pas një shqyrtimi të parimeve

---

<sup>12</sup> Cihelková, Eva dhe Hnát, Pavel, "Regional Integration of the New Member States during the Pre-Accession Period and after Eastern Enlargement," Centre for Applied Policy Research (CAP) Working Paper, dhjetor 2006, fq. 8.

<sup>13</sup> Për një shqyrtim më të hollësishëm për NEQ, shih, Cviić, Christopher, "The Central European Initiative," në Andrew Cottey red. *Subregional Cooperation in the New Europe: Building Security, Prosperity and Solidarity from the Barents to the Black Sea*, London: Macmillan Press, 1999, fq. 113–127.

<sup>14</sup> Cihelková, fq. 8.

<sup>15</sup> Grupi i Vishegradit (GV) në fillim njihet si "Treshi i Vishegradit" (V3), por më vonë, kur në vitin 1993 Çekosllovakia u nda në dy vende të pavarura (Republika Çeke dhe Sllovakia), grupi u shndërrua në "Katërshen e Vishegradit" (V4).

<sup>16</sup> Dangerfield, Martin, "The Visegrad Group and the European Union's 'Eastern' Dimension," EUSA Biennial Conference 2009, Los Angeles 23, Panel 6I: *Reconsidering Enlargement*, fq. 4.

dhe procedurave kryesore të aleancës sub-rajonale.<sup>17</sup> Duhet theksuar që edhe pse nuk kishte ndonjë kërkesë formale për bashkëpunim rajonal në përmbajtjen e Marrëveshjeve të Evropës, dihet fare mirë që në vendet e Vishegradit prapa skenës u ushtrua një trysni e konsiderueshme për ta tejkaluar ngurrimin e tyre fillestar. Mesazhi nga Komisioni Evropian ishte që mungesa e përparimit në marrëdhëniet e ndërsjella do të ishte e papajtueshme me ambicjet për zhvillimin e mëtutjeshëm të integritimit në UE. Edhe pse rendi i ditës së bashkëpunimit rajonal ishte i ndërlidhur me fazën e pretenduar ‘të stabilizimit’ të politikës së UE-së ndaj EQL, ndërlidhet me anëtarësinë e ardhshme – dhe, në këtë mënyrë, edhe qasja ndaj integritimit – tashmë ishin evidente.<sup>18</sup>

Në vitin 1993, vendet e Vishegradit i vunë themelet e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) që synonte t’i liberalizonte rrjedhat tregtare në rajon. Është e rëndësishme këtu që kushti vendimtar për t’iu bashkangjitur CEFTA-s, krahas anëtarësisë në Organizatën Botërore të Tregtisë (WTO), ishte realizimi i marrëveshjes së asociimit me UE-në.<sup>19</sup> Pos kësaj, për formimin e një organizate ekonomike të tillë si CEFTA, në kuadrin e kornizës për bashkëpunim rajonal, ishin edhe shumë faktorë të tjerë të rëndësishëm. Së pari, aftësia e shteteve anëtare për ta rritur tregtinë e tyre me njëri-tjetrin e ndihmoi rritjen e prosperitetit të tyre dhe e përkrahu tranzicionin e tyre drejt ekonomive të bazuara në treg. Së dyti, me integrimin e tyre, ato e ndërtonin një urë midis UE-së dhe vendeve të EQL. Së treti, formimi i një aleance fuqinë e shteteve anëtare në negociatat për hyrje me UE-në e bënte më të madhe.<sup>20</sup> Duke qenë politikisht relativisht atraktive, CEFTA gradualisht tërhoqi anëtarë të rinj, të tillë si Sllovenia (1996), Rumania (1997), Bullgaria (1999), Kroacia (2003), dhe pas vitit 2006 edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Ideja e bashkëpunimit rajonal si një hap fillestar për anëtarësimin në UE lëvizi në drejtimin e bashkëpunimit rajonal si një kusht formal për aksesion, me ME-të që u nënshkruan me shtetet baltike në vitin 1995. Marrëveshjet me Estoninë, Latvinë dhe Lituaninë vendeve partnere u kërkonin “që ta mbanin dhe zhvillonin bashkëpunimin mes vete” dhe “që ta bënë çdo përpjekje për ta rritur progresin e tij.”<sup>21</sup> Rrjedhimisht, në Kopenhagë, në vitin 1992, Ministrat e Jashtëm të rajonit të Detit Baltik e themeluan Këshillin e Shteteve të Detit Baltik (KSHDB) si një trajtë e drejtpërdrejtë e bashkëpunimit rajonal. KSHDB u rregullua si forum i përgjithshëm politik për bashkëpunimin rajonal ndërqeveritar, dhe anëtarët e tij i përfshijnë 11 shtete të rajonit të Detit Baltik si dhe Komisionin Evropian. Pos UE-së, ky Këshill u ndikua, po ashtu, në një mënyrë të veçantë nga rregullimi institucional i Këshillit Nordik, dhe atë për shkak të afërsisë gjeografike dhe kulturore të

---

<sup>17</sup> Për një trajtim më të gjerë të ngritjes dhe rënies së GV-së, shih, Dangerfield, Martin, “The Visegrad Group in the expanded European Union: From pre-accession to post-accession cooperation, *East European Politics and Societies*, Vol. 22, No. 3, 2008, fq. 630-667.

<sup>18</sup> Dangerfield, Martin, “Regional Cooperation in the Western Balkans: Stabilisation Device or Integration Policy?,” *Perspectives on European Politics and Society*, Vol.5, No.2., 2004, fq. 210.

<sup>19</sup> Bechev, Dimitar, “Carrots, sticks and norms: the EU and regional cooperation in Southeast Europe,” *Journal of Southern Europe and the Balkans*, Vol. 8, No. 1, prill 2006, fq. 29.

<sup>20</sup> Kupich, Andrzej, “The Central European Free Trade Agreement: Problems, Experiences, Prospects,” në Andrew Cottey eds., *Subregional Cooperation in the New Europe: Building Security, Prosperity and Solidarity from the Barents to the Black Sea*, London: Macmillan Press, 1999, fq. 90.

<sup>21</sup> Dangerfield 2004, fq. 211.

këtyre dy rajoneve. Që nga themelimi i vet, KSHDB i ka kontribuar sigurimit të zhvillimeve pozitive brenda rajonit të Detit Baltik dhe ka shërbyer si forcë shtytëse për bashkëpunimin multilateral. Paralelisht me rritjen e ndikimit dhe të shtrirjes së vet, organizata është përfshirë hap pas hapi në aktivitetet e Unionit Evropian. Në të vërtetë, organizata ka qenë në gjendje ta tërheqë vëmendjen e UE-së, dhe në veçanti atë të Komisionit, kah rajoni, përmes Nismës së Rajonit të Detit Baltik, që ishte i vetmi rast në Evropë ku Komisioni e ka filluar një nismë në kuadrin e një organizate rajonale, dhe ia ka njohur rolin komplementar një 'të jashtëmi'.<sup>22</sup>

Kësisoj, mund të përfundohet që Unioni Evropian e ka ndikuar në masë të madhe formimin e bashkëpunimit rajonal në rajonin e EQL. Pavarësisht nga ajo se a i trajtonte axhenda kryesore e integritimit të EQL çështjet ekonomike apo politike, i tërë integrimi ishte i ndikuar pozitivisht nga përpjekjet e UE-së për ta përkrahur nisjen e proceseve integruese formale, si dhe joformale, në EQL, gjatë periudhës së para-aksesionit. Këto përpjekje ishin të motivuara kryesisht nga interesi i UE-së në marrëdhëniet e ndërsjella midis anëtarëve të rinj potencialë, që do ta forconin pozitën e tyre në mjedisin konkurrent të tregut të brendshëm.<sup>23</sup>

## 2.2. Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit

Në fazën fillestare pas shembjes së komunizmit, perspektiva e zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor<sup>24</sup> erdhi me një vonesë të caktuar në krahasim me pjesën tjetër të shteteve evropiane post-komuniste. Nga njëra anë, UE-ja ishte e preokupuar kryesisht me procesin e zgjerimit të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, ndërkohë që, nga ana tjetër, Ballkani ishte i gllabëruar në luftra të përgjakshme pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Pos kësaj, nëse në EQL fazat e stabilizimit, tranzicionit dhe të integritimit vërtetë u mbivendosën, këto, në parim, e vijuan njëra-tjetrën. Në Ballkanin Perëndimor, nga ana tjetër, integrimi në UE ishte një kusht për stabilizim, në vend se të ishte e anasjellta. Kjo e nënkuptonte që fazat e stabilizimit, tranzicionit dhe të integritimit duhej të vazhdonin njëkohësisht, ashtu që efektet e tyre të fuqizimit të ndërsjellë të bënin punë.<sup>25</sup> Prandaj, edhe pse procesi i zgjerimit të UE-së drejt Ballkanit Perëndimor i rikrijoi shumë nga modelet e përvojës së zgjerimit kah Evropa Qendrore dhe Lindore, ky, në të njëjtën kohë, futi edhe disa aspekte të reja në procesin evoluues të kondicionalitetit politik. Këto kritere të reja shitesë e pasqyronin ndryshimin e rrethanave ndërkombëtare, ankthet dhe barazpeshat e brendshme të UE-së, dhe kontekstet e veçanta rajonale dhe ato të brendshme të vendeve në fjalë. Pos parimeve të Kopenhagës dhe kritereve universale Perëndimore, UE-ja përvetësoi edhe një grumbull të posaçëm

---

<sup>22</sup> Për një trajtim më të gjerë për bashkëpunimin baltik, shih Tassinari, Fabrizio dhe Williams, Leena-Kaarina, "Soft Security in the Baltic Sea Region: Environmental Co-operation as a Pilot Project for Regional Integration in the Baltic Sea Area," në Fabrizio Tassinari red. *The Baltic Sea Region in the European Union: Reflections on Identity, Soft-Security and Marginality*, Wydawnictwo Uniwersytetu Gdańskiego, Nordeuropa-Institut der Humboldt-Universität zu Berlin, Gdańsk-Berlin, 2003, fq. 17-22.

<sup>23</sup> Čihelková, fq. 7.

<sup>24</sup> Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia dhe fillimisht Republika Federale e Jugosllavisë (me vonë Serbia dhe Mali i Zi).

<sup>25</sup> Batt, Judy, "The Stability/Integration Dilemma," në Judy Batt eds., *The Western Balkans: Moving on*, Chaillot Paper No. 70, tetor 2004, Institute For Security Studies, fq. 19.



shtesë të kriterëve për Ballkanin Perëndimor që i adresonin sfidat rajonale të pas-konfliktit, të rindërtimit, stabilizimit, dhe reformës.<sup>26</sup>

Procesi i Rojamonit (Royaumont), që filloi në dhjetor 1996 nën Presidencën franceze të UE-së me qëllim të përkrahjes së jetësimit të Marrëveshjeve Paqësore të Dejtonit/Parisit, ishte nisma e parë gjithëpërfshirëse e UE-së në rajon. Në të vërtetë, procesi i Rojamonit, pos shteteve anëtare të UE-së përfshinte, po ashtu, edhe vende fqinje rajonale, si dhe SHBA-të, Rusinë, OSBE-në dhe Këshillin e Evropës. Ky përqendrohej në përparimin e projekteve rajonale në fushat e shoqërisë civile, kulturës, të drejtave të njeriut dhe të demokracisë, në të njëjtën kohë kur i jipte përparësi dialogut ndërparlamentar. Një nismë e tillë për dialog dhe bashkëpunim u mirëprit nga të gjitha parlamentet kombëtare të Evropës Juglindore. Pos kësaj, Procesi i Rojamonit përkrahej, po ashtu, edhe nga Parlamenti Evropian.<sup>27</sup> Vizioni nxitës i Procesit të Rojamonit ishte një familje e bashkuar evropiane e themeluar mbi parimet e paqes, stabilitetit, bashkëpunimit dhe demokracisë, ndërkohë që rëndësia e tij ishte që ky i çonte përpara kanalet e dialogut dhe hapte rrugë për Qasjen Rajonale në UE.

Qasja Rajonale e simbolizonte shenjën fillestare të ndryshimit në strategjinë e UE-së për Ballkanin Perëndimor. Ishte pranuar që Evropa dështoi të vepronte bashkë dhe ta krijonte një politikë gjithëpërfshirëse për Ballkanin që nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë. Qasja Rajonale e UE-së ndaj vendeve të Evropës Juglindore u përvetësua së pari më 26 shkurt 1996, në Përfundimet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme. Këtu, UE shpreh qartë që “marrëveshjet me çdonjërin nga vendet në fjalë duhet të përpilohen si një nxitje përmbajtësore kah stabiliteti politik dhe si një instrument për zhvillimin dhe bashkëpunimin ekonomik midis tyre, midis këtyre vendeve dhe fqinjëve të tyre, dhe Unionit Evropian.”<sup>28</sup> Këto kushte të kondicionalitetit u përcaktuan më tutje më 29 prill 1997, kur Këshilli i vendosi kushtet politike dhe ekonomike që duhej të plotësoheshin nga këto vende, si themel për një politikë koherente dhe transparente drejt zhvillimit të marrëdhënieve bilaterale në fushën e tregtisë, të asistencës financiare dhe të bashkëpunimit ekonomik, si dhe të marrëdhënieve kontraktuale.<sup>29</sup> Megjithatë, duhet theksuar që Qasja Rajonale e vitit 1997 pati një sukses të kufizuar dhe u përqendrua më tepër në pezullimin e marrëveshjeve dhe në përjashtimin prej tyre, ose në ngrirjen e asistencës financiare.

Pas Luftës së Kosovës të vitit 1999, UE-ja përvetësoi një qasje rajonale më gjithëpërfshirëse që shikonte më pozitivisht, përmes Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit (PSA) për Ballkanin Perëndimor<sup>30</sup> dhe Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore (PS). Udhëheqësit e UE-së në një mënyrë të qartë vendosën që një politikë e rindërtimit, përmbajtjes dhe e stabilizimit emergjent nuk ishte e mjaftueshme për të sjellur paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm në Ballkan. Mendohej që këtë

---

<sup>26</sup> Anastasakis, Othon, “EU’s political conditionality in the Western Balkans: towards a more pragmatic approach,” *Southeast European and Black Sea Studies*, Vol. 8, No. 4, dhjetor 2008, fq. 367.

<sup>27</sup> European Commission, “European Union Initiatives for South-eastern Europe to Date.” <http://europa.eu.int/comm/enlargement> (23.09.2014).

<sup>28</sup> Përfundimet e Këshillit për Çështje të Përgjithshme (General Affairs Council) të 26 shkurtit 1996.

<sup>29</sup> Përfundimet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të 29 prillit 1997.

<sup>30</sup> Përfundimet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të 21–22 qershorit 1999.

ishin në gjendje ta arrinin vetëm perspektivat e mirëfillta për integrim në strukturat evropiane. Këshillat Evropiane në Feira dhe në Nicë e pranuan në një mënyrë të qartë thirrjen e vendeve si “kandidatë potencialë,” dhe këto flisnin për “perspektiva të qarta të aksesionit” një herë pasi të plotësoheshin kushtet relevante. Politika e Stabilizimit dhe e Asociimit ishte përpiluar ashtu që vendeve të Ballkanit t’u ndihmonte që këtë aspiratë ta shndërronin në realitet, dhe ta themelonte një kornizë strategjike në marrëdhëniet e tyre me UE-në.<sup>31</sup> Rrjedhimisht, Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit, dhe komponentet e tij kryesore, Marrëveshjet e Stabilizimit dhe të Asociimit (MSA-të) dhe Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Asociim (AKRZHA – janar 2007, që u zëvendësua nga programi i Instrumentit për Asistencën e Para-Aksesionit – APA), u shndërruan në mekanizmat kryesorë për zbatimin e politikës aktuale të UE-së për Ballkanin Perëndimor.<sup>32</sup> Mirëpo, kjo erdhi me një kondicionalitet më të madh politik, që theksin e vendeve në parimet e paqes, të drejtësisë për krimet e luftës, të pajtimit, jo-diskriminimit dhe të marrëdhënieve të mira fqinjësore. Pos kësaj, raportet e UE-së dhe punimet e strategjisë e theksonin dobësinë shtetërore dhe institucionale të të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe këto, pos kësaj, përqendroheshin në ndërtimin e shtetit, duke ofruar asistencë paralele financiare dhe teknike për modernizimin e strukturave lokale administrative.<sup>33</sup>

Rëndësia e bashkëpunimit rajonal ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor u theksua edhe një herë në Samitin e Zagrebit që u mbajt në nëntor 2000. Deklarata Finale e Samitit shprehte që “ndryshimet historike të kohëve të fundit janë duke e hapur rrugën për pajtimin dhe bashkëpunimin rajonal. Këto u mundësojnë të gjitha vendeve të rajonit për të vendosur marrëdhënie të reja të paqes dhe të stabilitetit në rajon, si dhe në të tërë kontinentin evropian, e që do të ishin të dobishme për çdonjërin prej tyre.”<sup>34</sup> Përfundimet për bashkëpunimin rajonal nuk ishin vetëm retorike, meqë pjesëmarrësit e Samitit të Zagrebit u pajtuan, po ashtu, që kërkesat e bashkëpunimit rajonal duhej të inkorporoheshin në Marrëveshjet e Stabilizimit dhe të Asociimit, dhe që lëvizjes drejt zonës së ndërsjellë të tregtisë së lirë duhej t’i jipej një prioritet i lartë. E qartë, në themel të këtij zhvillimi ishte njohja e shteteve të PSA-së që kjo, në të vërtetë, nuk ishte një çështje e zgjedhjes – përballë bashkëpunimit rajonal, konsideratat e tjera, çfarëdo qofshin ato, duhej t’u nënshtroheshin prioritetit të avancimit të marrëdhënieve të UE-së.<sup>35</sup>

Pas përfundimit të negociatave për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit në Samitin e Zagrebit, Republika e Maqedonisë ishte vendi i parë i rajonit që e nënshkroi MSA-në më 9 prill 2001.<sup>36</sup> Qëllimi

---

<sup>31</sup> “The Stabilisation and Association process for South East Europe First Annual Report,” Commission of the European Communities, Brussels, 03 prill 2002, fq. 4.

<sup>32</sup> Pippan, Christian, “The Rocky Road to Europe: the EU’s Stabilisation and Association Process for the Western Balkans and the Principle of Conditionality,” *European Foreign Affairs Review*, Vol. 9, 2004, fq. 222.

<sup>33</sup> Anastasakis, Othon, “EU’s political conditionality in the Western Balkans: towards a more pragmatic approach,” *Southeast European and Black Sea Studies*, Vol. 8, No. 4, dhjetor 2008, fq. 368.

<sup>34</sup> Samiti i Zagrebit i bëri bashkë krerët e shteteve të PSA-së në takimin e parë multilateral pas Millosheviqit. Ky e krijoi, po ashtu, atë që njihet si ‘Procesi i Zagrebit,’ që i mbledh udhëheqësit politikë të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe të shteteve të UE-së; shih, “The Declaration of the Zagreb Summit,” 24 nëntor 2000.

<sup>35</sup> Dangerfield 2004, fq. 213.

<sup>36</sup> Përndryshe, Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit hyri në fuqi më 1 prill 2004.

kryesor i MSA-ve ishte themelimi i një asociacioni formal midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Unionit gjatë një periudhe kalimtare. Në këtë periudhë, vendet potenciale kandidate gradualisht do t'i përshtatnin ligjet dhe strukturat e tyre me standardet dhe rregullat thelbësore të tregut të UE-së, dhe do ta harmonizonin legjislacionin e tyre me *acquis* të Komunitetit. Për më tepër, merrej se MSA-të do ta ndihmonin tranzicionin në kapitalizmin e tregut dhe në demokraci, dhe, po ashtu, që do ta ndihmonin bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat e mbuluara nga kjo marrëveshje. Ky proces i përvetësimit dhe harmonizimit merrej se do të vepronte njësoj si Marrëveshjet e Evropës në aksesionin e vendeve të EQL, dhe se do t'i përshpejtonte dhe trajtësonte reformat e brendshme politike dhe legale në Ballkanin Perëndimor.<sup>37</sup>

Në këtë Marrëveshje, ishin disa kushte të veçanta lidhur me bashkëpunimin rajonal dhe me marrëdhëniet e mira fqinjësore. Kështu, Marrëveshja e shpreh qartë që “paqja dhe stabiliteti ndërkombëtar dhe rajonal, dhe zhvillimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore janë qendrore për Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit.” Për më tepër, “Republika e Maqedonisë është e përkushtuar të hyjë në bashkëpunim dhe në marrëdhënie të mira fqinjësore me vendet e tjera të rajonit përfshirë një nivel të duhur të koncesioneve të ndërsjella që kanë të bëjnë me lëvizjen e personave, të mirave, të kapitalit dhe të shërbimeve, si dhe me zhvillimin e projekteve të interesit të përbashkët. Ky përkushtim e paraqet një faktor vendimtar në zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis palëve, dhe në këtë mënyrë i kontribuon stabilitetit rajonal.”<sup>38</sup> Shumë shpejt pas Maqedonisë, më 29 tetor 2001, Marrëveshjen e Stabilizimit dhe të Asociimit me UE-në e nënshkroi edhe Kroacia. Përsëri, si në rastin e Maqedonisë, bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore me vendet e tjera të rajonit e paraqisnin elementin kyç të marrëveshjes.<sup>39</sup> Ishte e qartë që në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, UE-ja që nga fillimi kishte vendosur të angazhohej aktivisht në trajtësimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe të bashkëpunimit rajonal. Rëndësia e bashkëpunimit rajonal dhe e marrëdhënieve të mira fqinjësore me vendet e tjera të rajonit shprehej po ashtu qartë në Marrëveshjet përkatëse të Stabilizimit dhe të Asociimit që të gjitha vendet e rajonit i nënshkruan më vonë me UE-në.

### 2.3. Pakti i Stabilitetit

Në një mënyrë paksa paralele me PSA, më 10 qershor 1999, UE-ja e nisi po ashtu edhe Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore. Megjithatë, edhe përkundrejt rolit udhëheqës të UE-së, Pakti i Stabilitetit nuk ishte instrument vetëm i UE-së. Në dokumentin themelues, më tepër se 40 vende partnere dhe organizata<sup>40</sup> bënë ndërmarrje për t'i fuqizuar vendet e Evropës Juglindore “në

---

<sup>37</sup> Pippin, fq. 233.

<sup>38</sup> “Stabilisation and Association Agreement between the Republic of Macedonia, of the one part, and the European Communities and their Member States, of the other part,” 9 prill 2001, Nenet 3 dhe 4.

<sup>39</sup> “Stabilisation and Association Agreement between the Republic of Croatia, of the one part, and the European Communities and their Member States, of the other part,” 9 prill 2001, Nenet 3 dhe 4.

<sup>40</sup> Partnerët e Paktit të Stabilitetit janë si vijon: 1. Vendet e rajonit: Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika e Maqedonisë, Moldova, Rumania dhe Serbia e Mali i Zi. 2. Shtetet anëtare të Unionit Evropian dhe Komisioni Evropian. 3. Vendet e tjera: Kanadaja, Japonia, Norvegjia. 4. Rusia, Zvicra, Turqia, SHBA. 5. Organizatat ndërkombëtare: KB, OSBE, Këshilli i Evropës, UNHCR, NATO, OECD. 6. Institucionet financiare ndërkombëtare:

përprojekjet e tyre për të forcuar paqen, demokracinë, respektimin e të drejtave njerëzore dhe prosperitetin ekonomik, ashtu që të arrihet stabilitet në të tërë rajonin.”<sup>41</sup> Megjithatë, është e rëndësishme të qartësohet që PS nuk ishte organizatë ndërkombëtare, që ky nuk kishte resurse të veta financiare, dhe që nuk ishte një trup zbatues. Pakti i Stabilitetit ishte i përpiluar si një trup i përkohshëm me fuqi të veçanta për t’i mbledhur përfaqësuesit e EJJL dhe të bashkësisë ndërkombëtare për të punuar në strategjitë e bashkëpunimit rajonal në fusha të ndryshme të tilla si demokracia, ekonomia dhe siguria.<sup>42</sup>

Në dokumentin themelues të Paktit të Stabilitetit, UE-ja, që e mori rolin udhëheqës në Pakt, ndërmori që Evropën Juglindore ta tërhiqte “më afër perspektivës së integritimit të plotë ... në strukturat e saj,” përfshirë edhe anëtarësimin përfundimtar të plotë. Megjithatë, vendet që dëshironin të pranoheshin duhej së pari t’i plotësonin kushtet e përcaktuara nga Këshilli i UE-së në 1993, që kishin të bënin me reformat demokratike, ekonomike dhe institucionale.<sup>43</sup> Në punën e vet, Pakti i Stabilitetit funksiononte si një rrugë dykahëshe midis donatorëve dhe vendeve pranuese të rajonit. Më e rëndësishmja, UE dhe shtetet e tij anëtare ishin, po ashtu, edhe donatorët më të rëndësishëm në rajon. Përkrahja e bashkësisë ndërkombëtare ishte e kushtëzuar me implementimin e reformave të duhura. Kështu, brenda kornizës së Paktit të Stabilitetit, qeveritë në rajon nuk ishin përgjegjëse vetëm për kriteret e Kopenhagës, por, po ashtu, edhe për bashkëpunimin rajonal, reformat ekonomike, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, e kështu me radhë. Si kundërshtpërblym, donatorët obligoheshin ta përkrahnin procesin e stabilizimit dhe të rindërtimit në një mënyrë të koordinuar përmes asistencës dhe kredive. Të gjitha elementet kyçe do të arriheshin përmes bashkëpunimit rajonal dhe integritimit të Ballkanit Perëndimor në institucionet Euro-Atlantike.<sup>44</sup>

Strukturat dhe metodat e punës së Paktit të Stabilitetit ishin të modeluara ngjashëm me ato të OSBE-së. Nga aspekti organizativ, Pakti i Stabilitetit mbështetej në udhëheqësinë politike të Koordinatorit Special dhe të Sekretariatit me një personel prej rreth 30 vetash. Mandati i Paktit për t’u përqendruar në promovimin e sistemeve të qëndrueshme demokratike, në promovimin e mirëqenies ekonomike dhe shoqërore, dhe në krijimin e një mjedisi stabil të sigurisë, pasqyrohej në tri njësitë e tij kryesore organizative – të njohura si Tabelat Punuese.<sup>45</sup> Në çdonjërin nga Tabelat

---

Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Banka Investuese Evropiane (BIE), Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës (BZHKE). 7. Nismat rajonale: Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi (BEDZ), Nisma e Evropës Qendrore (NEQ), Nisma Bashkëpunuese e Evropës Juglindore (NBEJJL), dhe Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore (PBEJJL).

<sup>41</sup> Për tekstin final të Paktit të Stabilitetit të 10 qershorit 1999, shih: <http://www.stabilitypact.org>.

<sup>42</sup> “Eight years of the Stability Pact for South Eastern Europe – From Stabilisation to Integration,” The Stability Pact for South Eastern Europe brochure, 12 dhjetor 2007, fq. 4.

<sup>43</sup> Teksti final i Paktit të Stabilitetit.

<sup>44</sup> Hombach, Bodo, “Stability Pact for Southeastern Europe: a New Perspective for the Region,” *Perceptions: Journal of International Affairs*, Vol. 5, No. 3, shtator – nëntor 2000, fq. 6.

<sup>45</sup> Nën Tabelën Rajonale ishin tri tabela punuese: tabela punuese një, e përpiluar për demokratizim dhe të drejta të njeriut; tabela punuese dy, e përpiluar për rindërtim ekonomik, bashkëpunim dhe zhvillim; tabela punuese tre, e përpiluar për çështjet e sigurisë, me dy nën-tabela, domethënë, sigurinë e mbrojtjen dhe drejtësinë e çështjet e brendshme. Për informata të hollësishme lidhur me strukturën dhe metodat e punës të PS, shih, <http://www.stabilitypact.org>.

Punuese, partnerët rajonal dhe ndërkombëtar bëheshin bashkë që në marrëdhënie të barabarta ta siguronin përparimin në çështje të veçanta. Ky forum unik e mundësonte zhvillimin e strategjive që bazoheshin në praktikat më të mira ndërkombëtare, por që u ishin përshtatur rrethanave lokale. Ky po ashtu mundësonte një koordinim më të mirë të resurseve rajonale dhe ndërkombëtare.

Që nga fillimi, ishte e qartë që Pakti i Stabilitetit merrej të ishte plotësues i aspiratave të EJL për anëtarësim në UE dhe në NATO. Megjithatë, duke e patur parasysh parësinë që vendet e rajonit ia jipnin UE-së dhe NATO-s, gatishmëria në anën e vendeve të Evropës Juglindore për ta marrë një rol në trupin e tyre rajonal bashkëpunues, në Paktin e Stabilitetit, ishte, të paktën fillimisht, e kufizuar. Ndërkohë që e mirëprisnin aftësinë e Paktit për të vepruar si një ndërmjetës për asistencën aq të nevojshme teknike dhe financiare, disa nga vendet e EJL ishin ngurruese për t'u përfshirë më për së afërmi në veprimtaritë e tij.<sup>46</sup> Kjo ndodhte pjesërisht për shkak të shqetësimeve politike të vendeve që Pakti do të shfrytëzohej si një dhomë pritjeje për anëtarësim në UE, apo, madje, edhe si një alternativë për këtë anëtarësimin. Dallimet politike dhe ekonomike ndërmjet vendeve të EJL, së bashku me trashëgiminë e hidhur, bënë që disa vende të besonin që shpresa e tyre më e mirë e një anëtarësimi të hershëm në UE dhe në NATO ishte që 'këtë ta bënin vetëm,' duke e lënë bashkëpunimin me fqinjët e tyre ballkanikë vetëm për situatat e domosdoshmërisë absolute.<sup>47</sup>

Rrjedhimisht, kjo i kontribuoi diskutimeve nëse nismat e PS-së dhe të PSA-së të UE-së ishin plotësuese apo konkurruese nga aspekti i bashkëpunimit rajonal dhe i integritetit të Ballkanit Perëndimor në UE. Për shembull, sipas Meurs dhe Yannis, PS dhe PSA nuk ishin një çift i përsosur meqë, strategjikisht, PS dhe PSA ishin të bazuara në parime kontraktuale të ballafaquara dhe këto bashkarisht nuk e dhanë një kornizë gjithëpërfshirëse për integrimin evropian. PS i jipte përparësi bashkëpunimit rajonal për stabilizim politik dhe ekonomik dhe për parandalimin e deficiteve strukturore si dhe të konflikteve në rajon. PSA e theksonte po ashtu domosdoshmërinë e bashkëpunimit rajonal, mirëpo, ky këtë bashkëpunimin e identifikonte si një mekanizëm të domosdoshëm dhe vendimtar për integrimin e rajonit në UE, në vend se për nevojat dhe specifikat zhvillimore të vendeve rajonale.<sup>48</sup> Përvojat e nxjerra nga zgjerimet paraprake të UE-së dëshmuuan që aksesioni në UE ka qenë një proces që në thelb e kishte shtetin në qendër, dhe që e kërkonte një kapacitet të fuqishëm rregullues dhe administrativ, njësoj si dhe përkrahjen vendëse të projektit të evropianizimit. Me qëllim që të përfitonin nga fondet dhe asistencë e UE-së, qeveritë e vendeve aplikuese duhej të mbështesnin programe shumë të mëdha të reformave.<sup>49</sup> Në këtë kuptim, "rajonalizmi, kur nxitet në një trajtë të përgjithshme si një qëllim në vetvete, mund ta kundërshtojë idenë e integritetit evropian dhe do të jetë sfidues për suksesin e PS, meqë procesi i aksesionit në UE

---

<sup>46</sup> The Stability Pact brochure, fq. 7.

<sup>47</sup> *Ibid.*

<sup>48</sup> Meurs, W. dhe Yannis, A., "The European Union and the Balkans: from Stabilisation Process to South Eastern Enlargement", *CEPS Europa South-East Monitor*, Issue 40, nëntor 2002, fq. 4.

<sup>49</sup> Kramer, Heinz, "The European Union in the Balkans: Another Step Towards European Integration," *Perceptions: Journal of International Affairs*, Vol. 5, No. 3, shtator - nëntor 2000, fq. 6.

është i përqendruar kryesisht në shtetin, dhe është bilateral.”<sup>50</sup> Prandaj, shtetet e Ballkanit Perëndimor me perspektivat më të mira të aksesionit ishin të brengosura që një rajonalizëm i padiferencuar mund t’i largonte nga premtimi i evropianizimit. Pos kësaj, procesi i aksesionit e promovonte integrimin në UE të vendeve rajonale përmes tregut të vet të brendshëm, që po ashtu ishte në konkurrencë me vetë logjikën e PS të bashkëpunimit rajonal, meqë tregjet e UE-së ishin pa dyshim më joshëse se tregu i brendshëm i rajonit i copëtuar nga lufta.<sup>51</sup>

Nga ana tjetër, Friis dhe Murphy i referohen nismave të UE-së pas krizës së Kosovës si ‘turbo-negociata’ në kuptimin që PSA duhet të konsiderohet si elementi thelbësor i kontribuimit të UE-së për Paktin e Stabilitetit. Sipas kësaj pikëpamjeje, vlen, po ashtu, edhe e anasjellta, që një bashkëpunim i rritur rajonal përmes Paktit të Stabilitetit do t’i përgatiste, edhe integrimin në UE, edhe standardet e anëtarësimit.<sup>52</sup> Sipas Bodo Hombach, zhvillimet dëshmuar që shqetësimi i hershëm për rivalitetin midis PS dhe PSA ka qenë i gabuar, dhe që PS nuk ka qenë rival, por plotësues i strategjive të UE-së në Ballkanin Perëndimor.<sup>53</sup> Pos kësaj, shumë çështje politike, shoqërore, ekonomike dhe të sigurisë, të tilla si mjedisi, tregtia, migrimi, terrorizmi dhe krimi i organizuar, nuk janë të kufizuara brenda kufijve shtetërorë, dhe mund të trajtohen në mënyrë të suksesshme vetëm përmes bashkëpunimit rajonal. Marrë në tërësi, mund të thuhet që kondicionaliteti bilateral dhe bashkëpunimi rajonal kishin objektiva strategjike të ndara, duke promovuar dimensione të veçanta, por njësoj të rëndësishme, për integrimin në UE dhe për stabilitetin e rajonit.<sup>54</sup>

Megjithatë, deri në vitin 2001, PSA u shndërrua në strategjinë udhëheqëse të UE-së në Ballkanin Perëndimor, gjë që e marginalizoi më tutje Paktin e Stabilitetit. Në vitin 2002, pas caktimit të Erhard Busek si Koordinator Special, Pakti i Stabilitetit u zvogëlua dhe i përgjithësoi prioritetet e veta. Si pasojë, Pakti u shndërrua në një plotësues të PSA. Kondicionaliteti i PSA u shndërrua në mekanizmin kryesor të integritit në UE, ndërkohë që PS e ndihmonte jetësimin e dimensionit rajonal të politikës së UE-së dhe e ruante një lloj ndërlidhjeje institucionale midis Ballkanit Perëndimor, nga njëra anë, dhe Rumanisë dhe Bullgarisë, nga tjetra.<sup>55</sup>

Megjithatë, duhet përmendur që arritja më e fuqishme e Paktit të Stabilitetit ishte vetëdija e shteteve për bashkëpunimin e ndërsjellë. Më tepër se dhjetë vjet pas fillimit të Paktit të Stabilitetit, duket sikur vendet e rajonit ishin më të vetëdijshme se pa stabilitet politik dhe ekonomik në rajon asnjëri nga vendet e veçanta nuk mund të jetë stabil. Vullneti dhe interesi për të marrë pjesë në zgjidhjen e problemeve rajonale sot janë më të pranishme dhe vendet e rajonit tregojnë një ndjeshmëri më të

---

<sup>50</sup> European Stability Initiative (ESI) and The East West Institute, “Democracy, Security and the Future of the Stability Pact for South Eastern Europe”, prill 2001, fq. 27. <http://www.esiweb.org> (29.08.2014).

<sup>51</sup> Meurs, W. dhe Yannis, A., fq. 5.

<sup>52</sup> Friis, L. dhe Murphy, A., “The European Union and Central and Eastern Europe: Governance and Boundaries,” *Journal of Common Market Studies*, Vol. 37, Issue 2, qershor 1999, fq. 218.

<sup>53</sup> Hombach, fq. 2.

<sup>54</sup> Meurs, W. dhe Yannis, A., fq. 5.

<sup>55</sup> Bechev, fq. 38.

madhe për çështjet dhe problemet rajonale.<sup>56</sup> Pakti formalisht u ndërpre në vitin 2008, me themelimin e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR), që nga Pakti i Stabilitetit e trashëgoi rolin e koordinatorit ndërmjet nismave të ndryshme rajonale. KBR i ka zyrat qendrore në Sarajevë, dhe aktualisht i ka rreth 46 organizata rajonale që veprojnë nën ombrellën e tij.<sup>57</sup>

## **2.4. Organizatat dhe nismat e tjera rajonale**

Pos organizatave rajonale tashmë të përmendura në nën-kapitujt e mëparshëm, në Gadishullin Ballkanik pas përfundimit të Luftës së Ftohtë është shfaqur edhe një bollëk nismash dhe organizatash rajonale. Këtu do të përqendrohemi shkurtimisht në më të rëndësishmet prej tyre që kanë të bëjnë me një shumëllojshmëri fushash të bashkëpunimit.

### **2.4.1. Nisma Bashkëpunuese e Evropës Juglindore (NBEJL)**

NBEJL është nismë rajonale e filluar nga SHBA-të, si përkrahje për zbatimin e Marrëveshjeve të Dejtonit. NBEJL është themeluar në dhjetor 1996 në sesionin inaugurues në Gjenevë, në bazë të “Pikave Finale të Kuptimit të Përbashkët UE-SHBA,” me qëllim të zhvillimit të një strategjie të qëndrueshme ekonomike në rajon. NBEJL është e përqendruar në programet dhe projektet e bashkëpunimit ndërkufitar, në fushat e zhvillimit të infrastrukturës, të çështjeve të tregtisë dhe të trafikut, të sigurisë, energjisë, mjedisit dhe të zhvillimit të sektorit privat.

Të gjitha programet e NBEJL janë duke u zbatuar nga ekspertët e shteteve anëtare dhe shteteve që e përkrahin këtë Nismë, me përkrahjen teknike të Komisionit Evropian, të Komisionit Ekonomik për Evropë të KB (KEE/KB), të Bankës Botërore, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Bankës Investuese Evropiane, Organizatës Botërore të Doganave, dhe, deri në një masë, të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Po ashtu, NBEJL bashkëpunon ngushtë me Paktin e Stabilitetit, Nismën e Evropës Qendrore, Organizatën e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi, agjencionet dhe programet e specializuara të KB dhe me organizatat e tjera.

Trupi kryesor brenda NBEJL është Komiteti i Programeve që përbëhet nga koordinatorët kombëtarë të Vendeve Anëtare. Komiteti për Programe i përcakton prioritetet e veprimtarisë së vet në bazë të metodave të vendosura të punës të përvetësuar më 29 janar 1997. Aktualisht, vendet anëtare të NBEJL janë: Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Hungaria, Moldavia, Maqedonia, Rumania, Sllovenia, Serbia, Turqia dhe Mali i Zi. Pos kësaj, janë disa vende dhe organizata ndërkombëtare që e kanë statusin e vëzhguesit.<sup>58</sup> Qëllimet kryesore të NBEJL janë: eliminimi i pengesave administrative dhe të tjera me qëllim të rritjes së efektshmërisë së rrjedhjes së

---

<sup>56</sup> Svilanovic, Goran. "Regional Cooperation in the Western Balkans: Today and in the Future," Public Debate, Skopje, 28 nëntor 2007. <http://www.fes.org.mk/eng/2007svilanovikeng.asp> (23.07.2014).

<sup>57</sup> Për më tepër hollësi lidhur me organizatat e ndryshme rajonale që veprojnë nën ombrellën e KBR si dhe për strukturat e tyre të brendshme, shih uebsajtin e tij zyrtar <http://www.rcc.int/>.

<sup>58</sup> Për më tepër hollësi shih uebsajtin zyrtar të NBEJL-së <http://www.secinet.org>.

të mirave dhe të tregtisë së përmirësuar, identifikimi i grykave të ngushta në korridoret kryesore ndërkombëtare të trafikut, krijimi i rrjeteve të gupave dhe të ndërlidhjeve të tyre me gypat ndërkombëtarë, ofrimi i fondeve për përparimin e ndërmarrësisë, kryesisht përmes projekteve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, etj.

Si pjesë e veprimtarive të tërësishme në rregullimin e funksionimit normal të bashkëpunimit ndërkufitar, brenda NBEJL-së është zhvilluar edhe bashkëpunimi në fushën e luftimit të krimin trans-kufitar. Për këtë qëllim, më 26 maj 1999 në Bukuresht është nënshkruar po ashtu “Marrëveshja mbi Bashkëpunimin për Parandalimin dhe Luftimin e Krimin Trans-Kufitar.” Në të njëjtën kohë u nënshkrua edhe “Karta e Qendrës Rajonale të NBEJL-së për Luftimin e Krimin Trans-Kufitar.” Marrëveshja e ofron bashkëpunimin midis shteteve anëtare në parandalimin, zbulimin, hetimin, ndjekjen dhe sanksionimin e krimin trans-kufitar. Në këtë kontekst, janë paraparë forma të bashkëpunimit të veçantë midis trupave të shteteve anëtare (informata, shkëmbimi i të dhënave, mbrojtja e të dhënave personale, parashtrimi i kërkesave, etj.). Është themeluar Komiteti i Bashkëpunimit të Ndërsjellë, si trupi kryesor për jetësimin e Marrëveshjes. Pos përfaqësuesve të vendeve anëtare, në këtë Komitet janë të përfshirë edhe përfaqësuesit e Interpolit dhe të Organizatës Botërore të Doganave (OBD) si “këshilltarë të përherëshëm.” Çdo vend në këtë Komitet përfaqësohet përmes dy zyrtarëve: një përfaqësuesi i doganave dhe një i policisë.

#### **2.4.2. Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore (PBEJL)**

Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore (PBEJL) u themelua në vitin 1996 në bazë të “Konferencës për Stabilitet, Siguri dhe Bashkëpunim në Evropën Juglindore.” PBEJL u fillua në vitin 1996 me synim të transformimit të Evropës Juglindore në një rajon të stabilitetit, sigurisë dhe bashkëpunimit, në pajtim me proceset integruese evropiane dhe përmes promovimit të dialogut dhe bashkëpunimit të ndërsjellë në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat e interesit të përbashkët. Dokumenti kryesor i Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore është Karta për Marrëdhënie të Mira Fqinjësore, për Stabilitet, Siguri dhe Bashkëpunim në Evropën Juglindore, e përvetësuar në Bukuresht në vitin 2000. Karta është amendamentuar në Samitin e Zagrebit të PBEJL-së, që u mbajt më 11 maj 2007, me qëllim të përkufizimit të marrëdhënive midis PBEJL-së dhe Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal.

PBEJL i bën bashkë Shqipërinë, Bosnjen e Hercegovinën, Bullgarinë, Republikën e Maqedonisë, Rumaninë, Serbinë, Greqinë, Kroacinë, Turqinë, Moldavinë dhe Malin e Zi, ndërkaq, Kosova është “përfshirë zyrtarisht” si një jo-anëtare.<sup>59</sup> PBEJL e paraqet një simbol të vullnetit të përbashkët të vendeve të rajonit për ta përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet veti dhe për ta sjellur një stabilitet të qëndrueshëm në Evropën Juglindore. PBEJL është organizuar në mënyrë të pavarur nga vetë vendet e Ballkanit, dhe si i tillë ky është i vetmi forum i bashkëpunimit i Ballkanit në rajon. Në këtë kuptim, PBEJL mund të përmendet si pranues politik i modeleve ballkanike të bashkëpunimit të viteve 1930, 1950 dhe 1980. Përndryshe, qëllimet themelore të bashkëpunimit rajonal brenda PBEJL përfshijnë

---

<sup>59</sup> Për më tepër hollësi shih uebsajtin zyrtar të PBEJL-së, <http://www.rspcsee.org>.



fuqizimin e sigurisë dhe të situatës politike, intensifikimin e marrëdhënieve ekonomike dhe të bashkëpunimit në fushat e resurseve njerëzore, të demokracisë, drejtësisë dhe të luftës kundër veprimtarive ilegale. Një synim tjetër i PBEJL është që anëtarëve të vet t'u mundësojë qasjen në strukturat evropiane dhe euro-atlantike përmes fuqizimit të marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe transformimit të rajonit në një zonë të paqes dhe të stabilitetit.

Veprimtaritë e PBEJL bëhen në Samitet e Krerëve të Shteteve dhe të Qeverive, në Takimet e Ministrave të Jashtëm, si dhe në nivelin e Drejtorëve Politikë të Ministrive të Jashtme të shteteve pjesëmarrëse të kësaj nisme. Mbahen, po ashtu, edhe Takimet e Trojkës, si një trup permanent koordinues që përbëhet nga vendi kryesues i tashëm, i kaluar, dhe i ardhshëm. Nga ana tjetër, dimensionin parlamentar i PBEJL bëhet përmes bashkëpunimit brenda Grupit Punues të dimensionit parlamentar të PBEJL, ku marrin pjesë, po ashtu, edhe përfaqësuesit e Kuvendeve Kombëtare të të gjitha shteteve anëtare. Aktualisht, Rumania e ka marrë Presidencën e PBEJL-së për periudhën 2013-2014, ndërkohë që Shqipëria do ta kryesojë PBEJL-në në periudhën 2014-2015.

### **2.4.3. Nisma e Evropës Qendrore (NEQ)**

Nisma e Evropës Qendrore e ka zanafillën nga takimi që u mbajt në Budapest në vitin 1989 kur u krijua Kuadrangonja, si një nismë e përbashkët e Italisë, Austrisë, Hungarisë dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ). Fillimisht, kjo organizatë e kishte synimin e tejkalimit të ndarjes në dy blloqe evropiane përmes rivendosjes së lidhjeve të bashkëpunimit ndërmjet vendeve me orientime të ndryshme politike dhe me struktura të ndryshme ekonomike. Me 18 anëtarët e vet aktual, NEQ është forumi më i madh dhe më i vjetër i bashkëpunimit rajonal në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore. 18 shtetet e sotme anëtare të NEQ-së i përfshijnë Austrinë, Shqipërinë, Bellorusinë, Bosnjen e Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, Republikën Çeke, Italinë, Hungarinë, Maqedoninë, Moldavinë, Poloninë, Rumaninë, Republikën Sllovaqe, Slloveninë, Serbinë, Ukrainën dhe Malin e Zi.<sup>60</sup> Është e qartë që anëtarësia e saj e paraqet një përzierje të nëntë anëtarëve të UE-së dhe të nëntë vendeve të tjera që nuk janë anëtare të UE-së, gjë kjo që këtë nismë e bën posaçërisht të rëndësishme në procesin e përsheptimit të integritit evropian të vendeve jo-anëtare të UE-së.

Rrjedhimisht, qëllim strategjik dhe themel i të gjitha veprimtarive të NEQ është “bashkëpunimi rajonal për integrimin evropian.” Zhvillimi i një bashkëpunimi cilësor dhe të orientuar kah projektet e inkurajon një përvetësim më të shpejtë të standardeve të UE-së, dhe krijon parakushte për një integrim të plotë në UE të shteteve anëtare të NEQ që nuk janë anëtare të tij. Me synim të fuqizimit të procesit të integritit evropian të të tërë rajonit, një nga prioritetet kryesore është bashkëpunimi me Unionin Evropian dhe krijimi i kushteve për nënshkrimin e marrëveshjes së veçantë midis NEQ dhe Komisionit Evropian. Përndryshe, veprimtaritë e NEQ janë të përqendruara kryesisht në realizimin e projekteve konkrete të bashkëpunimit në rajon. Këto kryhen në bazë të Planit të Veprimit të NEQ për një periudhë të caktuar kohore, dhe atë në fushat në vijim: zhvillimi ekonomik (klima, mjedisi, energjia, NVM-të, turizmi, transporti multimodal, bujqësia e qëndrueshme), zhvillimi

---

<sup>60</sup> Për më tepër hollësi shih uebsajtin zyrtar të NEQ, <http://www.cei.int>.

i potencialeve njerëzore (resurset njerëzore, shoqëria e informatës dhe mediave, bashkëpunimi ndërkulturor dhe minoritetet, shkenca dhe teknologjia) dhe bashkëpunimi ndër-rajonal ndër-kufitar. Pikat fokale të NEQ (ekspertët nga shtetet anëtare të NEQ) kanë rol vendimtar në përzgjedhjen e projekteve të cilësisë së lartë.

Duhet përmendur që NEQ vepron nën sistemin e presidencës rotative vjetore, ku tash atënë e kryeson Hungaria, ndërsa Austria do ta merr presidencën më 2014. Përndryshe, NEQ vepron përmes strukturave të ndryshme: Takimi Vjetor i Krerëve të Shteteve (Samiti i NEQ); Takimi Vjetor i Ministrave të Punëve të Jashtme (Takimi i MPJ); Takimet e rregullta të Komitetit të NEQ të Koordinatorëve Kombëtarë (KKK). KKK, që përbëhet nga përfaqësuesit e Ministrive të Jashtme të të gjitha shteteve anëtare, është trupi përgjegjës për menaxhimin e bashkëpunimit të NEQ dhe për implementimin e programeve dhe projekteve të NEQ-së. Takimet e Koordinatorëve Kombëtarë të NEQ mbahen disa herë në vit, ndërkohë që takimet e tjera mbahen vetëm kur të jetë nevoja. Bashkëpunimi parlamentar bëhet në kuadrin e kornizës së Dimensionit Parlamentar të NEQ (takimet e Komitetit Parlamentar dhe të Kuvendit Parlamentar). Duke e marrë statusin e vëzhguesit në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (në vitin 2011), NEQ e ka përmirësuar në një mënyrë domethënëse prestigjin e vet të tërësishëm dhe e ka forcuar rolin e vet si një faktor i integritit dhe stabilizimit në rajon dhe përtej tij.

NEQ, për dallim nga shumica e nismave të tjera, i ka fondet e veta për financimin apo bashkëfinancimin e projekteve të bashkëpunimit. Pos kontributeve të rregullta vjetore të shteteve anëtare, veprimtaritë e NEQ financohen nga një fond i veçantë, Fondi i NEQ në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), që përkrahet në tërësi nga Italia në vlerë prej përafërsisht 2 milion Euro në vit, si dhe nga donacione të tjera nga Italia dhe Austria, dhe, herë pas here, nga disa donacione të vogla të shteteve të tjera anëtare të NEQ (për ta përkrahur Programin Shkëmbyes të Përvetësimit të Aftësive). Rrjedhimisht, me një bashkëpunim të fuqishëm, dhe me përkrahjen financiare të Komisionit Evropian dhe të EBRD-së, ndikimi i tërësishëm financiar përmes implementimit të projekteve është shumë më i lartë.

#### **2.4.4. Nisma e Adriatik-Jonit (NAJ)**

Nisma e Adriatik-Jonit (NAJ) ishte e para që u nis në Konferencën e Ankonës për “Zhvillim dhe Siguri në Detet e Adriatikut dhe të Jonit,” që u mbajt në maj të vitit 2000 dhe u ndjek nga Kryeministrat dhe Ministrat e Punëve të Jashtme të gjashtë vendeve bregdetare (Shqipëria, Bosnia e Hercegovina, Kroacia, Greqia, Italia dhe Sllovenia). Në fund të Konferencës, Ministat e Punëve të Jashtme e përvetësuan “Deklaratën e Ankonës,” në praninë e Presidentit të Komisionit Evropian, duke e konfirmuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal si një mjet për ta forcuar stabilitetin ekonomik dhe politik të domosdoshëm për integrimin evropian. Në vitin 2002, Serbia dhe Mali i Zi iu bashkangjitën gjashtë anëtarëve të parë. Pas shpërbërjes së unionit të tyre në vitin 2006, që të dyjat e mbajtën anëtarësinë e tyre në Nismë, anëtarësia e të cilës tash përbëhet nga tetë anëtarë.<sup>61</sup>

<sup>61</sup> Për më tepër hollësi shih uebsajtin zyrtar të NAJ, <http://www.aii-ps.org>.

Trupi më i lartë i Nismës së Adriatik-Jonit është Këshilli i Ministrave të Jashtëm që takohet në baza vjetore. Komiteti i Zyrtarëve të Lartë i koordinon veprimtaritë e NAJ dhe i përgjatit takimet e Këshillit të saj. Komiteti i Zyrtarëve të Lartë takohet ashtu siç e shih të përshtatshme, ndërkohë që vendimet merren me konsensus. NAJ është aktive në sektorë të ndryshëm të bashkëpunimit rajonal, dhe në veçanti përmes tryezave të rrumbullakëta teknike që përcillen nga ekspertë që vijnë nga çdo vend anëtar: (1) Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; (2) Transporti dhe bashkëpunimi detar; (3) Turizmi, kultura dhe bashkëpunimi ndëruniversitar; dhe, (4) Mjedisi dhe mbrojtja nga zjarri.

Qëllim i nismës është bashkëpunimi midis anëtarëve të vendosur përgjatë detrave Adriatik dhe Jon në zhvillimin dhe sigurinë e të tërë rajonit. Kjo po ashtu i jep nxitje vendeve pjesëmarrëse për shkëmbimin e pikëpamjeve dhe të njohurive, për përcaktimin e interesave të përbashkëta, për përkrahjen e një bashkëpunimi më intensiv me UE-në dhe me nismat e tjera rajonale, për forcimin e paqes dhe të sigurisë, dhe për ngurtësimin e stabilitetit rajonal. Me qëllim të zhvillimit dhe forcimit të rrjetit të integruar të aktorëve të aftë për të punuar në koordinim drejt zhvillimit të pellgut të Adriatik-Jonit, një nga prioritetet e Presidencës Italiane ishte t'i ndihmonte marrëdhëniet e NAJ-së me organizatat e tjera rajonale që punonin në Evropën Qendrore dhe Juglindore, të tilla si Nisma e Evropës Qendrore (NEQ), si dhe me organizatat dhe aktorët e tjerë rajonalë që punonin jashtë Evropës Juglindore, por që e kishin të përbashkët me NAJ-në interesin e bashkëpunimit rajonal. Është nisur një bashkëpunim i fuqizuar me Këshillin e Shteteve të Detit Baltik (KSHDB), bazuar në interesin e përbashkët në mjedisin bregdetar dhe detar. Në këtë aspekt, Presidenca Italiane ka bërë përpjekje për të themeluar lidhje për bashkëpunim dhe ndërveprim midis këtyre dy organizatave.

Shumë vite pas themelimit të Nismës së Adriatik-Jonit mjedisi gjeopolitik përreth është ndryshuar rrënjësisht. Në veçanti, në mesin e të gjitha vendeve pjesëmarrëse, Sllovenia në vitin 2004, dhe Kroacia në vitin 2013, hynë në UE, ndërkohë që vendet e tjera në anën lindore të Adriatik-Jonit (Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia), edhe pse me korniza kohore dhe kushte të ndryshme, janë duke iu afruar dalëngadalë UE-së në kuadrin e kornizës së Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit, si një hyrje në anëtarësimin e ardhshëm në UE. Pavarësisht nga këto ndryshime, shkaqet që kanë qenë në themel të krijimit të NAJ-së ende këmbëngulin, dhe këto me kalimin e kohës janë bërë madje edhe më të fuqishme. Ndërvarshmëria e rritur ndërmjet shteteve, e ndërlikuar me proceset e globalizimit dhe me nevojën për të ofruar zgjidhje të përbashkëta për problemet e përbashkëta që e ndikojnë rajonin e Adriatikut, kërkon veprim të koordinuar jo vetëm ndërmjet vendeve rajonale, por, po ashtu, edhe ndërmjet nismave rajonale. Kështu, bashkëpunimi dalëngadalë ka marrë trajta të ndryshme, përfshirë themelimin e partneriteteve që i përfshijnë rrjetet dhe forumet e Adriatik-Jonit, të tilla si Forumi i Odave të Tregtisë të Adriatik-Jonit, Forumi i Qyteteve të Adriatik-Jonit, dhe UniAdriac-i (Rrjeti i Universiteteve të Adriatik-Jonit).

#### 2.4.5. Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ)

Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi u themelua më 25 qershor 1992, kur krerët e shteteve dhe të qeverive të njëmbëdhjetë vendeve: Shqipërisë, Armenisë, Azerbaixhanit, Bullgarisë, Gjeorgjisë, Greqisë, Moldovës, Rumanisë, Rusisë, Turqisë dhe Ukrainës, e nënshkruan në Stamboll Deklaratën e Samitit dhe Ekspozenë e Bosforit. Kjo u krijua si një model unik dhe premtues i nismës multilaterale politike dhe ekonomike që synonte forcimin e ndërveprimit dhe të harmonisë ndërmjet shteteve anëtare, si dhe sigurimin e paqes, stabilitetit dhe prosperitetit, duke i inkurajuar marrëdhëniet miqësore dhe të mira fqinjësore në rajonin e Detit të Zi. Republika e Serbisë iu bashkangjiti Organizatës si shtet anëtar në vitin 2004, ndërkohë që statusin e vëzhguesit në kuadrin e Organizatës e kanë vendet në vijim: Egjipti, Austria, Bellorusia, Kroacia, Republika Çeke, Franca, Gjermania, Izraeli, Italia, Polonia, Sllovakia, Tunizia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Unioni Evropian është njëra ndër një mori organizatash ndërkombëtare që e kanë të njëjtin status. Nga ana tjetër, Hungaria, Irani, Jordania, Japonia, Korea e Jugut, Mali i Zi, Sllovenia dhe Mbretëria e Bashkuar, si dhe disa organizata ndërkombëtare në BEDZ, e kanë statusin e partnerit të pjesshëm të dialogut.<sup>62</sup>

BEDZ synon ta mbajë rajonin e Detit të Zi si një zonë stabile dhe prosperuese përmes bashkëpunimit multilateral ekonomik ndërmjet shteteve anëtare. Organizata e mbulon një zonë gjeografike me afër 20 milionë kilometra katrorë, përfshirë Detin e Zi, Ballkanin dhe vendet e Kaukazit, që janë në dy kontinente dhe që e përfaqësojnë një rajon me rreth 350 milionë njerëz. Zona e BEDZ, që është e pasur me naftë dhe gaz, si dhe me resurse të tjera natyrore, ka qenë një nga korridoret kryesore të transportit dhe të kalimit të energjisë. Kapaciteti i tregtisë së jashtme ndërmjet shteteve anëtare është mbi 300 miliardë dollarë amerikanë në vjet. Përndryshe, Zyra Qendrore e BEDZ – Sekretariati Permanent Ndërkombëtar i Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ PERMIS) – u themelua në mars të vitit 1994 në Stamboll. Pas Sekretariatit të vet, BEDZ-ja i ka katër trupa të tjerë – Asambleenë Parlamentare (APBEDZ), Bankën e Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim (BDZTZH), Këshillin e Biznesit, dhe Qendrën Ndërkombëtare për Studimet e Detit të Zi (QNSDZ).

Prioritetet e BEDZ, ashtu siç janë të dhëna në Kartën e saj, i formulojnë fushat e bashkëpunimit, si tregtinë dhe zhvillimin ekonomik, veprimtaritë bankare dhe financat, komunikimet, energjinë, transportin, bujqësinë dhe industrinë bujqësore, shëndetësinë dhe farmacinë, mbrojtjen e mjedisit, turizmin, shkencën dhe teknologjinë, shkëmbimin e të dhënave statistikore dhe të informatave ekonomike, drogat, importimin ilegal të armëve dhe të materialeve radioaktive, terrorizmin dhe emigrimin ilegal, zhdukjen e pasojave të urgjencave, bizneset e vogla dhe të mesme, edukimin, ripërtëritjen institucionale dhe qeverisjen e mirë.

---

<sup>62</sup> Për më tepër hollësi, shih uebsajtin zyrtar të BEDZ, <http://www.bsec-organization.org>.

#### 2.4.6. Partneriteti i Kartës së Adriatikut

Karta SHBA-Adriatiku, një nismë kjo në frymën e Kartës SHBA-Baltiku të vitit 1998, iu propozua bashkarisht, nga Presidentët e Shqipërisë, Kroacisë dhe të Maqedonisë, Presidentit Bush në Samitin e NATO-s në Pragë, në nëntor 2002, dhe u nënshkrua nga katër ministrat e punëve të jashtme në Tiranë, më 2 maj 2003.<sup>63</sup> Si projekt diplomatik kjo Kartë i kishte dy qëllime – ta sigurojë politikën e derës së hapur të NATO-s, dhe ta ofrojë një mekanizëm të ri për bashkëpunimin ndërmjet tre vendeve të Ballkanit për ta arritur qëllimin e tyre të përbashkët – vazhdimin e bashkëpunimit trilateral të mbrojtjes, dhe pranimin në NATO.<sup>64</sup> Në takimin e parë të Komisionit të Partneritetit, që u mbajt më 14 nëntor 2003 në Washington, pala shqiptare e propozoi “Planin e Veprimit,” dhe ajo maqedone “Planin e Bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes për 2004,” ku që të dyjat i harmonizojnë veprimtaritë konkrete në sektorin e mbrojtjes: krijimin e Qendrës rajonale për operacionet paqësore në Krivollak, manovrat ushtarake të përbashkëta brenda territorit të vendeve nënshkruese, përgatitjen e njësive të përbashkëta për operacionet e përkrahjes së paqes dhe për misionet paqeruajtëse, konsultimet për politikën e sigurisë dhe të mbrojtjes, shkëmbimin e elementeve të trajnimit ushtarak, bashkëpunimin ushtarako-teknik dhe kontrollin e armatimeve. Në takimin e Komisionit të Partneritetit që u mbajt në Shkup në mars të vitit 2004, u miratua një Plan i ri Aksional për bashkëpunim, që i paraprinte takimeve dhe konferencave për diplomacinë publike që do të përfshinin kryesuesit e komiteteve parlamentare të politikave të jashtme, ministrat e mbrojtjes, drejtorët politikë të ministrive të jashtme dhe ekspertët e NATO-s, si dhe takimet për parandalimin e shumëzimit të armëve të shkatërrimit në masë. Në çdonjërin nga këto takime janë shkëmbyer dhe diskutuar përvojat për reformat e mbrojtjes, si dhe çështjet që kishin të bënin me procedurat legjislative, dhe u bënë konsultime të intensifikuara të përbashkëta me vendet rajonale anëtare të NATO-s (Italia, Sllovenia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Greqia dhe Turqia).<sup>65</sup> Më 4 dhjetor 2008, gjatë takimit ministror të OSBE-së në Helsinki, Kartës së Adriatikut iu bashkangjiten Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina, dhe, më pas, këto pesë vende anëtare shpesh herë referoheshin si vendet A-5. Pos kësaj, Serbia i ka ndjekur konferencat e Kartës në statusin e vëzhguesit në nivelin ministror dhe në nivelin e Komandantëve të Gjeneralstabeve.

Në pjesën e vet që ka të bëjë me integrimet euro-atlantike, Karta e shpalos një qëllim të qartë të tre vendeve për ta arritur “integrimin e plotë në institucionet evropiane dhe trans-atlantike ekonomike, të sigurisë dhe të mbrojtjes,” meqë këto besojnë që Evropa nuk mund të jetë “e lirë përderisa Evropa Juglindore të mos bëhet e sigurtë.” Pritjet e tilla të përbashkëta mbështeten nga pikëpamja që SHBA-të “i përkrah aspiratat dhe përpjekjet e Shqipërisë, Kroacisë dhe të Maqedonisë për të qenë të integruara,” edhe pse me një kusht që kjo do të ndodhë vetëm kur këto “të bëhen të afta ta marrin përgjegjësinë për anëtarësi dhe të bëhen të gatshme t’i mbrojnë vlerat demokratike që mbrohen edhe

---

<sup>63</sup> Si nënshkruese të Kartës së Adriatikut, Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia rëndom janë referuar si vendet A-3.

<sup>64</sup> Grdesic, Ivan, “US-Adriatic Charter of Partnership: Securing the NATO Open Door Policy,” *Politička misao*, Vol. XLI, No. 5, 2004, fq. 104.

<sup>65</sup> Ničić, Blagoje, “The Adriatic Charter – Cooperation, Integration, Stability,” *Centre for Civil-Military Relations*, Belgrade, 02 shkurt 2005, fq.1.

nga vetë Aleanca.”<sup>66</sup> Partneriteti i Kartës së Adriatikut e ka krijuar një kornizë institucionale që ka ndihmuar në rritjen e dukshmërisë së rajonit dhe e ka krijuar një mekanizëm për përfshirjen e drejtpërdrejtë të Qeverisë së SHBA në çështjet e saj, meqë këto tre vende punojnë bashkë në implementim dhe në veprimtari. Jeta e freskët në këtë partneritet e ka përtëritur përkushtimin e këtyre vendeve për ta arritur integrimin e plotë në komunitetin Euro-Atlantik. Ky e ka ofruar një mjet të ri për këto kombe si evropianë bashkëkohorë të shekullit njëzetënjë, ta vëjnë në jetë besimin e tyre të sinqertë që diskursi qytetar dhe mjetet paqësore mund ta zgjidhin çdonjërin nga dallimet e tyre.<sup>67</sup>

### 3. RRUGA E KOSOVËS DREJT PJESËMARRJES RAJONALE

#### 3.1. Anëtarësia nën Administratën e UNMIK-ut

##### HYRJE

Shkatërrimi i ish-Jugosllavisë u vijua nga luftrat e përgjakshme në Kroaci, Bosnje e Hercegovinë dhe në Kosovë. Gjatë viteve 1990 Kosova në kuptimin e plotë të fjalës nuk kishte kurfarë pjesëmarrje rajonale, meqë autonomia e saj ishte shfuqizuar, dhe shumica e popullatës së saj jetonte në një *de facto* apartheid. E tërë struktura e administrimit rajonal ishte shpërbërë, dhe shqiptarët praktikisht përnjëherësh u përjashtuan nga vendet e tyre të punës, dhe atyre iu mohua arsimimi në gjuhën e tyre, dhe iu nënshtruan një abuzimi masiv të të drejtave të tyre njerëzore dhe të lirive të tyre qytetare.<sup>68</sup> Ashtu siç e vë në dukje Maliqi, Kosova u shndërrua në një *de facto* koloni të Serbisë, ku 90 përqind të popullatës së saj (shqiptarët) sundoheshin nga më pak se 10 përqind (serbët).<sup>69</sup>

Shqiptarët në Kosovë e kishin të qartë që jeta e tyre nën sundimin serb ishte bërë e pamundur, kështu që, të udhëhequr nga Ibrahim Rugova, ata u futën në një fushatë paqësore për ta fituar të drejtën e tyre për vetëvendosje.<sup>70</sup> Mirëpo, kjo politikë e mosdhunës nuk u shpërblye nga bashkësia ndërkombëtare. Duke e parë si mesazh të vetëm kryesor të Dejttonit atë që bashkësia ndërkombëtare e kuptonte vetëm gjuhën e konfliktit të armatosur, nga viti 1997 dhuna në Kosovë u rrit në një mënyrë domethënëse. Derdhja e armëve të lehta në Kosovë, pas trazirave të dhunshme shoqërore

---

<sup>66</sup> Karta e Adriatikut, Komunikatë për shtyp e Departamentit të Shtetit për Kartën e Adriatikut të nënshkruar nga Shtetet e Bashkuara, Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia, Tiranë, 2 maj, 2003.

<http://www.uspolicy.be/Article.asp?ID=7E0CDD76-790B-4031-978A-AB198EA78CCA> (14.07.2014)

<sup>67</sup> Tarifa, Fatos, “The Adriatic Europe: Albania, Croatia, and Macedonia,” *Mediterranean Quarterly*, Vol. 16, No.4, Vjeshtë 2005, fq. 17.

<sup>68</sup> Shfuqizimi i autonomisë së Kosovës u vijua me vargje të tëra dekretesh legale që vlenin vetëm për territorin e Kosovës, që shqiptarët e Kosovës i privuan nga shumë nga të drejtat themelore njerëzore. Këto i përfshinin Dekretin për Marrëdhëniet e Punës nën Rrethanat e Veçanta, Dekretin mbi Edukimin, dhe Dekretin që i Kufizonte Transaksionet e Pronës së Patundshme. Si pasojë, nga 170.000 shqiptarë të punësuar në sektorin publik, 115.000 u dëbuan nga buna. Dekreti i Edukimit përjashtoi praktikisht pothuaj gjysmë milion shqiptarë të rinj nga sistemi edukativ shtetëror; shih, Muhamedin Kullashi, “Kosovo and Disintegration of Yugoslavia,” në, Dusan Janjic dhe Shkelzen Maliqi, red., *Conflict or Dialogue: Serbian-Albanian Relations and Integration of the Balkans*, Subotica: Open University, 1994, fq. 183.

<sup>69</sup> Maliqi, Shkelzen, *Kosova: Separate Worlds*. Prishtinë: Dukagjini, 1998, fq. 43.

<sup>70</sup> Demjaha, “Kosovo: A perspective from inside,” fq. 33.

në Shqipëri, e kombinuar me një shembje të plotë të ligjit dhe të rendit, e ndihmuan shfaqjen e UÇK-së, një forcë e fshehtë guerile kjo, që e ndiqte strategjinë e sulmeve në stacionet e policisë dhe të vrasjeve të zyrtarëve serbë, të policëve, dhe të bashkëpunëtorëve shqiptarë të regjimit serb.<sup>71</sup> Autoritetet serbe reagues me sulme policore, gjykime politike, dhe me mizori të skajshme. Midis marsit dhe tetorit të vitit 1998 pothuaj 2.000 shqiptarë ishin vrarë, shumë shtëpi, punishte dhe shkolla ishin shkatërruar, dhe gati 400.000 qytetarë shqiptarë ishin detyruar t'i braktisnin shtëpitë e tyre.<sup>72</sup>

Duke qenë dëshmitare e rrjedhës së refugjatëve në vendet fqinje, dhe duke iu frikësuar shkapërderdhjes së luftës së Kosovës jashta saj, bashkësia ndërkombëtare i caktoi negociatat në shkurt në Kështjellën e Rambujesë në Francë. Përballë dhunës së vazhdueshme serbe, në një situatë kur vetëm shqiptarët e kishin nënshkruar marrëveshjen paqesore, në orët e hershme të 24 marsit 1999, NATO-ja i nisi sulmet e para ajrore kundër caqeve në Kosovë, dhe më pas edhe në Serbi. Pas 78 ditësh të fushatës së vazhdueshme ajrore të NATO-s kundër Republikës Federale të Jugosllavisë, më 10 qershor 1999, nën një rrezik gjithnjë e më të madh të vendosjes së trupave tokësore të NATO-s, përfaqësuesit e Ushtrisë Jugosllave dhe të NATO-s e nënshkruan Marrëveshjen Ushtarake-Teknike për tërheqjen e trupave jugosllave nga Kosova, gjë kjo që e përfundoi luftën.<sup>73</sup>

Në bazë të Rezolutës 1244 të 10 qershorit 1999 dhe të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të 12 qershorit (S/1999/672), Forca e udhëhequr nga NATO-ja (KFOR) e vendosi praninë e vet në krahinën e dërrmuar nga lufta. Nga ana tjetër, në bazë të po të njëjtës Rezolutë, u themelua, po ashtu, edhe Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), që synonte ta administronte Kosovën pa e paragjykuar statusin e saj të jashtëm.<sup>74</sup> Për herë të parë në histori, KB iu dha një mandat i paprecedent, si për nga shtrirja, ashtu edhe për nga kompleksiteti struktural, për ta zëvendësuar rolin e shtetit. Rezoluta 1244 e ngriti UNMIK-un, dhe këtë e thërriste që: t'i kryej funksionet themelore civile administrative, ta promovojë themelimin e një autonomie përmbajtësore dhe të vetëqeverisjes së Kosovës, ta ndihmojë procesin politik për ta përcaktuar statusin e ardhshëm të Kosovës, ta koordinojë ndihmën humanitare dhe atë të fatkeqësive të të gjitha agjencioneve ndërkombëtare, ta përkrahë rindërtimin e infrastrukturës kyçe, ta mbajë ligjin dhe rendin civil, t'i promovojë të drejtat njerëzore, dhe ta sigurojë kthimin e sigurtë dhe të papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur nëpër shtëpitë e tyre në Kosovë.<sup>75</sup> Marrë në tërësi, sa i përket shtrirjes dhe synimeve, mandati i UNMIK-ut ishte pothuaj i paprecedent sipas të gjitha standardeve të operacioneve të KB në terren. Jo vetëm që ky ishte autorizuar ta merrte të tërë

---

<sup>71</sup> Calic, fq. 28.

<sup>72</sup> Shih, për shembull, disa nga numrat e tetorit të vitit 1998 të gazetës ditore kosovare në gjuhën shqipe, Koha Ditore, dhe raportet nga zyra e UNHCR në Prishtinë të botuara gjatë kësaj periudhe.

<sup>73</sup> Benson, fq. 177.

<sup>74</sup> "Administration and Governance in Kosovo: Lesson learned and lessons to be learned," Prishtinë-Gjenevë: Kosovar Institute for Policy Research and Development, qershor 2005, fq. 1.

<sup>75</sup> United Nations Security Council, Resolution 1244, 1999.

përgjegjësinë kalimtare administrative mbi territorin e Kosovës, por këtij i ishte dhënë, po ashtu, edhe roli qendror politik në zgjidhjen e konfliktit.<sup>76</sup>

Nën strukturën e UNMIK-ut, korniza vepruese ishte e ndarë në katër shtylla të udhëhequra nga agjencione të ndryshme ndërkombëtare që për herë të parë vepronin si qeveri, dhe e kishin një shkallë të lartë të autonomisë në krijimin dhe zbatimin e politikave. Shtylla humanitare e udhëhequr nga UNHCR u nis në qershor 2000. Pas riorganizimit në maj 2001, Shtyllat Një dhe Dy, që përbëheshin nga administrata civile, policia dhe drejtësia, udhëhiqeshin drejtpërdrejtë nga UNMIK-u, ndërkohë që rindërtimi ekonomik ishte nën jurisdiksionin e UE-së, ndërsa ndërtimi i institucioneve i ishte caktuar OSBE-së. Në maj të UNMIK-ut ishte Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, që gjithnjë njihej si PSSP.<sup>77</sup>

### 3.2. Pjesëmarrja rajonale në UNMIK-un

Pos të gjitha përgjegjësitë të përmendura më sipër, në kuadrin e mandatit të vet për ta çuar përpara stabilitetin rajonal në Ballkanin Perëndimor, UNMIK-u u angazhua, po ashtu, për marrëdhëniet bilaterale dhe për pjesëmarrjen rajonale në emër të Kosovës. Mes tjerash, kjo ishte, po ashtu, në pajtim me qëllimin e UE-së për të siguruar që Kosova të shndërrohet në një partner të besueshëm, që do të shkonte së bashku me pjesën tjetër të rajonit drejt UE-së. Rrjedhimisht, elementet kyçe që UNMIK-u ishte duke u përpjekur t'i arrinte ishin krijimi i një Kosove demokratike dhe multi-etnike me një bazë të shëndoshë për zhvillim ekonomik dhe integrim më të madh në rajon. Duke filluar nga gjysma e parë e vitit 2000, UNMIK-u u angazhua që nga fillimi në zhvillimin e marrëdhënieve bilaterale të Kosovës në kuadrin e rajonit. Hapat e parë përfshinin marrëveshjet për zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike dhe të bashkëpunimit policor me vendet fqinje, të tilla si Maqedonia<sup>78</sup> dhe Shqipëria.<sup>79</sup> Kjo u vijua nga takimet dhe marrëveshjet me Slloveninë,<sup>80</sup> Bosnjen e Hercegovinën,<sup>81</sup> Turqinë,<sup>82</sup> dhe Kroacinë.<sup>83</sup> Si pjesë e procesit të transferimit të përgjësive, që nga viti 2004 përfaqësuesit e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) të Kosovës filluan të marrin pjesë krahas me ata të UNMIK-ut në takimet, negociatat, dhe në realizimin e këtyre marrëveshjeve, me disa nga vendet përkatëse.<sup>84</sup>

---

<sup>76</sup> Yannis, Alexandros, "The UN as Government in Kosovo," *Global Governance* 10, 2004, fq. 67.

<sup>77</sup> Judah, fq. 94.

<sup>78</sup> Shih, për shembull, "Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo," UN Doc. S/2000/218, 13 mars 2001, 13, para. 61; shih, po ashtu, takimin e PSSP-së me zyrtarët e lartë shqiptarë, UN Docs. S/2001/218, 13 mars, 2001, 13, para. 61 and S/2001/565, 7 qershor 2001, 3 dhe 4, para. 10.

<sup>79</sup> Takimi i PSSP-së me autoritetet maqedone, *ibid.*, UN Doc. S/2002/436, 22 prill 2002, 9, para. 46.

<sup>80</sup> Memorandumi i Mirëkuptimit për Njohjen e Ndërsjellë të Sigurimeve të Veturave, shih, UN Doc. S/2002/1126, 9 tetor 2002, 9, para. 46.

<sup>81</sup> Marrëveshja e Tregtisë së Lirë, UN Doc. S/2006/906, 20 nëntor 2006, 6, para. 20.

<sup>82</sup> Marrëveshja për Mbrojtjen e Investimeve, UN Doc. S/2006/361, 5 qershor 2006, 5, para. 12.

<sup>83</sup> Marrëveshja e Tregtisë së Lirë, UN Doc. S/2006/906, 20 nëntor 2006, 6, para. 20.

<sup>84</sup> Me Shqipërinë dhe Maqedoninë, UN Doc. S/2004/613, 30 korrik 2004, 14, para. 50; po ashtu, gjatë negociatimit të marrëveshjes së tregtisë së lirë me Maqedoninë, UN Doc. S/2005/88, 14 shkurt 2005, 18 and 19, para. 73.



Më vonë, që nga viti 2004, UNMIK-u e nënshkroi në emër të Kosovës një mori marrëveshesh ndërkombëtare, dhe mori pjesë në një mori nismash rajonale, të tilla si Traktati i Komunitetit të Energjisë, Marrëveshja për Zonën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit, Observuesi i Transportit të Evropës Juglindore, CEFTA, dhe, më e rëndësishmja, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal.<sup>85</sup> UNMIK-u bëri, po ashtu, marrëveshje me mekanizmat monitorues të trupit të traktateve për të drejtat e njeriut të Këshillit të Evropës në vitin 2004, domethënë me Komitetin për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit dhe Dënimit Jonjerëzor dhe Degradues (KPT), dhe me Komitetin Këshillues të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve.<sup>86</sup> Duke e bërë këtë, UNMIK-u automatikisht e mori pushtetin dhe e përmbushi obligimin e vet që buronte nga ai, në emër të Kosovës. Kjo u bë e mundur në sajë të paaftësisë së Serbisë, si nënshkruese e këtyre traktateve, për t'i përmbushur obligimet e veta lidhur me Kosovën. Në kuadrin e mandatit të vet, përfaqësuesit e UNMIK-ut rregullisht morën pjesë në të gjitha këto organizata rajonale duke u përpjekur që Kosovën ta sjellte më afër rajonit, si politikisht, ashtu edhe ekonomikisht. Megjithatë, disa çështje të hapura midis vendeve të rajonit e kanë penguar seriozisht një bashkëpunim domethënës rajonal politik dhe të sigurisë. Rrjedhimisht, bashkëpunimi rajonal për të gjitha vendet në rajon, në përgjithësi, dhe për Kosovën/UNMIK-un, në veçanti, doli të jetë më i zbatueshëm në fushën ekonomike, se në ato politike dhe të sigurisë.

Në këtë drejtim, tregtia e lirë midis vendeve të rajonit gjithësesi dukej si premtuese. Kjo nuk vie si befasi, meqë i tërë Ballkani Perëndimor ka popullatë prej rreth 23 milionë njerëzish, që është e shpërndarë në shtatë vende të vogla. Në të kaluarën, sa herë që të mirat barteshin përmes kufijve, përsëriteshin procedura të mundimshme, që kërkonin kohë të gjatë dhe një masë të madhe shpenzimesh që i lodhnin njerëzit. Krijimi i një tregu të vetëm synonte jo vetëm ta ndihmonte tregtinë e lirë ndërmjet vendeve të rajonit, por, po ashtu, edhe ta rriste joshjen e tërësishme të Ballkanit Perëndimor si një treg dhe synim i investimeve. Rrjedhimisht, me përkrahjen e UE-së, në prill 2006, vendet anëtare të CEFTA-s në atë kohë, dhe vendet e Ballkanit Perëndimor u pajtuan për riorganizimin e CEFTA-s. Rregulla e saj ekzistuese për anëtarësi kërkonte që vendet anëtare duhej të ishin njëkohësisht edhe vende anëtare të OBT-së dhe që duhej të kishin MSA me UE-në. Me këtë marrëveshje, rregulla për anëtarësi u ndryshua në favor të vendeve që në atë kohë nuk i plotësonin këto kërkesa (Serbia, Mali i Zi, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kosova/UNMIK-u dhe Moldova).

CEFTA e modifikuar (e quajtur CEFTA–2006), një kornizë e re për marrëveshjen multilaterale për tregtinë e lirë që i përfshinte vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Moldovën, dhe që i zëvendësoi marrëveshjet paraprake bilaterale për tregtinë e lirë, hyri në fuqi në korrik 2007 kur Kosova u bë po ashtu pjesë e marrëveshjes CEFTA. Marrëveshja e aksesionit në emër të Kosovës u nënshkrua nga

---

<sup>85</sup> Papić, Tatjana, "Fighting for a Seat at the Table: International Representation of Kosovo," *Chinese Journal of International Law* (2013), fq. 551.

<sup>86</sup> Shih Marrëveshjen midis UNMIK-ut dhe Këshillit të Evropës për arranzhimet teknike që kanë të bëjnë me Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare të 23 gushtit 2004; në dispozicion në: [www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/6\\_Resources/PDF\\_Agreement\\_UNMIK\\_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/6_Resources/PDF_Agreement_UNMIK_en.pdf) (22.08.2014) dhe Marrëveshjen midis UNMIK-ut dhe Këshillit të Evropës për arranzhimet teknike që kanë të bëjnë me Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit e Dënimeve Jonjerëzore dhe Degraduese të 23 gushtit 2004; në dispozicion në: [www.cpt.coe.int/documents/srb/2004-08-23-eng.pdf](http://www.cpt.coe.int/documents/srb/2004-08-23-eng.pdf) (22.08.2014).

UNMIK-u, me autoritetin e dhënë për ta përfaqësuar Kosovën në punët e jashtme. Qëllimet kryesore të kësaj Marrëveshjeje ishin, mes tjerash, zgjerimi i tregtisë në të mira dhe shërbime, dhe forcimi i investimeve përmes mekanizmit të rregullave korrekte, stabile dhe të parashikueshme të eliminimit të pengesave ndaj tregtisë midis palëve, ofrimi i mbrojtjes së duhur në të drejtat pronësore intelektuale në pajtim me standardet ndërkombëtare, dhe harmonizimi i dispozitave për çështjet e politikave moderne për tregtinë, të tilla si rregullat e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore. Kjo, po ashtu, i përfshinte procedurat e qarta dhe efektive për zgjidhjen e mospajtimeve dhe e ndihmonte vendosjen graduale të zonës së vendeve të Ballkanit Perëndimor–UE-së, ashtu siç ishte paraparë në Komunikatën e Komisionit Evropian të 27 janarit 2006.<sup>87</sup> Si rezultat, tregtia e jashtme midis vendeve anëtare gradualisht u rrit dhe CEFTA e krijoi një disponim në opinionin publik në favor të integritimit ekonomik që ishte i paparamendueshëm në vitet 1990.<sup>88</sup>

Nga ana tjetër, bashkëpunimi në sektorin e energjisë merret, ashtu siç është vërejtur në komunikatën e Komisionit të janarit 2005, si një nga zhvillimet më inkurajuese, edhe përkundrejt faktit që procesi tërhoqi më pak vëmendje të mediave se integrimi i tregtisë, dhe, kësaj, publiku rajonal është më pak i vetëdijshëm për të. Duke u bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar më 2002 dhe 2003 (Memorandumi ‘i Athinës’), Traktati i Komunitetit të Energjisë u nënshkrua në tetor 2005 midis UE-së dhe nëntë partnerëve nga rajoni (Bullgaria, Rumania, Kroacia, BeH, Serbia, Mali i Zi, Shqipëria, Kosova–UNMIK-u dhe Maqedonia).<sup>89</sup> Traktati, që hyri në fuqi në korrik 2006, krijon kornizë legale për një treg rajonalisht të integruar për energji dhe gaz natyror dhe për integrimin e këtij tregu në tregun më të gjerë të UE-së. Në praktikë, kjo don të thotë që vendet e EJT do të duhen të themelojnë modele të përputhshme kombëtare të elektricitetit dhe të gazit, në pajtim me direktivat relevante të UE-së (elektriciteti, gaz, vlerësimi i impaktit mjedisor, reduktimi i përmbajtjes së squfurit në karburante dhe centralet e mëdha me djegje), si dhe me legjislacionin sekondar. Në të njëjtën kohë, ky synon t’i vendosë rregullat e përbashkëta për gjenerim, transmetim dhe distribuim të elektricitetit dhe gazit, si dhe të themelojë autoritete kombëtare të energjisë në nivelin shtetëror, si dhe rregullatorë dhe operatorë të sistemeve të transmetimit së bashku me plane konkurrencte aksionale shtetërore dhe rajonale për tregjet e elektricitetit dhe të gazit natyror, dhe t’i hapë këto tregje në pajtim me përkushtimet ndaj UE-së gjatë një periudhe të përshtatshme tranzicionale. I modeluar sipas Traktatit Evropian të Komunitetit të Qymyrit dhe të Çelikut që ishte në themel të UE-së, ky ushtrim supozohet se do të jetë reciprokisht fitimprurës – UE-ja do të përftojë nga siguria më e madhe në furnizimin me gaz dhe energji që do të kalojnë nëpër këto vende, ndërkohë që tregjet e energjisë së vendeve jo-evropiane do të operojnë në një mënyrë më të efektshme duke i zbatuar

---

<sup>87</sup> Për më tepër hollësi shih, <http://www.cefta.int>.

<sup>88</sup> Koyama, Yoji. “A Thorny Path of Economic Recovery: Case of Macedonia,” *Portal on Central Eastern and Balkan Europe*, University of Bologna, No. 14, gusht 2011, fq. 18-19. [www.pecob.eu/flex/cm/pages/...php/L/.../BLOB%3AID%3D3177](http://www.pecob.eu/flex/cm/pages/...php/L/.../BLOB%3AID%3D3177) (27.08.2014)

<sup>89</sup> "The Western Balkans on the road to the EU: Consolidating stability and raising prosperity," Communication from the Commission, COM (2006) 27 final, Brussels, 27.01.2006, fq. 12.

rregullat e UE-së. Për më tepër, konsumatorët e tyre do të përfitojnë nga tregjet më konkurrencte dhe nga dhënia e subvencioneve aty ku ato nevojiten më së shumti.<sup>90</sup>

Një dimension tjetër i rëndësishëm nga aspekti i pjesëmarrjes rajonale të Kosovës/UNMIK-ut gjithsesi ishte infrastruktura e transportit meqë kjo përfaqëson një gurëthemel për zhvillimin ekonomik. Megjithatë, duhet të përmendet që cilësia e rrugëve dhe e hekurudhave është prishur seriozisht në rrjedhën e tranzicionit post-komunist dhe të konflikteve në rajon. Jo vetëm që Ballkani Perëndimor u largua nga bërthama e UE-së më tepër se vendet e Evropës Qendrore dhe të atyre të Baltikut, por, në mesatare, cilësia e lidhjeve fizike ishte po ashtu më e dobët.<sup>91</sup> Për Kosovën, meqë kjo është e mbyllur dhe pa mundësi të transportimit ujor, rrugët dhe hekurudhat e paraqesin të vetmen mundësi të qëndrueshme për bartjen e të mirave në portet e afërta të Durrësit dhe të Selanikut, si dhe në pjesën tjetër të Evropës. Prandaj, edhe përkundrejt disa vonesave të caktuara, ishte inkurajuese që pjesa më e madhe e përpjekjes së UE-së lidhur me infrastrukturën transportuese në vitet 2000 u përqendrua në Ballkanin Perëndimor. Në tetorin e vitit 2001, Komisioni Evropian e botoi një punim për infrastrukturën rrugore që i identifikonte politikën, udhëzimet dhe parimet themelore. Për më tepër, ka patur përpjekje në rrjedhje e sipër për ta institucionalizuar edhe më tutje bashkëpunimin rajonal lidhur me transportin. Në gjysmën e parë të vitit 2008, Presidenca Sllovene e Këshillit të UE-së i dha propozimet për themelimin e Komunitetit të Transportit në Ballkanin Perëndimor, një entitet i modeluar në Komunitetin paraprakisht ekzistues të Energjisë.<sup>92</sup>

Duke synuar t'i përmirësojë aftësitë transportuese të Kosovës, më 11 qershor 2004, UNMIK-u, së bashku me Qeveritë e Shqipërisë, Bosnjës e Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, dhe me Komisionin Evropian, e nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për zhvillimin e Rrjetit Bërthamë të Transportit Rajonal, që çoi në themelimin e organizatës rajonale të transportit, Observuesin e Transportit të Evropës Juglindore (OTEJL). Qëllimi kryesor i OTEJL ishte ta promovonte bashkëpunimin në zhvillimin e infrastrukturës kryesore dhe ndihmë në Rrjetin Gjithpërfshirës multimodal OTEJL, dhe ta ndihmonte kapacitetin lokal për zbatimin e programeve investuese, dhe atë për grumbullimit e të dhënave dhe analizën e Rrjetit Gjithpërfshirës OTEJL.<sup>93</sup> Rrjedhimisht, katër qëllimet kryesore të bashkëpunimit OTEJL janë: (1) Zhvillimi i Rrjetit Gjithpërfshirës OTEJL; (2) Përmirësimi dhe harmonizimi i politikave rajonale të transportit dhe i standardeve teknike për zhvillimin e Rrjetit Gjithpërfshirës OTEJL; (3) Mbajtja e një rreti efektiv të koordinimit dhe të komunikimit; dhe, (4) Integrimi i Rrjetit Gjithpërfshirës OTEJL në kuadrin e Rrjetit më të gjerë Trans-Evropian.

---

<sup>90</sup> Moldova, Norvegjia, Turqia dhe Ukraina iu bashkuan Komunitetit të Energjisë si vëzhgues në takimin e parë të Ministrave të Energjisë pas hyrjes në fuqi të traktatit; për më tepër hollësi shih, Delevic, Milica. *Regional Cooperation in the Western Balkans*, Chaillot Paper No. 104, korrik 2007, Institute for Security Studies, fq. 65-66.

<sup>91</sup> Bechev, 2011, fq. 27.

<sup>92</sup> Për një shqyrtim të hollësishëm për nismat dhe projektet rajonale lidhur me infrastrukturën e transportit shih, Bechev, 2011, fq. 96-100.

<sup>93</sup> Për më tepër hollësi shih ueb-faqen zyrtare të OTEJL në <http://www.sectoint.org>.

Megjithatë, pjesëmarrja më e rëndësishme e Kosovës nën UNMIK-un nga aspekti i bashkëpunimit rajonal ishte padyshim ajo në Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal. Ashtu siç tashmë është përmendur, më 27 shkurt 2008, KBR e kishte trashëguar nga Pakti i Stabilitetit rolin e koordinatorit ndërmjet nismave të ndryshme rajonale, ku tipari i tij kryesor ishte ai që ishte një organizatë vetjake rajonale. Aktualisht, Këshilli, përmes Sekretariatit të vet e përkrah bashkëpunimin rajonal në Evropën Juglindore, e promovon integrimin në UE dhe atë Euro-Atlantik të rajonit, dhe ofron mbështetje operacionale për Proceset Bashkëpunuese të Evropës Juglindore (PBEJL). Gjashtë fushat e tij kryesore të përqendrimit janë: (1) *Zhvillimi Ekonomik dhe Shoqëror*: tregtia dhe investimi rajonal, dhe posaçërisht zbatimi i Marrëveshjes së Evropës Qendrore për Tregtinë e Lirë, të vitit 2006 (CEFTA), dhe korniza rajonale e investimeve, në koordinim me sektorin privat dhe së bashku me politikat e duhura sociale; (2) *Infrastruktura*: transporti, në veçanti korridoret kryesore, energjia, mjedisi, hapësira ajrore dhe teknologjitë IT; (3) *Drejtesia dhe Çështjet e brendshme*: parimisht, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë përkrahjen e bashkëpunimit të fuqizuar përmes NBEJL-së, dhe Qendrës Rajonale për Luftimin e Krimeve Ndërkufitare dhe Europolit; (4) *Bashkëpunimi i sigurisë*: reformat e sigurisë, shndërrimi ushtarak, kontrolli i armatimit të lehtë dhe forcimi i kontrollit civil të forcave të armatosura; (5) *Rritja e kapitalit njerëzor*: edukimi, hulumtimi dhe shkenca, dhe fuqizimi i aftësive administrative në këta sektorë; dhe, (6) *Bashkëpunimi parlamentar*: si një temë e tërthortë në përkrahjen e bashkëpunimit në të gjitha fushat e përmendura më sipër. Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal bashkëpunon, po ashtu, edhe me organizata dhe nisma të tjera që veprojnë në Evropën Juglindore, përfshirë edhe Nismën e Evropës Qendrore (NEQ), me të cilën i filloi negociatat heret në vitin 2009 për memorandumun e bashkëpunimit për ta fuqizuar bashkëpunimin e ndërsjellë, si dhe me Nismën e Adriatik-Jonit (NAJ).

Në bashkëpunim dhe koordinim me vendet e tjera të rajonit, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal merret, po ashtu, me ndihmën e vendeve të rajonit për t'i tejkaluar mospajtimet e tyre bilaterale. Ndër të tjera, kjo në një masë të madhe ka ndodhur meqë KBR ofronte ekspertizë teknike dhe nuk ishte i politizuar aq sa trupat e tjerë rajonale, domethënë PBEJL-ja. UNMIK-u ishte i angazhuar aktivisht në veprimtaritë e ndryshme të KBR-së, posaçërisht në projektet lidhur me energjinë dhe mjedisin, ku Kosova konsiderohej të ishte e një rëndësie kyçe në rajon. Megjithatë, angazhimi i UNMIK-ut duhej të ishte në pajtim me procedurat administrative sipas të cilave pjesëmarrja e Kosovës përmes UNMIK-ut mund të bëhej vetëm në pajtim me Rezolutën e KS KB 1244. Ndërkohë që sipas mandatit të vet UNMIK-u ishte i obliguar t'i transferonte gradualisht kompetencat e veta në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) të Kosovës, ky bëri fare pak për ta siguruar tranzicionin e patrazuar të përfaqësimit vetjak të Kosovës në KBR. Ashtu siç do ta shohin në nën-kapitullin vijues, një herë pasi që Kosova e shpalli pavarësinë e vet në shkurt 2008, kjo u përball me vështirësi të jashtëzakonshme për t'u angazhuar me bashkëpunimin e vet rajonal, në përgjithësi, dhe përbrenda KBR-së, në veçanti.

### 3.3. Pjesëmarrja pas pavarësisë

#### HYRJE

Ashtu siç tashmë u përmend, që nga qershori 1999 Kosova administrohej nga UNMIK-u që u themelua nga Sekretari i Përgjithshëm i KB, nën autoritetin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit. UNMIK-u udhëhoq nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), dhe ky e kishte të tërë pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv, përfshirë edhe administrimin e gjyqësorit.<sup>94</sup> Megjithatë, ndërkohë që Rezoluta 1244 e KSKB ia caktonte përgjegjësinë përfundimtare për Kosovën administratës së KB, kjo, po ashtu, kërkonte që KB t'i zhvillonin “institucionet e përkohshme për vetëqeverisje demokratike dhe autonome” dhe “ta ndihmonin procesin politik të përpiluar për ta caktuar statusin e ardhshëm të Kosovës, duke e marrë parasysh marrëveshjen e Rambujesë.”<sup>95</sup> Nga ana tjetër, sipas marrëveshjes së Rambujesë, pas tri vitesh “do të thirrej një takim ndërkombëtar për përcaktimin e mekanizmit për zgjidhjen përfundimtare për Kosovën, në bazë të vullnetit të popullit, pikëpamjeve të autoriteteve relevante ... dhe Aktit Final të Helsinkit.”<sup>96</sup>

Rrjedhimisht, më 1 nëntor 2005, ish Presidenti Finlandez Martti Ahtisaari u caktua si i Dërguar Special i KB për ta udhëhequr procesin e negociatave. Pas 15 raundesh të negociatave të rënda midis Prishtinës dhe Beogradit, Presidenti Ahtisaari e parashtroi propozimin e tij për statusin e ardhshëm të Kosovës.<sup>97</sup> Megjithatë, një propozim i tillë u kundërshtua vrullshëm, edhe nga Serbia, edhe nga Rusia, ku kjo e fundit vuri veto për një zgjidhje të mundshme në Këshillin e Sigurimit. Pa ndonjë veprim të mëtutjeshëm nga Këshilli i Sigurimit i KB, autoritetet e Kosovës u përgatitën ta bënin shpalljen e pavarësisë, heret në vitin 2008, si pjesë e procesit të koordinuar për së afërmi me bashkësinë ndërkombëtare. Më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës e miratoi Deklaratën e Pavarësisë “në pajtim të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të KB, Martti Ahtisaari.” Kjo e shpallte Kosovën si një republikë demokratike, sekulare dhe multi-etnike, dhe i pranonte në tërësi obligimet për Kosovën sipas planit të Ahtisaarit. Në pajtim me këtë, një ndër veprimet e para të Kosovës së pavarësuar rishtas ishte pranimi i misionit të sundimit të ligjit të UE-së (të njohur si EULEX), për të ofruar përkrahje dhe mbikëqyrje në sektorët e sigurisë dhe të gjyqësorit, dhe i Përfaqësuesit Ndërkombëtar Civil që do ta mbikëqyrte implementimin e planit të Ahtisaarit dhe që do të vepronte si Përfaqësues Special i UE-së në Kosovë. Edhe EULEX-i, edhe Përfaqësuesi Special, e kanë një brez pushtetesh ekzekutive, edhe pse këto në asnjë rast nuk e arrijnë nivelin që UNMIK-u dhe shefi i tij e kishin patur më heret.<sup>98</sup>

---

<sup>94</sup> Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, S/1999/779, 12 qershor 1999.

<sup>95</sup> Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, S/1999/672, 12 qershor, 1999.

<sup>96</sup> “Marrëveshja e Rambujesë,” në *Koha Ditore*, Prishtinë, 2 mars 1999, fq. 3.

<sup>97</sup> United Nations, “Report of the Special Envoy of the Secretary-General on Kosovo’s Future Status,” S/2007/168, 26 mars 2007.

<sup>98</sup> Tansey, Oisín, “Kosovo: Independence and Tutelage,” *Journal of Democracy*, Vol. 20, No. 2, prill 2009, fq. 159.

Pas shpalljes së pavarësisë, qeveria e Kosovës i hyri një detyre të vështirë të sigurimit të njohjes ndërkombëtare dhe të ndërtimit të institucioneve të vendit. Që nga fillimi Kosova e ka shpallur integrimin euro-atlantik si njërin nga prioritetet e veta më të rëndësishme strategjike. Prandaj, nuk është për t'u befusuar që krahas me këtë, bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore ishin deklaruar si synime të politikës së jashtme të vendit. Domethënë, në qëllimet e veta strategjike, Ministria e Punëve të Jashtme e shpreh që “politika e jashtme e Republikës së Kosovës synon të zhvillojë bashkëpunim ndër-rajonal, marrëdhënie të mira me shtetet fqinje, dhe një rajon demokratik dhe të integruar në UE dhe në NATO.”<sup>99</sup> Për më tepër, kjo e bënte të qartë që zhvillimi i marrëdhënieve në bazë të fqinjësisë së mirë dhe të bashkëpunimit me vendet rajonale, dhe në veçanti me vendet e Ballkanit Perëndimor, e paraqiste njërin nga kërkesat prioritare për Procesin e Stabilizimit dhe të Asocimit me UE-në.<sup>100</sup>

Megjithatë, pjesëmarrja e Kosovës në organizatat dhe nismat e ndryshme rajonale doli të jetë mjaft e vështirë, kryesisht për shkak të kundërshtimit tepër të madh nga Serbia, dhe të mosnjohjes së pavarësisë së saj nga vendet e ndryshme, përfshirë këtu edhe disa rajonale. Pos kësaj, meqë pavarësia e Kosovës nuk përkrahej nga ndonjë rezolutë e re<sup>101</sup> e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, institucionet e Kosovës të krijuara pas shpalljes së pavarësisë nuk mund të bëheshin pasardhëse të institucioneve të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Kosova nuk ishte në gjendje ta kishte një mënyrë të njësuar të përfaqësimit në trupat rajonale dhe ndërkombëtare, dhe kjo, kësajsoj, në disa nga trupat rajonale përfaqësohej si një shtet i pavarur, në të tjerët përmes UNMIK-ut dhe EULEX-it, dhe, shpesh herë, edhe nga ndonjë kombinim i këtyre dyjave.<sup>102</sup> Në këtë kontekst, modalitetet e përfaqësimit rajonal të Kosovës u bënë mjaft kontraverze, për shkak të qëndrimeve të kundërta të Serbisë dhe Kosovës lidhur me këtë çështje. Autoritetet e Kosovës argumentonin që duhej të ishin ato që do ta përfaqësonin Kosovën, dhe jo përfaqësuesit e UNMIK-ut. Nga ana tjetër, Serbia ngulmonte që vetëm UNMIK-u duhej ta përfaqësonte Kosovën dhe refuzonte të merrte pjesë në takimet në të cilat ishin ftuar edhe përfaqësuesit e Kosovës.<sup>103</sup> Ashtu siç pritej, qëndrimi i Serbisë lidhur me pjesëmarrjen e përbashkët në takimet me përfaqësuesit e Kosovës ishte më i ngurti menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, përfaqësuesit serbë largoheshin nga të gjitha mbledhjet në të cilat ishin të pranishëm përfaqësuesit e Kosovës si pjesë të delegacioneve të UNMIK-ut, dhe ku, në fund, u jipej fjala nga UNMIK-u. Për shembull, Serbia e kishte bërë të ditur që nuk do të merrte pjesë në asnjë veprim të KBR ku Kosova do të përpiqej të vepronte si shtet sovran në vend se të ishte nën tutelën e Misionit të Përkohshëm Administrativ të KB në Kosovë (UNMIK). Nga ana tjetër, Kosova ishte, po ashtu, një nga çështjet qendrore në samitin e PBEJL-së në Pomorje (Bullgari), më 29 maj 2008. Ministri i Jashtëm serb, Vuk Jeremić e bllokoi përfaqësuesin e Kosovës, Skender Hysenin nga ajo që t'i drejtohej takimit si shefi i

---

<sup>99</sup> Ministry of Foreign Affairs of Kosovo, “The Foreign Policy Objectives,” Prishtinë, Kosovë; në dispozicion në <http://www.mfa-ks.net/repository/docs/Kosovoforeignobjectives.pdf> (25.08.2014).

<sup>100</sup> *Ibid.*

<sup>101</sup> Rezoluta që do ta zëvendësonte Rezolutën ekzistuese 1244 të Këshillit të Sigurisë.

<sup>102</sup> Emini, Donika, “Kosovo’s Membership and Representation in Regional Security Initiatives,” Kosovar Center for Security Studies, shtator 2014, fq. 10.

<sup>103</sup> Papić, “Fighting for a Seat at the Table: International Representation of Kosovo,” *Chinese Journal of International Law* (2013), 12 (3), fq. 557.

diplomacisë së Kosovës, duke ngulmuar që në vend të tij duhej të fliste zyrtari i UNMIK-ut. Gjatë tërë takimit, Serbia ngulmonte që Kosova të mos përmendej fare në dokument, edhe pse Shqipëria ngulmonte në të kundërtën.<sup>104</sup> Kësisoj, për shkak të kundërshtimit të Serbisë, pavarësia e Kosovës i ndryshoi trajtat e bashkëpunimit rajonal, dhe kjo fillimisht pjesëmarrjen e Prishtinës në bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor e shndërroi në një sfidë shumë më të madhe se gjatë mbajtjes së UNMIK-ut.

Duhet përmendur që pjesëmarrja rajonale e Kosovës ishte e ndërlidhur ngushtë me sukseset e saj në arritjen e njohjeve të pavarësisë së saj. Fakti që, pos Serbisë, Kosovën nuk e ka njohur as Bosnja e Hercegovina, e vështirëson edhe më tutje integrimin e Kosovës në rajon. Nga ana tjetër, edhe pse UE-ja kishte ngulmuar vazhdimisht për përfshirjen e Kosovës në organizatat dhe nismat rajonale, qëndrimi i Unionit ishte penguar në një mënyrë serioze nga fakti që edhe pesë nga shtetet e tij anëtare nuk e kishin njohur Kosovën.<sup>105</sup> Duke qenë i vetëdijshëm që bllokada serbe e Kosovës mund ta kërcënojë seriozisht çfarëdo bashkëpunimi domethënës rajonal në EJJ, UE-ja ka ngulmuar në dialog midis Kosovës dhe Serbisë. Nga ana tjetër, refuzimi i Serbisë për pjesëmarrje të përbashkët në takimet ndërkombëtare me përfaqësuesit e Kosovës e krijoi, po ashtu, një sfidë të madhe për procesin e integritit të saj në UE, që, ashtu siç tashmë është përmendur, kërkonte një bashkëpunim përfshirës dhe funksional dhe marrëdhënie të mira fqinjësore. Në pikëpamjen e vet për aplikimin e Serbisë për anëtarësim në UE, Komisioni Evropian konstaton që arritja e progresit në këtë aspekt është një prioritet për Serbinë.<sup>106</sup> Ishte e qartë që, me qëllim që të bëhej një vend kandidat për anëtarësi në UE, Serbia duhej të bashkëpunonte në gjetjen e zgjidhjes për përfaqësimin rajonal të Kosovës. Kësisoj, perspektivat për kandidaturë u shndërruan në një nxitje kryesore për Serbinë që të angazhohej në gjetjen e zgjidhjes që do t'i mundësonte, edhe Beogradit, edhe Prishtinës, ta zhvillonin një bashkëpunim funksional rajonal.<sup>107</sup> Rrjedhimisht, në vijim të Rezolutës 64/29 të Shtatorit 2010 të Këshillit të Sigurisë të KB, UE-ja e ka ndihmuar dialogun midis Prishtinës dhe Beogradit. Sipas kësaj Rezolutive, Asambleja e Përgjithshme “e përshëndet gatishmërinë e Unionit Evropian për ta ndihmuar procesin e dialogut midis palëve; procesi i dialogut në vetvete do të jetë një faktor i paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon, dhe qëllim i këtij dialogu do të jetë që ta promovojë bashkëpunimin, të arrijë progres në rrugën drejt Unionit Evropian dhe t'i përmirësojë jetët e njerëzve.”<sup>108</sup>

Që nga marsi 2011, nën përkujdesin e UE-së, janë mbajtur shtatë raunde të negociatave midis dy vendeve, që janë përqendruar në tri çështje kryesore: (1) në bashkëpunimin rajonal; (2) në lirinë e lëvizjes; dhe, (3) në sundimin e ligjit. Gjatë këtyre negociatave, palët kanë arritur marrëveshje për

---

<sup>104</sup> Altmann, Franz-Lothar, “Kosovo’s Independence: The Consequences for EU Integration Policy,” në Cutting or Tightening the Gordian Knot?, Proceedings of the 16th Workshop of the Study Group “Regional Stability in South East Europe,” tetor 2009, fq. 118.

<sup>105</sup> Qiproja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja.

<sup>106</sup> European Commission, “Serbia Progress Report 2011,” Brussels: European Commission, Commission Staff Working Paper, 12 tetor 2011.

<sup>107</sup> Papić, 2013, fq. 560.

<sup>108</sup> UN Doc. A/RES/64/298, 9 shtator 2010.

lëvizjen e lirë të njerëzve, për vulat e doganave, për njohjen e diplomave universitare, për regjistrat e katastrit, për regjistrat civil, dhe për Menaxhimin e Integruar të Kufirt (MIK).<sup>109</sup> Në takimin e 23 shkurtit 2012, të dialogut të ndihmuar nga Unioni Evropian në Bruksel, Kosova dhe Serbia e kanë arritur marrëveshjen për Arranzhimet Lidhur me Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal (ALPBR). Sipas kësaj marrëveshjeje, Kosova do të merr pjesë dhe do të flasë për vetveten në të gjitha takimet rajonale ndërqeveritare, si një partner i barabartë me të gjitha shtetet e tjera pjesëmarrëse. Kjo marrëveshje bilaterale parasheh, po ashtu, që Kosova do të nënshkruajë marrëveshje të reja dhe do t'i bashkangjitet organizatave të reja ndërkombëtare ndërqeveritare.<sup>110</sup> Marrëveshja është menduar si një zgjidhje e përkohshme për emërtimin dhe përfaqësimin e Kosovës në kontekstin rajonal, që do t'i mbulojë takimet rajonale dhe format institucionale të bashkëpunimit rajonal, si dhe marrëveshjet ekzistuese dhe ato të ardhshme.<sup>111</sup> Këtu është shpresuar që zbatimi i suksesshëm i dispozitave të kësaj marrëveshjeje do ta sigurojë pjesëmarrjen e rritur të Kosovës në nismat dhe organizatat e ndryshme rajonale. Mirëpo, ashtu siç do ta shohim në nën-kapitullin vijues, madje edhe me një kesi marrëveshje në fuqi, integrimi i Kosovës në forumet e ndryshme rajonale mbeti një sfidë serioze.

### 3.4. Statusi aktual i pjesëmarrjes së Kosovës në organizatat dhe nismat rajonale

E inkurajuar nga marrëveshja për Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal të Kosovës, Kosova e ka ndërmarrë një veprim serioz për ta siguruar pjesëmarrjen e vet të plotë në organizatat dhe nismat e ndryshme rajonale. Rrjedhimisht, nën udhëheqjen e Ministrisë së vet të Punëve të Jashtme, Kosova filloi t'u qasej organizatave të ndryshme rajonale duke kërkuar anëtarësim të plotë si një vend sovran.<sup>112</sup> Anëtarësia dhe përfaqësimi i Kosovës në nismat rajonale tash u shndërrua në një prioritet kryesor për qeverinë e Kosovës, ashtu që kjo elektoratit të vet t'ia tregonte përkushtimin dhe arritjet e veta. Pos kësaj, përfaqësimi dhe anëtarësia e Kosovës në organizatat rajonale u shndërruan në një temë për të cilën në media flitej tepër shumë. E qartë, elitat politike e panë bashkëpunimin rajonal si një mënyrë të rëndësishme për ta bindur elektoratin për njohjen ndërkombëtare të shtetësisë së Kosovës.<sup>113</sup> Ishte e qartë që Kosova nuk ishte e gatshme që përgjithmonë të përfaqësohej nga UNMIK-u, dhe që ngulmonte të merrte pjesë me kushtet e veta sovraane që tashmë ishin njohur nga shumica e fqinjëve të saj.<sup>114</sup>

---

<sup>109</sup> Curri, Fatmir dhe Loshi, Mimika, "Monitoring Regional Cooperation in South East Europe: Country Report – Kosovo," në Stefan Dehnert dhe Dane Taleski (red.) *Monitoring Regional Cooperation in South East Europe*, Berlin: Friedrich Ebert Stiftung, 2013, fq. 74.

<sup>110</sup> Sipas kësaj marrëveshjeje 'Kosova\*' do të jetë i vetmi emërtues që do të përdoret në kuadrin e kornizës së bashkëpunimit rajonal. Në fusnotën që do të zbatohet për asteriksin do të shkruajë "Ky emërtim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me RKS KB 1244 dhe me Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës." Shih: "Arrangements Regarding Regional Representation and Cooperation," Brussels, Rev10 RC 23/02/2012.

<sup>111</sup> *Ibid.*, pika 11.

<sup>112</sup> Autori ka qenë i përfshirë personalisht në këtë proces në kohën që punonte si Këshilltar në Ministrinë e Punëve të Jashtme si pjesë e projektit UNDP/KFOS "Capacity Development Facility" të financuar nga Qeveria Norvegjeze gjatë periudhës korrik 2011-2012.

<sup>113</sup> Curri dhe Loshi, 2013, fq. 74.

<sup>114</sup> Altmann, 2009, fq. 119.



Megjithatë, edhe përkundrejt pritjeve të mëdha nga ana e autoriteteve kosovare, procesi i integritetit të Kosovës në organizatat dhe nismat rajonale ishte larg nga ajo që të ishte i patrazuar. Sa për fillim, marrëveshja për Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal të Kosovës ishte e prirur të interpretohej në mënyra të ndryshme nga qeveritë e Serbisë dhe të Kosovës. Domethënë, qeveritë e dy vendeve kishin interpretime të ndryshme për implementimin e marrëveshjes për asteriksin. Kosovës i ishte thënë që do të përfaqësohej me asteriks vetëm në pllakëzat e emrave, ndërkohë që fusnota do të përmendej vetëm në dokumentet e shkruara. Nga ana tjetër, Serbisë i ishte thënë që në çdo organizatë rajonale, Kosova do të përfaqësohej, edhe me asteriks, edhe me fusnotë me tekst të shkruar.<sup>115</sup> Për më tepër, organizatat e ndryshme rajonale i pranuan “konkluzione” e Brukselit pa udhëzime për atë se si duhet t’i zbatojnë ato, duke e lënë, kështu, këtë si çështje të interpretimit të të gjitha palëve.<sup>116</sup> Varësisht nga prania apo mungesa e fusnotës, edhe Beogradi, edhe Prishtina, ishin të frustruara sa herë që interpretimi i marrëveshjes nuk është respektuar, dhe kanë reaguar, qoftë duke dalur nga takimi, qoftë duke e bojkotuar atë në tërësi. Prandaj, këto interpretime reciprokisht përjashtuese i kanë penguar mundësitë e Prishtinës dhe të Beogradit për të marrë pjesë në të njëjtat forume rajonale, ndërkohë që në të njëjtën kohë i kanë bërë të ditura disa mangësi të qenësishme në mekanizmat për sigurimin e implementimit të marrëveshjeve.<sup>117</sup>

Për më tepër, Qeveria e Serbisë e përvetësoi një udhëzim sipas të cilit plakëza me emër duhej të ishte “Kosova\*,” e vijuar nga teksti për të cilin është arritur pajtimi në ALPBR, si dhe që nuk duhej të kishte paraqitje të simboleve të “Republikës së Kosovës.” Në rastin kur përfaqësuesit e Serbisë nuk ia dëlnin t’i siguronin këto kondita me nikoqirin e takimit, ata do të dëlnin nga takimi. E qartë, jo vetëm që interpretimi i ALPBR që e jpte ky udhëzim nuk ishte në pajtim me dispozitat e marrëveshjes, por nxiste, po ashtu, dyshime serioze për qëllimet e mira të Serbisë në zbatimin e ALPBR-së.<sup>118</sup>

Si pasojë, edhe përkundrejt marrëveshjes, Kosova ende ishte e paaftë për ta arritur një përfaqësim të plotë në shumicën e organizatave rajonale. Edhe përkundrejt marrëveshjes, Serbia vazhdimisht i bllokonte ose i bojkotonte takimet rajonale ku Kosova ishte e ftuar si partnere. Në vijim do t’i analizojmë arritjet konkrete të Kosovës nga aspekti i pjesëmarrjes rajonale në disa nga organizatat dhe nismat më të rëndësishme rajonale.

---

<sup>115</sup> Shih “Misunderstandings mire Kosovo representation agreement,” SETimes.com, 16 mars, 2012, [www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/features/setimes/features/2012/03/16/feature-02](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2012/03/16/feature-02) (16.09.2014).

<sup>116</sup> Më vonë, sipas uebsajtëve të dy qeverive, doli që “përfundimet” e famshme të Brukselit madje edhe kishin versione të ndryshme; shih, Curri dhe Loshi, 2013, fq. 75.

<sup>117</sup> “Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo,” UN Doc. S/2012/275, April 27<sup>th</sup>, 2012, 4, para.14.

<sup>118</sup> Papić, 2013, fq. 563.

### 3.4.1. Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (KBR)

Ashtu siç tashmë është përmendur, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal në vitin 2008 e ka trashëguar nga Pakti i Stabilitetit rolin e koordinuesit ndërmjet nismave të ndryshme rajonale. Që nga fillimi, KBR-ja duhej të ishte një kornizë e zotëruar dhe e udhëhequr rajonalisht që e përkrah integrimin evropian dhe euro-atlantik të vendeve aspiruese. Edhe pse UNMIK-u ishte i angazhuar aktivisht në aktivitetet e ndryshme të KBR-së në emër të Kosovës, ky nuk bëri ndonjë punë të madhe për ta siguruar një tranzicion të patrazuar për në përfaqësimin vetjak të Kosovës në KBR. Meqë krijimi i KBR-së është përputhur pothuaj me përpikëri me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, një pozitë e tillë e UNMIK-ut shkaktoi vështirësi jashtëzakonisht të mëdha që Kosova të angazhohej në emër të vetin në kuadrin e KBR-së. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Serbia e bëri të ditur që kjo nuk do të merrte pjesë në asnjë takim apo veprimtari të KBR-së në të cilat Kosova nuk do të përfaqësohej nga UNMIK-u, por përpiquej të vepronte si shtet sovran.<sup>119</sup> Nga ana tjetër, autoritetet e Kosovës ngulmuan të pranoheshin si përfaqësues të Republikës së Kosovës, pa UNMIK-un në emër të tyre. Në një mënyrë mjaft paradoksale, ndërkohë që merrej se KBR-ja duhej ta ndihmonte bashkëpunimin ndërmjet vendeve të rajonit, ky, të paktën fillimisht, nuk bëri pothuaj asgjë që në kuadrin e vet ta përfshinte edhe Kosovën – domethënë, vendin të cilit integrimi dhe përkrahja rajonale i nevojitej më së shumti.<sup>120</sup>

Pos që ishte e penguar nga kundërshtimi i vazhdueshëm i Serbisë, pjesëmarrja e përfaqësuesve të Kosovës vështirësohej, po ashtu, nga problemi i shfrytëzimit të pasaportave të Kosovës dhe i sigurimit të vizave për vendet që ende nuk e kishin njohur pavarësinë e Kosovës. Meqë Sekretariati i KBR-së ndodhet në Sarajevë, kjo çështje u bë posaçërisht e mundimshme për ndjekjen e takimeve në Bosnje e Hercegovinë. Domethënë, edhe pse Bosnja e Hercegovina, sipas Marrëveshjes së Vendit Nikoqir të KBR-së,<sup>121</sup> e kishte obligimin për ta ndihmuar këtë proces, autoritetet e vendit nuk ishin në gjendje t'i bënin rregullimet e nevojshme që autoritetet kosovare të hynin në vendin e tyre me pasaportat kosovare. Përkundrazi, procedurat për sigurimin e vizave ishin jashtëzakonisht të ngatërruara dhe kërkonin tepër shumë kohë. Ndër të tjera, për ta siguruar vizën, qytetarëve të Kosovës u nevojitej një letër ftese, një letër biznesi, dhe një notë diplomatike, ku letra e ftesës duhej të zyrtarizohej te noteri dhe duhej t'i dërgohej ambasadës në Sarajevë të vendit prej nga ishte aplikuesi.<sup>122</sup> Megjithatë, situata është përmirësuar që nga shtatori 2009, kur janë bërë arranzhime të

---

<sup>119</sup> Altmann, 2009, fq. 118.

<sup>120</sup> Pos Zyres në Terren në Kosovë të Qendrës Rajonale Mjedisore për Evropën Qendrore dhe Lindore, shih Kallaba, Pëllumb, "Permanent Structured Cooperation in the Western Balkans as a Model towards European Union Accession," e paraqitur në konferencën *Leaving Europe Waiting Room: Overcoming the Crisis of EU Enlargement in the Western Balkans*, Graz, 9-11 nëntor, 2012.

<sup>121</sup> Sipas Marrëveshjes për Vendin Nikoqir (MVN), Sekretariatit të KBR-së i jipej një themel i fortë ligjor për ta filluar punën e vet ashtu siç është planifikuar në fundin e shkurtit 2008. Pos kësaj, MVN po ashtu ia mundësoi Sekretariatit ta përfundonte Marrëveshjen e Qendrës me Belgjikën për ta themeluar Zyrën Ndërlidhëse të KBR-së në Bruksel; shih Curri dhe Loshi, 2013, fq.73.

<sup>122</sup> Shih, "Kosovars face travel problems in BiH," SETimes, 30 korrik 2012, [http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/features/setimes/features/2012/07/30/feature-04](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2012/07/30/feature-04) (07.10.2014).

veçanta ashtu që autoritetet kosovare t'i ndiqnin takimet e KBR-së të drejtuara nga nikoqiri.<sup>123</sup> Sidoqoftë, çështjet e tilla teknike, së bashku me trysnitë politike, ishin arsyeja kryesore pse Kosova nuk mori pjesë në takimet e Bordit të KBR-së dhe në ngjarjet e tjera të drejtuara nga KBR-ja midis qershorit 2008 dhe shtatorit 2009. Fatkeqësisht, një qasje e tillë “anti-pavarësi” është përvetësuar edhe nga vende të tjera që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës (për shembull Moldova, Sllovakia dhe Rumania). Si pasojë e një qasjeje të tillë, delegacioni i Kosovës madje as që është pranuar të merr pjesë në takimin e parë vjetor që është mbajtur në qershor 2009 në Chisinau, në Moldovë.

Një situatë e re u krijua pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) të 22 korrikut 2010, që konstatonte që shpallja e pavarësisë e Kosovës nuk ishte shkelje e të drejtës ndërkombëtare.<sup>124</sup> Kjo për autoritetet e Kosovës ishte një argument shtesë për ta kundërshtuar përfaqësimin rajonal të Kosovës përmes UNMIK-ut. Si pasojë, autoritetet e Kosovës nuk morën pjesë në takimet e Bordit të KBR-së në vitin 2010, mirëpo, këto, megjithatë, morën pjesë në Takimin Vjetor të KBR-së në Mal të Zi në qershor 2011, dhe në Takimin e Bordit të shtatorit 2011, si pjesë e delegacionit të UNMIK-ut/Kosovës. Duhet përmendur që emërimi i ish Ministrit të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, Goran Svilanovic si Sekretar i Dytë i Përgjithshëm në maj 2011 krahas me përvetësimin e Strategjisë dhe Programit të saj Punues 2011-2013 e dha një moment të ri për konsolidimin e Selisë së KBR-së në Sarajevë.<sup>125</sup> Nga ana tjetër, Komisioni Evropian e ka kritikuar KBR-në për përqendrimin e veprimtarive të veta në një diplomaci deklarative dhe në shënimin e pranisë së vet në ngjarje, më tepër se në veprime konkrete që rajonit do t'i jipnin vlerë të shtuar.<sup>126</sup> Pos kësaj, Komisioni ka ngulmuar në një mënyrë të vazhdueshme që të gjitha palët në rajon ta përvetësojnë një “qëndrim konstruktiv në gjetjen e mënyrave pragmatike për ta siguruar një karakter përfshirës të bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore,” dhe i ka inkurajuar fuqishëm “të gjitha palët për të kërkuar zgjidhje pragmatike dhe është i gatshëm t'i ndihmojë të gjitha përprojekjet drejt këtij rezultati.”<sup>127</sup>

Megjithatë, çështja e përfaqësimit të barabartë të Kosovës në Sekretariatun dhe Bordin e KBR-së ende mbetet e mundimshme. Edhe pse përfaqësuesit e Kosovës i kanë ndjekur disa takime rajonale për të cilat kërkohej ndihma nga UNMIK-u, shumica prej tyre ende paraqiste problem për përfaqësimin e Kosovës me emrin e vet kushtetues, duke e penguar kështu seriozisht pjesëmarrjen e plotë rajonale të Kosovës.<sup>128</sup> Madje edhe pasi që Kosova dhe Serbia e arritën marrëveshjen për

---

<sup>123</sup> Në të vërtetë, edhe përkundrejt vendosjes së një procedure të thjeshtësuar për përfaqësuesit e Kosovës, procedura e vizave mbeti mjaft e komplikuar, posaçërisht për ngjarjet e tjera rajonale të organizuara në BeH; shih Curri dhe Loshi, 2013, fq.73.

<sup>124</sup> Tanner, Adam dhe Stevenson, Reed. "Kosovo independence declaration deemed legal." *Reuters*, 22 korrik 2010. <http://www.reuters.com/article/idUSTRE66L01720100722> (16.09.2014)

<sup>125</sup> Kallaba, 2012, fq. 12.

<sup>126</sup> Commission (DG Enlargement) non paper, *Moving towards a more efficient Regional Cooperation Council*, Western Balkans Region, Meeting doc.168/2009, 20 tetor 2009.

<sup>127</sup> European Commission, “Kosovo - Fulfilling its European Perspective,” Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, Commission of the European Communities, Brussels, 14 tetor 2009.

<sup>128</sup> Curri dhe Loshi, 2013, fq.73.

Arranzhimet Lidhur me Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal, çështja e pjesëmarrjes së Kosovës në nismat rajonale, përfshirë KBR-në nuk ishte, as e kënaqshme, as e mjaftueshme. Në marsin e vitit 2012, delegacioni serb doli nga Bordi i Takimit të KBR-së në Sarajevë. Sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë, përfaqësuesi i Serbisë u largua nga takimi meqë pllakëza e emrit të Kosovës e përmbante vetëm asteriksin pa fusnotën e bashkangjitur.<sup>129</sup> Në të njëjtën kohë, edhe përkundrejt Strategjisë dhe Programit Punues të ri 2011-2013 të KBR-së, Sekretariati i tij kishte bërë fare pak për ta avancuar anëtarësinë e plotë të Kosovës.

Vetëm në takimin e vet të parë të vitit 2013 Bordi i Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal vendosi ta përmirësonte statutin e vet dhe deklaratën e vet themeluese, ta tërhiqte referimin në UNMIK-un, dhe t'i mundësonte Kosovës të hyjë si pjesëmarrëse në këtë proces.<sup>130</sup> Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të KBR-së, Goran Svilanovic, "pjesëmarrja e Kosovës\* në Këshillin Bashkëpunues Rajonal është një konfirmim i përkushtimit të plotë të organizatës për ta siguruar gjithëpërfshirjen në veprimtaritë tona," ndërkohë që në të njëjtën kohë tregonte që "rajoni është në gjendje ta marrë përgjegjësinë për të ardhmen e vet dhe t'i krijojë konditat për një progres të përgjithshëm në frymën e tolerancës dhe të bashkëpunimit."<sup>131</sup> Një vendim i tillë u mirëprit nga vende të shumta, si Shtetet e Bashkuara, Turqia, Shqipëria, Suedia, si dhe të gjithë përfaqësuesit e UE-së. Sipas MJ të Kosovës, vendi mbetet i përkushtuar ndaj bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore, dhe vendimi i KBR-së padyshim që hap mundësi të reja të anëtarësisë dhe bashkëpunimit për Kosovën.<sup>132</sup> Për t'i marrë mundësitë e krijuara nga anëtarësia në KBR, Qeveria e Kosovës e themeloi Zyren e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (ZKBR) që do të vepronte në kuadrin e Zyres së Kryeministrit. Kjo Zyre udhëhiqet nga këshilltari politik i emëruar nga Kryeministri, që, pos që do të jetë përgjegjës për drejtimin e Zyres dhe të zbatimit të kompetencave të saj, njëkohësisht do të shërbejë edhe si Koordinator Kombëtar për Bashkëpunimin Rajonal për vendet e Evropës Juglindore.<sup>133</sup>

### 3.4.2. Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore (PBEJL)

Ashtu siç tashmë është përmendur, Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore daton nga viti 1996 dhe e paraqet platformën e vetme bashkëpunuese "vendëse" të rajonit, që përbëhet ekskluzivisht nga shtetet e Evropës Juglindore. Edhe pse synonte ta promovonte dialogun

---

<sup>129</sup> Latković, N., "Delegacija Srbije zbog nedostataka fusnote napustila Sarajevo, a prištinska zbog fusnote otišla iz Beograda," *Blic*, 15 mars 2012. [www.blic.rs/Vesti/Politika/312244/Delegacija-Srbije-zbog-nedostataka-fusnote-napustila-Sarajevo-apristinska-zbog-fusnote-otisla-iz-Beograda](http://www.blic.rs/Vesti/Politika/312244/Delegacija-Srbije-zbog-nedostataka-fusnote-napustila-Sarajevo-apristinska-zbog-fusnote-otisla-iz-Beograda) (25.09. 2014).

<sup>130</sup> Kosova në listën e pjesëmarrësve të KBR-së zakonisht emërtohej 'Kosovo (UNMIK),' mirëpo kjo u ndryshua në 'Kosova\*', ku asteriksi do të thoshte që "ky emërtim është pa paragjykim për qëndrimin ndaj statusit, dhe është në pajtim me RKSKB 1244 dhe me Mendimin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë të Kosovës." Shih, "Kosovo becomes full-fledged participant of Regional Cooperation Council," Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Kosovo, <http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,1603> (10.10.2014).

<sup>131</sup> "Kosovo\* becomes full-fledged participant in RCC," *Kosovo Compromise*, <http://kosovocompromise.com/cms/item/topic/en.html?view=story&id=4446&sectionId=1> (12.10.2014)

<sup>132</sup> "Kosovo becomes full-fledged participant of Regional Cooperation Council."

<sup>133</sup> "Office of the Regional Cooperation Council," The Office of the Prime Minister of the Republic of Kosovo, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,129> (12.10.2014).

diplomatik dhe politik ndërmjet vendeve të rajonit, PBEJL-ja shpesh herë është kritikuar për mungesën e ndonjë impakti domethënës, duke punuar kryesisht në një nivel të deklarimeve të paqarta dhe të përgjithësuara.<sup>134</sup> Për më tepër, edhe pse një nga nismat e pakta rajonale në atë kohë, PBEJL ishte mjaft e përçarë gjatë luftës së Kosovës në vitet 1998-1999. Edhe përkundrejt përvetësimit të Kartës së Bukureshtit për Marrëdhëniet e Mira Fqinjësore, për Stabilitet, Siguri dhe Bashkëpunim në Evropën Juglindore në vitin 2000,<sup>135</sup> PBEJL-ja tregoi fare pak sukses për zgjidhjen apo zbutjen e mospajtimeve bilaterale në Ballkanin Perëndimor. Më 14 shtator 2007 në Plovdiv, Ministrat e Punëve të Jashtme të Bosnjes e Hercegovinës dhe të vendeve të tjera pjesëmarrëse të PBEJL-së, si dhe UNMIK-u në emër të Kosovës, e nënshkruan marrëveshjen që Sekretariatit e KBR-së e vendoste në Sarajevë. Rrjedhimisht, pas themelimit të vet në vitin 2008, Sekretariati i Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal i përkrah dhe i përgatit takimet dhe samitet ministrorë të PBEJL-së. Sipas *Deklaratës së Përbashkët për Themelimin e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal*, KBR-ja i ofron PBEJL-së kapacitete operationale përmes Sekretariatit të vet dhe, po ashtu, vepron nën udhëheqjen politike të PBEJL-së.<sup>136</sup>

Ngjashëm me KBR-në, dhe, në parim, për të njëjtat arsye që u përmendën më sipër, përfaqësuesit e Kosovës u përballën me vështirësi serioze për të marrë pjesë në takimet e PBEJL-së pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Si pasojë, përfaqësuesit e Kosovës nuk ishin në gjendje të merrnin pjesë në takimet kyçe të PBEJL-së, të tillë si Samiti që u mbajt në Chisinau në qershor 2009, më pastaj në Stamboll në vitin 2010, dhe në vitin 2011 në Budvë.<sup>137</sup> Në samitin e Beogradit që u mbajt në qershor 2012 nën drejtimin e Serbisë, Kosovës iu mohua anëtarësia në PBEJL edhe përkundrejt marrëveshjes për Arranzhimet Lidhur me Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal të arritur në shkurt 2012. Si pasojë e kundërshtimit të Serbisë, Shqipëria e bllokoi draft-deklaratën e përbashkët, dhe kësaj krerët e shteteve nuk ishin në gjendje për ta përvetësuar atë.<sup>138</sup> Polemika lidhur me pjesëmarrjen e Kosovës në takimin e PBEJL-së vazhdoi po ashtu gjatë Drejtimit të Maqedonisë në vitin 2013. Fillimisht, nikoqirët e ftuan Ministrin e Jashtëm të Kosovës, si një mysafir të veçantë në takimin formal të ministrave të jashtëm të vendeve të PBEJL-së që u mbajt në maj 2013. Kosova mori pjesë përmes Zëvendësministrit të Jashtëm dhe ministrat ishin në gjendje ta përfundonin Deklaratën e Përbashkët të Ohrit.<sup>139</sup> Megjithatë, për shkak të vërejtjeve nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, Kosova nuk u ftua në Samitin e PBEJL-së të Krerëve të Shteteve dhe të Qeverive në Ohër. Duke konstatuar që një veprim i tillë është në kundërshtim me frymën e bashkëpunimit dhe të dialogut në rajon, si dhe me marrëveshjen për ALPBR të arritur në Bruksel, Presidenti i Shqipërisë

---

<sup>134</sup> Shih Delevic, 2007, fq.18.

<sup>135</sup> Shih, "The Bucharest Charter," 12 shkurt 2000, <http://www.seecp-turkey.org/icerik.php?no=32> (10.10.2014).

<sup>136</sup> Kallaba, 2012, fq. 7.

<sup>137</sup> Curri dhe Loshi, 2013, fq.73.

<sup>138</sup> Shih "Albania blocks joint declaration at end of SEECP summit," *B92*, 15 qershor 2012, [http://www.b92.net/eng/news/politicsarticle.php?yyyy=2012&mm=06&dd=15&nav\\_id=80779](http://www.b92.net/eng/news/politicsarticle.php?yyyy=2012&mm=06&dd=15&nav_id=80779) (13.10.2014)

<sup>139</sup> Deklarata e PBEJL-së e takimit formal të Ministrave të Punëve të Jashtëm, Ohër, 31 maj 2013, [http://www.preventionweb.net/files/31414\\_seecpohriddeclaration.pdf](http://www.preventionweb.net/files/31414_seecpohriddeclaration.pdf) (13.10.2014)

Bujar Nishani e anuloi pjesëmarrjen e tij.<sup>140</sup> Meqë Bullgaria dhe Greqia e kishin bërë të ditur paraprakisht që presidentët e tyre nuk do të marrin pjesë në samit, kur edhe Presidenti kroat Ivo Josipovic po ashtu e bëri të ditur që nuk do të vinte, samiti u anulua në tërësi.<sup>141</sup>

Edhe pse Komisioneri për Zgjerim i UE-së Stefan Füle nuk e komentoi anulimin e samitit të PBEJL-së, ai ngulmoi qartë në përfshirjen e përfaqësuesve nga i tërë rajoni.<sup>142</sup> Anulimi i samitit e solli përsëri në sipërfaqe rëndësinë e jashtëzakonshme të përfshirjes së Kosovës në organizatat dhe nismat rajonale. Kjo e dëshmoi që në rajon nuk mund të ketë bashkëpunim domethënës dhe konstruktiv rajonal pa përfshirjen e plotë të Kosovës. Si pasojë, në vitin 2014 Kosova u ftua, edhe në takimin e dytë joformal, edhe në Samitin e PBEJL-së si mysafir i veçantë i drejtimit nga ana e Rumanisë. Duke folur për rëndësinë e PBEJL-së për rajonin dhe duke i dhënë argumentet pse Kosova duhet të bëhet anëtar i kësaj organizate, Ministri i Jashtëm i Kosovës, Enver Hoxhaj, po ashtu e shprehu përkushtimin e Kosovës për të qenë pjesë e PBEJL-së si një nga organizatat më të rëndësishme nga aspekti i bashkëpunimit rajonal.<sup>143</sup> Nga ana tjetër, në qershor 2014, jo vetëm që Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga mori pjesë në Samitin e PBEJL-së të Krerëve të Shteteve dhe të Qeverive, por u përvetësua edhe Deklarata e Samitit që “e fton Kosovën të marrë pjesë në një mënyrë të përhershme në veprimtaritë dhe takimet e PBEJL-së, në të gjitha nivelet dhe në kushte të barabarta.”<sup>144</sup> Edhe pse Zëvendës Kryeministri i parë dhe Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë Ivica Dacic u ngut që ta mohonte atë që Kosova do të bëhet një anëtar i plotë i PBEJL-së, është e qartë që Kosova dalëngadalë është duke u bërë anëtar i plotë i familjes rajonale.<sup>145</sup>

### 3.4.3. Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore (CEFTA)

Ashtu siç tashmë është diskutuar, në prill 2006 vendet anëtare të CEFTA-s në atë kohë dhe vendet e Ballkanit Perëndimor u morën vesh për riorganizimin e CEFTA-s duke e ripunuar rregullën për anëtarësi për t'i përfshirë vendet e Evropës Juglindore. Rrjedhimisht, së bashku me vendet e tjera të rajonit Kosova u bë pjesë e CEFTA-s përmes marrëveshjes për aksesion, që në emër të Kosovës u nënshkrua nga UNMIK-u. Edhe pse tregtia për vite të tëra është konsideruar si fusha më e rëndësishme e bashkëpunimit rajonal në Ballkan, pas suksesit fillestar CEFTA më pas pësoi nga grindjet e vazhdueshme dhe luftrave tregtare lidhur me çështjet kontestuese. Pos kësaj, CEFTA është sfiduar në mënyrë të vazhdueshme për shkak të trendeve proteksioniste, pengesave në

---

<sup>140</sup> “Albanian President explains his decision not to take place in the SEECP Summit in Ohrid” *Independent Balkan News Agency*, 29 maj 2013, <http://www.balkan.eu.com/albanian-president-explains-decision-place-seeep-summit-ohrid/wsthash.uW02NtSa.dpuf> (13.10.2014)

<sup>141</sup> “Macedonia Cancels Regional Summit Amid Kosovo Dispute,” *Radio Free Europe/Radio Liberty*, 29 maj 2013, <http://www.rferl.org/content/balkan-summit-cancel-kosovo-macedonia/25001274.html> (13.10.2014).

<sup>142</sup> “Füle fails to comment on SEECP Summit cancellation, urges inclusion,” *Macedonia Online*, 31 maj 2013, <http://www.macedonia-online.com/fule-fails-to-comment-on-seeep-summit-cancellation-urges-inclusion> (13.10.2014).

<sup>143</sup> “Minister Hoxhaj seeks Kosovo’s membership in SEECP,” Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Kosovo, 18 shkurt 2014, <http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,2246> (13.10.2014).

<sup>144</sup> “SEECP Bucharest Summit Declaration,” Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Romania, 25 qershor 2014, 3 para 3.

<sup>145</sup> “Kosovo Did Not Become SEECP Member,” *InSerbia Network Foundation*, 2 korrik 2014, <http://inserbia.info/today/2014/07/kosovo-did-not-become-seeep-member/> (13.10.2014).

sigurimin e gjithëpërfshirshmërisë dhe paaftësisë për t'i zgjidhur grindjet bilaterale politike dhe ekonomike.<sup>146</sup> Nga ana tjetër, duke e marrë parasysh që zhvillimi i ardhshëm ekonomik i Kosovës është i bazuar në tregti, prodhim dhe eksport, CEFTA gjithsesi dukej si një mekanizë shumë e rëndësishme për t'i arritur këto qëllime. Përmes anëtarësisë në CEFTA Kosova është para një tregu prej 20 milionë konsumatorësh, në kohën kur është po ashtu e hapur ndaj vendeve të tjera anëtare për bartjen e njohurive rreth tregtisë, teknologjisë dhe konkurrencës.<sup>147</sup>

Megjithatë, Kosova vështirë që mundi t'i shfrytëzonte këto benefite të CEFTA-s, meqë kjo e shpalli pavarësinë shumë shpejt pas anëtarësimit të vet në organizatë. Edhe pse sipas Kushtetutës së Kosovës autoritetet kosovare duhej ta siguronin përfaqësimin e saj rajonal dhe ndërkombëtar, ato nuk u pranuan si trashëgimtarë të drejtpërdrejt të UNMIK-ut nga disa prej palëve në këto marrëveshje.<sup>148</sup> Si pasojë, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina kërkuan që në të gjitha takimet e CEFTA-s Kosova duhej të përfaqësohej nga përfaqësuesi i UNMIK-ut. Për më tepër, një herë pasi që institucionet e Kosovës i ndryshuan vultat nga "Doganat e UNMIK-ut" në "Doganat e Kosovës," Serbia dhe BeH në mënyrë të njëanshme e bllokuan eksportin e të mirave nga Kosova, dhe e bllokuan shfrytëzimin e territorit të tyre për qëllime të tranzitit.<sup>149</sup> Rrjedhimisht, bllokada e shkaktoi një rënie të eksporteve të Kosovës për 9.8% vetëm gjatë vitit 2008, ndërkohë që kompanitë lokale u detyruan t'i shfrytëzojnë vendet e treta ashtu që të integroheshin në tregun rajonal.<sup>150</sup> Në vitin 2009, edhe pse deficit i tërësishëm tregtar i Kosovës vlerësohej në 43% të GDP-së, për shkak të bllokadës ky deficit i saj përmbajtësor në tregtinë e të mirave dhe shërbimeve nuk u ndihmua nga bashkëpunimi rajonal përmes CEFTA-s.<sup>151</sup> Pos kësaj, gjatë periudhës 2008-2011 produktet e Kosovës u bënë më pak konkurrense në tregun evropian dhe investitorët e jashtëm u dekurajuan për të investuar në Kosovë për shkak të vështirësive për t'i eksportuar produktet e tyre në rajon.<sup>152</sup>

Është interesante për t'u vërejtur që edhe përkundrejt mos-nënshtrimit të qartë të Serbisë dhe të Bosnjes e Hercegovinës ndaj marrëveshjes së CEFTA-s dhe humbjeve të qarta të ekonomisë kosovare, autoritetet e Kosovës nuk ndërmorën kurfarë masash për pothuaj pesë vjet. Vetëm në vitin 2011 Kosova vendosi të ndërmirte masa reciproke kundër të dyja vendeve.<sup>153</sup> Kjo çështje shkaktoi tendosje politike dhe të sigurisë në vendet përkatëse që u desht të adresoheshin jashta sekretariatit të CEFTA-s. Me përfshirjen e drejtpërdrejtë të Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm në kuadrin e procesit të dialogut të ndihmuar nga UE-ja në Bruksel gjatë shtatorit 2011, pranimi i vulave të doganës së Kosovës, edhe nga Serbia, edhe nga BeH, çoi në heqjen e embargove të ndërsjella në tregti.<sup>154</sup> Në përgjithësi, është një zhgënjim i madh i autoriteteve të Kosovës lidhur

---

<sup>146</sup> Kallaba, 2012, fq. 9.

<sup>147</sup> "Kosovo in CEFTA: In or Out?," Policy Brief, The Institute for Advanced Studies GAP, mars 2011, fq.4.

<sup>148</sup> Curri dhe Loshi, 2013, fq. 72.

<sup>149</sup> Kallaba, 2012, fq. 10.

<sup>150</sup> "Kosovo in CEFTA: In or Out?," 2011, fq. 4.

<sup>151</sup> Mamei, 2011, fq. 25.

<sup>152</sup> Kallaba, 2012, fq. 110. n

<sup>153</sup> Xharra, Besian, "Kosovo to Tackle Serbia Blockade at CEFTA," *Balkan Insight*, 24 mars 2011, <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-to-tackle-serbia-blockade-at-next-cefta-meeting> (14.10.2014).

<sup>154</sup> Kallaba, 2012, fq. 11.

me CEFTA-n. Në shtator 2012, Koordinatorin Kombëtar i Kosovës për Bashkëpunimin Rajonal, z. Edon Cana e fajësoi UE-në për atë që Serbinë nuk e bëri llogaridhënese dhe e akuzoi atë që rezultatet i ofron tepër ngadalë dhe në hesap të Kosovës.<sup>155</sup> Megjithatë, bazuar në Raportin e CEFTA-s për vitin 2012, Kosova së bashku me Moldovën janë seriozisht pas vendeve të tjera në rajon, si dhe në praktikën ndërkombëtare në përgjithësi.<sup>156</sup> Në rrethana të tilla, dhe duke e patur parasysh kundërshtimin e vazhdueshëm nga Serbia dhe nga vendet e tjera mosnjohëse, të paktën në ndërkohë, perspektivat e Kosovës për anëtarësim të plotë në CEFTA mbeten mjaft të dobëta.

#### 3.4.4. Nisma e Evropës Qendrore (NEQ)

Ashtu siç u përmend më parë, meqë anëtarësia e saj e paraqet një përzierje të nëntë anëtarëve të UE-së dhe të nëntë vendeve që nuk janë anëtare të UE-së, Nisma e Evropës Qendrore e luan një rol domethënës në procesin e përshejtimin të integritimit evropian të shteteve anëtare që nuk janë në UE. Sidoqoftë, për shkak të profilit të lartë politik të takimeve të NEQ, Kosova deri në kohët e fundit nuk ia ka dalë ta arrijë ndonjë përparim domethënës nga aspekti i pjesëmarrjes së saj në këtë nismë. Arsyeja kryesore, në mesin e shumë të tjerave, është në faktin që dy shtete anëtare të UE-së dhe pesë shtete anëtare që nuk janë në UE (përfshirë Serbinë dhe Bosnjen e Hercegovinën) nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës. Megjithatë, pas përparimit të bërë me Serbinë përmes dialogut të ndihmuar nga UE-ja dhe anëtarësimit në disa organizata dhe nisma rajonale, Kosova ia ka dalë të marrë pjesë në konferencën e Këshillit të Punëve të Jashtme të vendeve anëtare të Nismës së Evropës Qendrore që është mbajtur në Vjenë në qershor 2014. Me këtë rast, Zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Kosovës që mori pjesë si mysafir i veçantë i Kryesuesit, po ashtu mori pjesë në konferencën e organizuar në margjinë të samitit, që iu kushtua integritimit evropian dhe zhvillimit ekonomik në Ballkanin Perëndimor.<sup>157</sup>

Nga aspekti i perspektivave të ardhshme për t'iu bashkangjitur NEQ-së, Kosova mund të përfitojë nga anëtarësimi i saj i kohëve të fundit në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD). Kjo don të thotë që, meqë NEQ-ja ka bashkëpunim të fuqishëm me EBRD-në, dhe merr përkrahje financiare nga ajo, anëtarësia e Kosovës në të mund të ofrojë perspektiva shtesë për t'iu bashkangjitur Nismës. Nga ana tjetër, meqë qëllimi strategjik dhe themeli i të gjitha veprimtarive të NEQ-së është “bashkëpunimi rajonal për integritim evropian,” Kosova mund ta shfrytëzojë, po ashtu, progresin e saj të tashëm drejt UE-së, dhe përkrahjen shumë të madhe të Unionit për pjesëmarrjen e saj rajonale, për ta dhënë në fund një argument edhe më të fuqishëm për t'iu bashkangjitur nismës.

---

<sup>155</sup> Curri dhe Loshi, 2013, fq. 80.

<sup>156</sup> Kurtovic, Safet, Siljkovic, Boris dhe Dasic, Boban, “The effect of non-tariff barriers on trading flows Bosnia and Herzegovina within CEFTA 2006,” Volume 8, Issue 2, Shkup, dhjetor 2013, fq. 17.

<sup>157</sup> “Selimi participates in the ministerial meeting of the CEI,” Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, 4 qershor 2014; <http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,2361> (20.10.2014).



### 3.4.5. Partneriteti i Kartës së Adriatikut

Ashtu siç u përmend më heret, në dhjetor 2008, nisma u zgjerua edhe më tutje, kur gjatë takimit ministror të OSBE-së në Helsinki, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina iu bashkangjitën Kartës së Adriatikut. Që nga atëherë, këto pesë vende anëtare rëndom referoheshin si vendet A-5. Pos kësaj, Serbia i përcolli konferencat e Kartës në statusin e vëzhguesit në nivelin ministror dhe në nivelin e Komandantëve të Gjeneralshtabeve. Kosova ka marrë pjesë, po ashtu, edhe në takimet e Kartës si vëzhgues në nivelin ministror apo në nivelin e Komandantëve ushtarakë të Shtabit, por deri më tash nuk ka marrë pjesë në kurfarë ushtrimesh ushtarake.<sup>158</sup> Meqë synimi i qartë i Kartës është “integrimi i plotë në institucionet evropiane dhe trans-atlantike ekonomike, të sigurisë dhe të mbrojtjes”<sup>159</sup> i anëtarëve të tij, qëllimi i Kosovës për t’u bërë anëtar i saj i plotë nuk është për t’u befusuar. Rrjedhimisht, si pjesë e aspiratave dhe përpjekjeve të saj euro-atlantike për ta zgjeruar pjesëmarrjen rajonale, Kosova në vitin 2012 ka aplikuar për anëtarësim në A-5. Shpresohet që anëtarësimi në Kartë është një mënyrë për ta ndihmuar integrimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në mekanizmin e mbrojtjes dhe sigurisë rajonale të Kartës, duke e lehtësuar kësaj rruge për në NATO.<sup>160</sup> Pos kësaj, pavarësisht nga aspiratat e saj për anëtarësim në NATO, Kosova është i vetmi vend në rajon që nuk ka patur ofertë për të marrë pjesë në Partneritetin për Paqe. Një izolim i tillë i Kosovës nga instrumentet konsultative të NATO-s – KPEA dhe PFP – e paraqet një sfidë për përmbylljen e arkitekturës së sigurisë në rajon, dhe në Evropën si të tërë, posaçërisht për shkak të mospajtimeve të pazgjidhura me Beogradin dhe institucioneve të papërfunduara kombëtare të mbrojtjes.<sup>161</sup>

Megjithatë, gjasat e Kosovës për anëtarësim janë momentalisht seriozisht të penguar nga mosnjohja e pavarësisë së saj nga Bosnja e Hercegovina si anëtar i plotë i A-5, meqë Karta kërkon konsensus nga të gjithë anëtarët e saj.<sup>162</sup> Nga ana tjetër, Serbia i ka vazhduar përpjekjet e saj për ta bllokuar pjesëmarrjen rajonale të Kosovës edhe në këtë nismë. Edhe pse vetë është vëzhguese, Serbia tashmë i ka bojkotuar disa takime të Kartës të cilat i ka përcjellur Kosova në cilësinë e vëzhguesit, ndërkohë që në takimin e ministrave të punëve të jashtme në Zagreb në vitin 2012 kjo e ka dërguar një diplomat të nivelit më të ulët.<sup>163</sup> Mirëpo, ishte pikërisht në këtë takim të Komisionit të Kartës në Zagreb që vendet anëtare e theksuan atë që Karta e SHBA-Adriatikut mbetet e hapur për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe që, në kuadrin e kësaj, ajo e mirëpriste praninë e delegacioneve

---

<sup>158</sup> Për shembull, Kosova ka marrë pjesë në takimet e Komisionit të Partneritetit të Kartës së Adriatikut që janë mbajtur në Shkup dhe në Zagreb, në dhjetorët e viteve 2010 dhe 2012; shih, “Çitaku to Take Part in the Adriatic Charter – USA Forum, Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, 14 dhjetor 2010; <http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,617> (14.10.2014).

<sup>159</sup> Komunikatë për shtyp e Departamentit të Shtetit, 2003.

<sup>160</sup> Brajshori, Muhamet, “Kosovo looking to join the Adriatic Charter,” *Southeast European Times*, 21 janar 2013; [http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/features/setimes/features/2013/01/21/feature-04](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2013/01/21/feature-04) (14.10.2014).

<sup>161</sup> Peci, Lulzim, “Kosovo in the Security and Defence Context of the Western Balkans,” Kosovar Institute for Policy Research and Development, shtator 2014, fq. 54.

<sup>162</sup> Emini, 2014, fq. 15.

<sup>163</sup> Brajshori, 2013.

të Kosovës dhe të Serbisë si një plotësim të planit rajonal të bashkëpunimit.<sup>164</sup> Pos kësaj, anëtarësimi i kohëve të fundit i Kosovës në Verifikimin Rajonal të Kontrollit të Armatimit dhe Shërbimit e Asistencës së Implementimit (VRKASHAI) i ka mundësuar Kosovës që të përmbushë kritere për anëtarësim në NATO dhe këtë e ka sjellur një hap më afër anëtarësimin në Kartë, në të njëjtën kohë që i ka kontribuar rritjes së stabilitetit rajonal.<sup>165</sup>

## **4. PERSPEKTIVAT E ARDHSHME TË PJESËMARRJES RAJONALE TË KOSOVËS**

Ashtu siç u diskutua më heret, edhe përkundrejt pengesave dhe sfidave serioze për pjesëmarrjen e saj rajonale, Kosova ia ka dalë ta arrijë një progres të caktuar sa i përket anëtarësisë së saj në organizatat dhe nismat rajonale. Sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, me anëtarësimin e fundit në VRKASHAI, Kosova ia ka dalë ta sigurojë anëtarësimin e plotë në një numër total prej 35 organizatash rajonale dhe ndërkombëtare.<sup>166</sup> Në mesin e tyre, anëtarësimi i plotë në Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal dhe në krahun e tij politik, PBEJL, janë gjithsesi më të rëndësishmet. Nga ana tjetër, Kosova nuk ka patur shumë interes, dhe, rrjedhimisht, nuk ka ndërmarrë hapa konkretë drejt pjesëmarrjes në Organizatën e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi, të Nismës së Adriatik-Jonit dhe të Nismës Bashkëpunuese të Evropës Juglindore. Mirëpo, anëtarësia në KBR i ka mundësuar Kosovës të ketë qasje në një numër të madh organizatash dhe nismash të tjera që vepron nën të. Megjithatë, është e qartë që perspektivat e ardhshme të pjesëmarrjes rajonale të Kosovës do të varen në mënyrë domethënëse nga tre faktorë vendimtarë: (1) Nga marrëdhëniet e tërësishme midis Kosovës dhe Serbisë; (2) Nga njohja ndërkombëtare dhe integrimi i Kosovës; dhe, (3) Nga kapaciteti institucional i institucioneve të Kosovës.

### **4.1. Marrëdhëniet e tërësishme midis Kosovës dhe Serbisë**

Ashtu siç e kemi parë më parë, Serbia deri më tash ka qenë pengesa kryesore për pjesëmarrjen e Kosovës në organizatat dhe nismat rajonale. Duke qenë tashmë anëtare e shumicës së këtyre organizatave, Serbia i ka shfrytëzuar të gjitha fuqitë e veta politike dhe diplomatike ashtu që, në parim, ta parandalonte integrimin rajonal të Kosovës. Madje edhe pas arritjes së marrëveshjes për Arranzhimet Lidhur me Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal (ALPBR), Serbia, të paktën fillimisht, vazhdoi ta luante lojën për ta penguar pjesëmarrjen rajonale të Kosovës. Në një mënyrë mjaft ironike, një ndryshim i madh, të paktën nga aspekti i zbatimit të suksesshëm të ALPBR-së, filloi pasi Serbia e zgjodhi qeverinë e vet të re në shtator 2012. Edhe pse pritej që qeveria e re do të

---

<sup>164</sup> "MFA welcomes the results of the US-Adriatic Charter Partnership Commission," Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë, 14 dhjetor 2012; [http://www.keminet.net/~minfagov/index.php?option=com\\_content&view=article&id=8530:mpj-pershendet-rezultatet-e-komisionit-te-partneritetit-te-kartes-se-adriatikut-shba&catid=112:lajme&Itemid=88&lang=en](http://www.keminet.net/~minfagov/index.php?option=com_content&view=article&id=8530:mpj-pershendet-rezultatet-e-komisionit-te-partneritetit-te-kartes-se-adriatikut-shba&catid=112:lajme&Itemid=88&lang=en) (14.10.2014).

<sup>165</sup> "Kosova anëtarësohet në organizatën e sigurisë RACVIAC," *KOHAnet*, 10 tetor 2014; <http://koha.net/?id=27&l=28875> (14.10.2014)

<sup>166</sup> "Kosova anëtare e 35 organizatave rajonale e ndërkombëtare," *KOHAnet*, 15 tetor 2014; <http://koha.net/?id=27&l=29472> (16.10.2014).

jetë më nacionaliste se paraprakja, kjo në shtator 2012 i bëri disa ndryshime pozitive lidhur me qëndrimin për interpretimin e ALPBR-së. Domethënë, qeveria e përvetësoi një udhëzim të ri, sipas të cilit fusnota duhej të qëndronte vetëm në dokumentet zyrtare të takimeve, dhe jo në pllakëzat me emrin e Kosovës. Pos kësaj, në situata kur nuk kishte arsye me justifikime të forta, ky udhëzim i jepte liri veprimi Qeverisë, për t'u mundësuar përfaqësuesve të Serbisë t'i vijojnë takimet madje edhe kur kushtet e parashtruara në udhëzim nuk plotësohen.<sup>167</sup>

Një qëndrim i tillë i ri i Qeverisë së Serbisë e mundësoi pjesëmarrjen e përbashkët të Beogradit dhe Prishtinës në takimet rajonale, duke e shënuar, kështu, një hap përpara në bashkëpunimin rajonal. Së shpejti pas kësaj, kjo u vijua nga një fazë e re e dialogut të promovuar nga UE-ja për çështjet “teknike,” që kësaj here u arranzhua në nivel më të lartë. Më 19 tetor 2012, Kryeministri i Serbisë, Ivica Dačić, dhe ai i Kosovës, Hashim Thaçi, u takuan në Bruksel nën organizimin e Përfaqësueses së Lartë të UE-së për Çështjet e Jashtme dhe për Politikën e Sigurisë (PJPS), Baroneshës Kethrin Eshton.<sup>168</sup> Takimi vijues, që u mbajt më 7 shkurt 2013, i bëri bashkë Presidentët e dy vendeve, Atifete Jahjagën e Kosovës dhe Tomislav Nikoliqin e Serbisë.<sup>169</sup> Këto takime çuan në hapat e mëtutjeshëm drejt normalizimit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. Një nga arritjet më të mëdha ishte marrëveshja për t'i caktuar zyrtarët përkatës për ndërlidhje që do të vendoseshin në godinat e UE-së në Beograd dhe në Prishtinë. Pos ofrimit të ndërtesave të veta, UE-ja do të ofronte edhe ndihmë për t'i arritur këto arranzhime, dhe asistencë për zbatimin e tyre. Zyrtarët për ndërlidhje, me detyrë për t'i ndjekur të gjitha çështjet e ndërlidhura me normalizimin e marrëdhënieve, dhe, në instancë të fundit, për t'i adresuar problemet e përditshme, u shkëmbyen në mesin e qershorit 2013.<sup>170</sup> Qeveritë e dy vendeve e ndërmorën një hap përpara, kur Kryeministrat e Kosovës, Thaçi, dhe të Serbisë, Dačić, më 19 prill 2013 në Bruksel, nën mbikëqyrjen e Unionit Evropian, e nënshkruan “Marrëveshjen e Parë për Parimet për Normalizimin e Marrëdhënieve.” Edhe pse marrëveshja është kundërshtuar, edhe në Serbi, edhe në Kosovë, kjo më pas u miratua nga të dyja parlamentet, në Beograd, dhe në Prishtinë.<sup>171</sup> E qartë, shtytja kryesore prapa këtyre arritjeve ishte premtimi i përparimit të mëtutjeshëm drejt integritimit në UE. Perspektiva e jetës më të mirë brenda UE-së përmes reformave rrënjësore shoqërore dhe ekonomike ashtu siç është kërkuar nga

---

<sup>167</sup> Staletović, Ljiljana, “Fusnota može, ali ne mora,” *Dnevni Akter*, 9 shtator 2012; <http://www.akter.co.rs/weekly/33-politika/print-14562-fusnota-mo-e-ali-ne-mora.html> (16.10.2014)

<sup>168</sup> Shih Barlovac, Bojana, “Dacic and Thaci Meet in Brussels, Make History,” *Balkan Insight*, 19 tetor 2012; [www.balkaninsight.com/en/article/dacic-and-thaci-make-history-attending-meeting](http://www.balkaninsight.com/en/article/dacic-and-thaci-make-history-attending-meeting) (15.10.2014).

<sup>169</sup> Barlovac, Bojana, “Kosovo, Serbia Presidents Hail Outcome of Talks,” *Balkan Insight*, 7 shkurt 2013 [www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-and-serbiapresidents-pledge-to-normalise-relations](http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-and-serbiapresidents-pledge-to-normalise-relations) (15.10.2014).

<sup>170</sup> Shih “The Agreement on Liaison Arrangements,” Bruksel, 31 maj 2013; shih, po ashtu, “Priština Appoints New Liaison Officer in Belgrade,” *B92*, 21 qershor 2013 [www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2013&mm=06&dd=21&nav\\_id=86708](http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2013&mm=06&dd=21&nav_id=86708) (15.10.2014).

<sup>171</sup> Marrëveshja referohet po ashtu si Marrëveshja e Brukselit. Ndër të tjera, kjo saktëson “që asnjëra palë nuk do ta bllokojë, apo inkurajojë të tjerët të bllokojnë, përparimin e palës tjetër në rrugët përkatëse të UE-së.” Edhe pse drafti më i hershëm i referohej “qasjes në organizatat ndërkombëtare,” ky u refuzua nga Beogradi, meqë ky mendonte që kjo do të çonte në njohjen e tij formale të Kosovës. Shih “Information Session: First Agreement Between Serbia and Kosovo of Principles Governing Normalization of Relations,” *Wilson Center*, 24 prill 2013; <http://www.wilsoncenter.org/event/information-session-first-agreement-between-serbia-and-kosovo-principles-governing> (17.10.2014).

*acquis*, përsëri është dëshmuar se është një nxitje e rëndësishme, edhe për Serbinë, edhe për Kosovën.<sup>172</sup>

Këtu duhet përmendur që, megjithatë, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, lidhshipi në Beograd e përvetësoi pikëpamjen që mund ta ndjekë paralelisht betejën e vet të pandërprerë për ambicjet që Serbia t'i bashkangjitet UE-së së bashku me Kosovën. Të paktën fillimisht, UE-ja, që edhe vetë ishte e ndarë rreth çështjes së Kosovës, ka lëvizur heshtazi krah për krah me këtë ide. Meqë mbrojtja e integritetit territorial të Serbisë ishte një domosdo madje edhe për udhëheqësit serbë pro-evropianë, një arsytim i tillë nga UE-ja ishte i kuptueshëm. Domethënë, ngulmimi që nga fillimi në pranimin e shtetësisë së Kosovës do të kishte rezultuar në një bllokim të përnjehershëm të përparimit të Serbisë drejt UE-së.<sup>173</sup> Mirëpo, më vonë UE-ja e bëri të qartë që dy çështjet nuk janë aq të ndara sa Beogradi do të donte të ishin. Shumica e vendeve të UE-së besojnë që përparimi i Serbisë drejt Brukselit duhet të shoqërohet me një normalizim të caktuar hap-pas-hapi të marrëdhënieve me Prishtinën. Meqë vendimet për zgjerim bazohen në konsensus, është e mundur madje edhe për shtetet individuale të UE-së që t'i imponojnë vetë kushtet e veta lidhur me këtë çështje. Rrjedhimisht, ishte kancelarja gjermane, Angela Merkel, ajo që në gushtin e vitit 2011 e ndërliði qartë statusin e kandidatit të Serbisë me përparimin e përmirësimit të marrëdhënieve me Prishtinën.<sup>174</sup> Më vonë, në Strategjinë e vet për Zgjerim 2012-2013, Komisioni Evropian e saktësoi qartë që “një përmirësim i dukshëm dhe i qëndrueshëm i marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës nevojitet ashtu që të dyjat të mund të vazhdojnë në rrugën e tyre përkatëse drejt UE-së, ndërkohë që do të shmanget ajo që cilado prej tyre ta bllokojë tjetrën në këto përpjekje. Ky proces duhet të rezultojë gradualisht në normalizimin e plotë të marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës me perspektivën që të dyjat të jenë në gjendje t'i ushtrojnë në tërësi të drejtat e tyre dhe t'i përmbushin përgjegjësitë e tyre përbrenda UE-së.”<sup>175</sup>

Në një mënyrë, zbutja e qëndrimit të Serbisë ndaj pjesëmarrjes rajonale të Kosovës u përputh me këto mesazhe të reja të UE-së. E qartë, është një logjikë në idenë që aspiratat e UE-së të Serbisë dhe politikat e saj ndaj Kosovës duhet të shikohen së bashku. Ashtu siç tashmë është përmendur, zhvillimi i marrëdhënieve pozitive me fqinjët ka qenë gjithmonë një aspekt i rëndësishëm i zgjerimit të UE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor. Nga ana tjetër, duke patur parasysh investimin shumë të madh të UE-së në Kosovë, është e qartë që çfarëdo politikash të Serbisë kundër Kosovës do të jenë të dëmshme për interesat e UE-së. Pos kësaj, meqë perspektiva e UE-së shtrihet në të tërë

---

<sup>172</sup> Madden, David, “Serbia and regional cooperation in the Western Balkans: EU membership perspective as a tool for overcoming the past,” *South East European Studies at Oxford*, 8 maj 2013; <http://seesoxcentral.blogspot.com/2013/05/serbia-and-regional-cooperation-in.html> (16.10.2014).

<sup>173</sup> Lehne, Stefan, “Kosovo and Serbia: Toward a Normal Relationship,” *The Carnegie Endowment for International Peace, Policy Outlook*, mars 2012, fq. 7.

<sup>174</sup> Cahn, Dianna, “EU Candidacy Drives Serbia to Improve Kosovo Relations,” *Voice of America*, 31 gusht 2011; <http://www.voanews.com/content/eu-candidacy-drives-serbia-to-improve-kosovo-relations-128908358/170852.html> (18.10.2014).

<sup>175</sup> Komisioni Evropian, “Enlargement Strategy and Main Challenges 2012-2013,” *Communication from the Commission to the European Parliament and the Council COM(2012) 600*, Commission of the European Communities, Bruksel, 10 tetor 2012.

Ballkanin Perëndimor, nga aspekti i politikave të UE-së ndaj rajonit do të ishte kundërproduktive nëse Serbia do të bëhej një shtet i ri anëtar dhe do ta bllokonte përparimin e mëtutjeshëm të Kosovës drejt UE-së.<sup>176</sup> Në një mënyrë të qartë, një realitet i tillë e paraqet shansin më të mirë të Kosovës për t'i përmirësuar perspektivat për një pjesëmarrje të plotë dhe domethënëse rajonale. Kosova duhet ta shfrytëzojë kondicionalitetin e veçantë lidhur me Kosovën për përparimin e Serbisë drejt UE-së në hesap të integritit të vet rajonal. Për të njëjtin shkak, Kosova duhet t'i intensifikojë reformat e veta strukturale në rrugëtimin e vet drejt Unionit Evropian, në të njëjtën kohë kur duhet ta dëshmojë vullnetin e vet politik dhe përkushtimin për t'i plotësuar kërkesat dhe standardet evropiane në këtë proces. Ashtu siç Stefan Lehne me të drejtë e vuri në dukje, “Ashtu siç rruga më e mirë për Prishtinën që ta bindë Beogradin për ta marrë një qasje më konstruktive shkon përmes Brukselit, përmirësimi i marrëdhënieve me Beogradin do të jetë një rrugë e rëndësishme për Kosovën që të arrijë përparim drejt UE-së.”<sup>177</sup> Megjithatë, normalizimi i plotë i marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, është vështirë i paramendueshëm pa një njohje të ndërsjellë. Nëse do të vazhdohet politika e tashme e Brukselit “për të mos e toleruar edhe një Qipro tjetër,” atëherë, çmimi përfundimtar për anëtarësimin e Serbisë në UE do të jetë njohja e Kosovës, mirëpo, çmimi përfundimtar që do të duhet ta paguaj Kosova ende mbetet i paqartë.

#### 4.2. Njohja ndërkombëtare dhe integrimi i Kosovës

Sipas informatave zyrtare në uebsajtin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, deri më tash Kosovën e kanë njohur 98 vende,<sup>178</sup> edhe pse numri që rëndom përmendet nga autoritetet e Kosovës është 108. Pa gjykuar nëse numri i tashëm është i lartë apo i ulët, janë padyshim disa vende mosnjohëse që janë të rëndësishme për Kosovën sa i përket pjesëmarrjes së saj të suksesshme rajonale. Para së gjithash, kjo ka të bëjë me pesë vendet anëtare të UE-së që ende nuk e kanë njohur shtetësinë e Kosovës. Nga këto pesë vende, Greqia dhe Rumania janë jashtëzakonisht të rëndësishme kur fjala është për integrimin rajonal të Kosovës. Në fakt, këto dy vende janë, po ashtu, pjesë e rajonit më të gjerë, dhe në të njëjtën kohë edhe anëtare të disa organizatave dhe nismave të rëndësishme rajonale. Një përparim në trajtë të njohjes nga këto dy vende do t'i përmirësonte seriozisht perspektivat e Kosovës për një pjesëmarrje të suksesshme rajonale. Ashtu siç tashmë është vërejtur, përkrahësi kryesor i përfshirjes së Kosovës në forumet rajonale deri më tash ka qenë UE-ja. Ishte UE-ja ajo që e ndihmoi dialogun që sollti deri te ALPBR-ja, që më tutje i mundësoi Kosovës për t'u bërë anëtare e disa nismave të rëndësishme rajonale të tilla si KBR dhe PBEJL. Mirëpo, UE-ja nuk është në gjendje të flasë me një zë të vetëm kur fjala vjen te Kosova, meqë pesë nga 28 anëtarët e tij ende nuk e kanë njohur pavarësinë e saj. Pos kësaj, mosnjohja nga pesë shtete anëtare të UE-së atë e parandalon që me Kosovën të mirret në të njëjtin nivel si ai që e mban me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor.<sup>179</sup>

---

<sup>176</sup> International Crisis Group, “Serbia and Kosovo: The Path to Normalisation,” *ICG Europe Report* N° 223, 19 shkurt 2013.

<sup>177</sup> Lehne, 2012, fq. 8.

<sup>178</sup> Shih, “Countries that have recognized the Republic of Kosova,” Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Kosovo; <http://www.mfa-ks.net/?page=2,33> (17.10.2014).

<sup>179</sup> Lehne, 2012, fq. 5.

Shumëkush argumenton që kjo është arsyeja kryesore pse Kosova dhe Serbia nuk janë “shpërblyer” në mënyrë të barabartë për konstruktivitetin e tyre gjatë të tërë dialogut të përkrahur nga UE-ja. Ndërkohë që ministrat e UE-së në Këshillin e fundit të Çështjeve të Përgjithshme të vitit 2013 u pajtuan që Serbia duhet t’i fillojë bisedimet për hyrje, Kosova vetëm është falënderuar për atë që ishte konstruktive dhe besnike ndaj UE-së. Shpresat e Kosovës që dialogu me Serbinë do ta përshpejtojë përparimin e saj drejt udhëtimit të lirë nga vizat dhe nënshkrimi të paktit të Stabilizimit dhe Asociimit me UE-në ende nuk janë realizuar.<sup>180</sup> Prandaj, Kosova duhet të përpiket ta rrisë momentin e kohëve të fundit të krijuar nga zhvillimet pozitive me Serbinë për t’i intensifikuar përpjekjet e veta ndaj pesë anëtarëve mosnjohës të UE-së. Në maj 2014, Kosova i ka përfunduar negociatat formale për Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit, dhe kjo pritet t’i nënshkruaj MSA-të deri në fundin e këtij viti. Edhe pse marrëveshja do ta ketë trajtën e një marrëveshjeje vetëm me UE-në, duke i përfshirë UE-në në njërën anë, dhe Kosovën në tjetrën, kjo do të ushtrojë trysni shtesë në pesë shtetet mosnjohëse anëtare të UE-së.<sup>181</sup> Edhe pse sipas dispozitave të reja të Traktatit të Lisbonës MSA-të nuk kanë nevojë për t’u ratifikuar nga shtetet anëtare, Kosova së bashku me UE-në duhet ta shfrytëzojnë nënshkrimin e marrëveshjes për të ndërmarrë veprime të koordinuara për të ushtruar trysni të mëtutjeshme në shtetet mosnjohëse. Duke e bërë këtë, Kosova duhet posaçërisht të mbështetet në përfshirjen e tashme të rritur të Gjermanisë në rajon. Bazuar në gjendjen e tashme, është vështirë për të besuar që Spanja dhe Qiproja, dhe, deri në një masë, edhe Sllovakia, do t’i ndryshojnë qëndrimet e tyre ndaj Kosovës, pavarësisht nga trysnia që mund të ushtrohet në to. Prandaj, përpjekjet e Kosovës për njohje gjatë kësaj periudhe duhet të përqendrohen në Greqinë dhe Rumaninë. Pos asaj që janë vendet më të rëndësishme të UE-së për integrimin rajonal të Kosovës, që të dyja këto vende kohëve të fundit kanë treguar shenja të caktuara të ndryshimit të qëndrimit të tyre ndaj njohjes së Kosovës. Kështu, Greqia kohëve të fundit ka deklaruar që e dëshiron Kosovën në UE dhe që kjo e përkrah atë që të gjitha shtetet anëtare të UE-së duhet ta njohin atë.<sup>182</sup> Nga ana tjetër, Kryeministri i tashëm i Rumanisë, Victor Ponta ka premtuar që do ta rimendojë kundërshtimin e pavarësisë së Kosovës nga Rumania nëse ai e fiton garën presidenciale në nëntor 2014.<sup>183</sup> Njohja eventuale nga këto dy shtete anëtare të UE-së padyshim që do ta ushtrojë një trysni shumë të madhe mbi Serbinë për të hequr dorë nga kundërshtimi i anëtarësimit të Kosovës në forumet rajonale. Në këtë rast, Kosova mund të shpresojë jo vetëm për një pjesëmarrje domethënëse rajonale, por edhe për një hap të madh përpara në integrimin e saj ndërkombëtar.

Një çështje tjetër e rëndësishme në këtë drejtim është përparimi eventual në marrëdhëniet e tërësishme me Bosnjen e Hercegovinën. Ashtu siç tashmë është vërejtur, pos Serbisë, për shkak të politikës së saj të mosnjohjes, BeH ka qenë kundërshtari më i madh i pjesëmarrjes rajonale të

---

<sup>180</sup> Zulfaj, Jeton, “Who won the EU game on Kosovo and Serbia?,” *EUobserver*, 10 janar 2013, <http://euobserver.com/foreign/122677> (17.10.2014).

<sup>181</sup> “Stabilisation and Association Agreement negotiations successfully completed,” European Union Office in Kosovo/European Union Special Representative in Kosovo, 2 maj 2014; [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/press\\_corner/all\\_news/news/2014/20140502\\_03\\_en.htm](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/press_corner/all_news/news/2014/20140502_03_en.htm) (20.10.2014).

<sup>182</sup> “Greece To Recognize Kosovo?,” *InSerbia News*, 19 mars 2014, [ins Serbia.info/today/2014/03/greece-to-recognize-kosovo/](http://ins Serbia.info/today/2014/03/greece-to-recognize-kosovo/) (20.10.2014).

<sup>183</sup> Zogjani, Nektar, “Romanian Election Raises Kosovo’s Hope of Recognition,” *BalkanInsight*, 17 shtator 2014; <http://www.balkaninsight.com/en/article/romanian-election-raises-kosovo-s-hope-of-recognition> (28.10.2014).

Kosovës. Për momentin, marrëdhënie diplomatike midis dy vendeve nuk ka, ndërkohë që edhe marrëdhëniet e tjera janë të reduktuara në minimum. Ashtu siç tashmë është shpjeguar, Serbia kohëve të fundit e ka ndërmarrë një numër hapash të rëndësishëm që i kontribuojnë zbutjes së marrëdhënieve me Kosovën dhe pjesëmarrjes më të madhe rajonale të saj. Vendet e tjera që nuk e njohin Kosovën e kanë pranuar një realitet të tillë dhe i kanë përshtatur politikat e tyre në pajtim me këtë. Mirëpo, akoma, Bosnja e Hercegovina nuk ka treguar kurfare shenjash pozitive për rivendosjen e marrëdhënieve me Kosovën, madje as në çështjet e aspekteve praktike të bashkëpunimit me qytetarët e Kosovës.<sup>184</sup> Edhe pse BeH e pranon që çfarëdo përpjekjesh për t'u kthyer në gjendjen paraprake do të ishte kundërproduktive për Serbinë dhe për rajonin, për shkak të përçarjeve të saj të brendshme, deri më tash nuk është arritur kurfare konsensusi i brendshëm rreth çështjes së Kosovës. Megjithatë, Kosova duhet ta shfrytëzojë suficitin shumë të madh tregtar prej rreth 80 milionë Eurosh që Bosnja e ka me Kosovën. Masat e përkohshme reciproke tregtare tremujore që Kosova ia imponoi Bosnjes në korrik 2011 i kishin shkaktuar humbje shumë të mëdha kompanive boshnjake.<sup>185</sup> Duke e rritur tryninë në këtë drejtim, Kosova mund të jetë në gjendje të arrijë një përparim drejt normalizimit të marrëdhënieve me BeH. Nga ana tjetër, Kosova duhet të ushtrojë tryzni në UE-në që edhe ndaj Bosnjes ta përvetësojë një kondicionalitet të ngjashëm të veçantë, ashtu që përparimi i saj drejt UE-së të jetë i ndërlidhur me Kosovën. Ndërkohë që kjo mund të mos e ndryshojë qëndrimin e Bosnjes lidhur me njohjen e Kosovës, kjo gjithsesi mund ta zbusë qëndrimin e saj lidhur me pjesëmarrjen rajonale të Kosovës. Së fundi, Kosova duhet, po ashtu, ta shfrytëzojë faktin që tashmë është njohur nga të gjithë fqinjët e vet pos Serbisë. Duke e fuqizuar dhe zhvilluar më tutje bashkëpunimin me këta fqinjë, Kosova mund të ushtrojë një tryzni shtesë në shtetet mosnjohëse nga fqinjëria e vet më e gjerë. Tashmë kemi parë si politika e Beogradit e bojkotimit të ngjarjeve rajonale që përcilleshin nga Kosova ka çuar në përjashmëri e saj nga një numër konferencash të rëndësishme. Përkrahja e vazhdueshme nga fqinjët e saj dhe nga UE-ja, mund të shtojë një tryzni shtesë, edhe në Serbi, edhe në Bosnje, për ta ndaluar politikën e tyre të pengimit të pjesëmarrjes rajonale.

Dhe, e fundit, por jo edhe më e parëndësishmja, Kosova duhet t'i vazhdojë përpjekjet e veta për integrim të mëtutjeshëm ndërkombëtar duke i përsheptuar procedurat për t'iu bashkangjitur Këshillit të Evropës. Meqë shtetet sovrane e kanë të drejtën ekskluzive për t'iu bashkangjitur organizatave ndërkombëtare, duke e siguruar anëtarësinë në Këshill, Kosova do ta legjitimojë edhe më tutje statusin e vet si shtet i pavarur. Duke u bërë anëtare e një organizate, jo vetëm që shteti e konfirmon sovranitetin e vet, por, po ashtu, sovraniteti i atij shteti të veçantë njihet nga ajo organizatë ndërkombëtare.<sup>186</sup> Në këtë kontekst, anëtarësimi i kohëve të fundit në Komisionin e Venedikut, një nga institucionet më të rëndësishme të Këshillit të Evropës, e paraqet një hap të

---

<sup>184</sup> Ndërkohë që qytetarët e BeH mund të udhëtojnë shpesh në Kosovë pa vizë, qytetarët e Kosovës që udhëtojnë në Bosnje e Hercegovinë, apo përmes territorit të saj, ende kanë nevojë për vizë. Është interesante të përmendet që Sllovakia, si një vend tjetër mosnjohës, i pranon dokumentet e udhëtimit të Kosovës me vizë të Shengenit; shih, "Kosovo: New Reality of Regional Cooperation," *Policy Analysis* 4/13, Foreign Policy Initiative BH, dhjetor 2013, fq. 10.

